




# **RAPORTI I AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2013**



Shkurt, 2014

**Tabela e lëndës**

1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM .....	1
2. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR PERIUDHËN JANAR – 4 PRILL 2013 .....	4
2.1. Përmirësimi i kuadrit nënligjor .....	4
2.2. Licencimet.....	5
2.2.1. Licencat Radio FM .....	6
2.2.2. Licencat për programet radiotelevizive me kabëll.....	6
2.2.3. Rinovimet.....	7
2.2.4. Licenca të pavlefshme.....	8
2.2.5. Miratimi i ndryshimeve në të dhënat e licencës.....	9
2.3. Programacioni .....	10
2.4. Kontrolli i veprimtarisë së subjekteve .....	17
2.5. E drejta e transmetimit të programeve radiotelevizive .....	18
2.6. Problematika në ekzekutimin e vendimeve .....	22
2.7. Subjektet me transmetime të palicencuara.....	23
2.7.1. Transmetime analoge tokësore të palicencuara .....	23
2.7.2. Transmetimet numerike të paautorizuara.....	23
2.7.2.1. Digitalb .....	23
2.7.2.2. Tring.....	24
2.7.2.3. Transmetimet numerike në rajonin Tiranë- Durrës .....	25
2.7.2.4. Transmetime numerike të verifikuara gjatë 2013-ës .....	26
2.8. Mbulimi me sinjal analog tokësor i zonës së mbulimit .....	27
2.8.1. Televizioni publik (RTSH) .....	27
2.8.2. Operatorët privatë kombëtarë .....	28

3. VEPRIMTARIA E AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE GJATË PERIU DHËS PRILL-DHJETOR 2013 .....	30
3.1. Aktet e reja nënligjore.....	30
3.2. Akte të tjera.....	41
3.3. Zëvendësimi i licencave.....	42
3.4. Mbi përmbajtjen dhe etikën e programeve .....	43
3.4.1. Mbrojtja me përparësi e të drejtave të fëmijëve.....	43
3.4.2. Personat me aftësi të kufizuara .....	45
3.4.3. E drejta e përgjigjes .....	46
3.4.4. Këshilli i Ankesave .....	46
3.5. Disa dukuri të programeve informative .....	47
3.6 Mbi regjistrimin dhe monitorimin e programeve.....	53
4. KALIMI NË TRANSMETIMET NUMERIKE .....	55
4.1. Vështrim i përgjithshëm.....	55
4. 2. Administrimi i frekuencave numerike .....	56
4.2.1. Planifikimi i rrjeteve televizive numerike.....	56
4.2.2. Koordinimi me vendet fqinjë .....	58
4.2.2.1. Koordinimi me Italinë.....	58
4.2.2.2. Koordinimi me Maqedoninë .....	61
4.2.2.3. Koordinimi me Greqinë .....	63
4.2.2.4. Koordinimi me Malin e Zi .....	63
4.2.3. Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve .....	64
4.2.4. Përgatitja e Planeve të frekuencave për fazën e parë për krijimin e rrjeteve numerike (MUX 1 - MUX 5).....	65
4.2.4.1. Dokumentacioni Teknik i Rrjeteve Numerike MUX 1 dhe MUX 2 .....	65
4.2.4.2. Dokumentacioni Teknik i Rrjeteve Numerike MUX 3, MUX 4 dhe MUX 5 .....	66

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

4.2.5. Përgatitja e specifikimeve teknike të marrësit numerik .....	67
4.3. Procedura e licencimit sipas “beauty contest” .....	67
4.3.1.Puna përgatitore për hartimin e rregullores .....	68
4.3.2. Rregullorja e licencimit sipas “beauty contest” .....	71
4.3.3 Ecuria e procedurës së licencimit sipas “beauty contest” .....	73
4.4 Puna për përgatitjen e kalimit në transmetimet numerike tokësore të operatorëve ekzistues analogë privatë lokalë .....	76
4.4.1 Impakti i RTSH-së në procesin e kalimit në transmetimet numerike tokësore .....	78
4.5 Drejtimi i procesit të digjitalizimit.....	79
4.5.1 Grupi i punës për studimin e mundësisë për rritjen e numrit të mbulimeve me rrjete numerike tokësore .....	79
5. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCIARE.....	81
5.1. Burimet njerëzore dhe administrative .....	81
5.2. Marrëdhëniet me jashtë.....	83
5.2.1. Rezultatet e projektit “Televizioni Digjital i Evropës Juglindore (SEE Digi TV)”, i financuar nga Bashkimi Evropian.....	86
5.3. Marrëdhëniet me publikun dhe grupet e interesit .....	88
5.4. Aktiviteti ekonomik dhe financiar .....	90
5.4.1 Të ardhurat .....	90
5.4.1.1. Realizimi i treguesve financiarë.....	91
5.4.1.2.Realizimi i zërit “Të ardhura” .....	91
5.4.1.3.Të ardhurat nga agjenti tatimor.....	94
5.4.2. Shpenzimet.....	95
5.4.2.1.Shpenzime korente.....	95
5.4.2.2. Shpenzimet për investime .....	96
5.5 Pasqyrat financiare të operatorëve radiotelevizivë .....	97

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

5.6 Gjobat.....	98
5.7 Rezultatet dhe rekomandimet e kontrollit të ushtruar nga KLSH.....	100
6. KONKLUSIONE.....	102

## 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Miratimi i ligjit të ri nr. 97/2013, datë 04.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” përbën momentin më të rëndësishëm në veprimtarinë e transmetimeve audiovizive për vitin 2013. Ky ligj, i cili është hartuar me asistencën dhe bashkëpunimin e ekspertëve të Komisionit Evropian, Këshillit të Evropës dhe OSBE-së, është i përafëruar plotësisht me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audiovizive 2010/13/BE. Ligji i ri sjell ndryshime dhe përmirësime në fushën e rregullimit të transmetimeve të medias elektronike, si dhe plotëson kuadrin e nevojshëm rregullator për kalimin e Shqipërisë nga transmetimet analoge në transmetimet numerike.

Kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike është një proces shumë i rëndësishëm, realizimi i të cilit, brenda afateve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare, krijon mundësitë për një pluralizëm më të madh në media. Për rrjedhojë, një autoritet rregullator audioviziv i pavarur luan një rol kyç në realizimin me sukses të këtij procesi.

Fusha e politikave audiovizive ka një rëndësi të veçantë në procesin e integritit të Shqipërisë në BE, për shkak të detyrimeve të rëndësishme që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA). Një nga standardet kryesore, që lidhen me këtë marrëveshje, është edhe garantimi i pavarësisë së autoritetit rregullator të medias, si dhe në përgjithësi, respektimi i politikave të Bashkimit Evropian në lidhje me modalitetet e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

Si vend anëtar i Këshillit të Evropës, Shqipëria ka detyrimin të respektojë legjislacionin dhe standardet e miratuara nga ky organizëm. Në mënyrë të veçantë, duhet të përmendet, në këtë aspekt, Rekomandimi i Komitetit të Ministrave Rec (2000) 23 mbi pavarësinë dhe funksionet e autoriteteve rregulluese të sektorit të transmetimeve, që u sugjeron shteteve anëtare, *“të parashikojnë dispozita në legjislacionin e tyre dhe masa në politikat e tyre, që i japin pushtet autoriteteve rregulluese të sektorit të transmetimit, duke i mundësuar ato të përmbushin misionet e tyre në mënyrë efikase, të pavarur dhe transparente, siç parashikohet nga ligji kombëtar, në përputhje me udhëzimet e parashtruara në shtojcën e këtij rekomandimi”*.

Zbatimi i akteve dhe rekomandimeve ndërkombëtare, si dhe i dispozitave ligjore, kërkon funksionimin normal të një organi kolegjal, vendimmarrjet e të cilit kushtëzohen, rast pas rasti, nga një shumicë e cilësuar, mungesa e së cilës e bën tepër të vështirë përmbushjen e

objektivave ligjore të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA). Ky shqetësim është ngritur në vijueshmëri nga AMA (ish KKRT) nëpërmjet komunikimit zyrtar me Kuvendin e Shqipërisë, që në datën 03 prill 2013. Kuvendit iu kërkua fillimi i procedurave ligjore për plotësimin e vendeve vakante të AMA-s<sup>1</sup>, kërkesë që, në tetor 2013<sup>2</sup>, iu përsërit edhe me fillimin e Legjislaturës së re.

Mosplotësimi i vendeve vakante të Autoritetit ka sjellë pengesa serioze dhe bllokim të vendimmarrjes për një tërësi aktesh rregullatore dhe vendimesh të tjera të rëndësishme, si vendimet për dhënien dhe heqjen e licencave dhe/ose autorizimeve, emërimi i Këshillit të Ankesave, miratimi i rregullores së brendshme dhe të një numri vendimesh të tjera që kërkojnë, sipas ligjit, një shumicë të cilësuar.

Vazhdimi i një situate të tillë krijon, ndërmjet të tjerash, vështirësi në respektimin e afateve kohore të vendosura nga legjislacioni kombëtar dhe aktet ndërkombëtare për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike (qershor 2015).

Zhvillimet e rëndësishme të ndodhura në fushën e medias në Shqipëri, si miratimi i Strategjisë Kombëtare për Kalimin nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, ligji i ri për mediat audiovizive, dhe realizimi i detyrimeve të parashikuara nga Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive (AVMSD), duhet të shoqërohen domosdoshmërisht me ndryshimet e nevojshme strukturore, për t'iu përgjigjur me efikasitet nevojave dhe kapaciteteve që kërkojnë këto zhvillime. Për këtë, miratimi nga Kuvendi i Shqipërisë i ndryshimeve strukturore të paraqitura nga AMA<sup>3</sup>, do të mundësonte pasjen e një strukture efikase dhe me fleksibilitet më të madh për të menaxhuar dhe zgjidhur problematikat aktuale të veprimtarisë audiovizive, duke qenë në një linjë me filozofinë rregullatore të disa vendeve të Bashkimit Evropian. Aktualisht, kjo strukturë nuk është miratuar ende nga Kuvendi i Shqipërisë.

Pavarësisht problematikave të lartpërmendura, në kuadër të zbatimit të dispozitave të ligjit të ri “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, AMA nisi punën për hartimin e të gjitha akteve të nevojshme nënligjore, si dhe procesin e këshillimit publik me të gjithë aktorët e interesuar për të gjitha ato akte rregullatore, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive.

---

<sup>1</sup> Shkresa nr. 781 prot., datë 03.04.2013

<sup>2</sup> Shkresa nr. 1564 prot., datë 01.10.2013

<sup>3</sup> Shkresat nr. 864 prot., datë 11.04. 2013 dhe nr. 1563 prot., datë 01.10.2013.

Kjo përjasje këshillimi publik, jo vetëm që rridhte si detyrim nga neni 48 i ligjit të sipërmendur, por është njëkohësisht në linjë me praktikën evropiane, e cila ka treguar se një tranzicion i harmonizuar drejt transmetimeve digjitale, kërkon një konsensus të gjerë ndërmjet aktorëve të interesuar. Gjatë gjithë vitit raportues, AMA ka qenë e angazhuar në hartimin e miratimin e akteve të nevojshme rregullatore, një pjesë e të cilave tashmë janë miratuar. Ndër to, përmendim akte me ndikim të drejtpërdrejtë, si Rregullorja e *beauty contest*-it dhe Kodi i Transmetimit, të cilat trajtohen në mënyrë të detajuar në vijim të këtij raporti.

Në përfundim, duhet të theksohet fakti se, procesi i kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike kërkon një autoritet rregullator, të cilit t'i garantohet integriteti dhe pavarësia. Integriteti dhe pavarësia e autoritetit rregullator përbëjnë garanci për vazhdimësinë e procesit, dhe shmangin vonesat në respektimin e afateve të vendosura nga legjislacioni kombëtar dhe aktet ndërkombëtare për kalimin në transmetimet numerike.

Për sa më sipër, AMA, bazuar në detyrat funksionale, ka vijuar veprimtarinë e vet për përmbushjen e objektivave dhe kërkesave për mbikëqyrjen e veprimtarisë audiovizive.



## 2. VEPRIMTARIA E KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR PERIUdhËN JANAR – 4 PRILL 2013

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (në vijim KKRT), gjatë periudhës janar – 4 prill 2013<sup>4</sup>, e ka kryer veprimtarinë e tij duke u mbështetur në kuadrin ligjor rregullues të veprimtarisë së fushës audiovizive, më konkretisht, në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9742, datë 28.05.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”.

Në bazë dhe në zbatim të këtyre akteve ligjore, KKRT brenda kompetencave të veta, ka miratuar disa ndryshime në akte nënligjore, të cilat kanë ndikuar në përmirësime të dukshme në aktivitetin e institucionit dhe kanë plotësuar kuadrin nënligjor të nevojshëm për të garantuar përmbushjen e objektivave të autoritetit.

Gjatë veprimtarisë së vet rregullatore e mbikëqyrëse, KKRT është fokusuar dhe përqendruar në përmbushjen e objektivave dhe funksioneve të veta, si kontrolli i zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues nga subjektet radiotelevizive dhe garantimi i konkurrencës së ndershme në fushën e mediave audiovizive. Kështu, gjatë kësaj periudhe funksionet e institucionit janë realizuar përmes miratimit të vendimeve për dhënien/heqjen apo rinovimin e licencave për transmetime radiotelevizive, trajtimin dhe shqyrtimin të ankesave të subjekteve të sanksionuar për kundërvajtje administrative. Aspekt tjetër i veprimtarisë administrative të KKRT-së është gjithashtu edhe ndjekja e proceseve gjyqësore, ndjekja e ekzekutimit të vendimeve etj.

KKRT gjatë periudhës raportuese, ka miratuar një sërë vendimesh të rëndësishme.

### 2.1. Përmirësimi i kuadrit nënligjor

Gjatë periudhës raportuese, KKRT ka miratuar disa ndryshime të domosdoshme në rregulloret ekzistuese, me qëllim përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit nënligjor për kontrollin dhe mbikëqyrjen e veprimtarisë audiovizive.

#### 1. Miratimi i ndryshimeve në rregulloren “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”.

KKRT, me vendimin nr. 17, datë 18.01.2013, ka miratuar disa ndryshime në rregulloren “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”.

<sup>4</sup> Datë e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”

Nëpërmjet këtij akti është shtuar detyrimi që të gjithë subjektet radio ose televizive analoge, satelitore apo kabllore të licencuara, kur paraqesin kërkesën për rinovim licence, të depozitojnë dokumentacionin e të drejtës së transmetimit të programeve (marrëveshje, kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi), dokumentacion, i cili duhet të jetë i certifikuar dhe i regjistruar paraprakisht në Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit. Qëllimi i miratimit të këtij ndryshimi ishte forcimi i luftës kundër fenomenit të piraterisë radiotelevizive, i cili ka qenë dhe mbetet shqetësim konstant për tregun audioviziv.

## 2. Miratimi i ndryshimeve në rregulloren “Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive”.

KKRT, me vendimin nr. 28, datë 01.02.2013, ka miratuar disa ndryshime në rregulloren, “Për licencimin e operatorëve të rrjeteve numerike tokësore e satelitore dhe të operatorëve për programet radiotelevizive”, miratuar me vendimin e KKRT-së nr. 696, datë 14.04.2008. Qëllimi i miratimit të këtyre ndryshimeve është përputhja e karakteristikave teknike të rrjeteve numerike, standardin e kompresionit etj., me standardet e vendosura në Strategjinë e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012. Respektimi i standardeve, të përcaktuara nga institucionet e specializuara, konsiderohet si kusht bazë për sigurimin e përputhshmërisë së pajisjeve që do të përdoren për ndërtimin e rrjeteve të transmetimeve televizive, duke siguruar cilësinë e dëshiruar dhe duke shmangur shpenzimet e tepërta për përshtatjen e pajisjeve. Në kushtet e ekzistencës së shumë operatorëve që do të ofrojnë rrjete numerike (lokale, rajonale e kombëtare), standardizimi i pajisjeve të rrjeteve siguron bashkëveprimin e tyre, aplikimin e guidave programore të përbashkëta, si dhe thjeshtimin e pajisjeve marrëse (ose set-top-bokseve). Pajisjet që përdoren në rrjetet e radiokomunikimit duhet të plotësojnë standardet e miratuara nga institucione të specializuara ndërkombëtare. Për pajisjet e telekomunikacioneve, ku bëjnë pjesë edhe pajisjet për ndërtimin e rrjeteve televizive, institucioni i specializuar është Instituti Evropian i Standardizimit të Telekomunikacioneve (ETSI - European Telecommunications Standardization Institute).

### **2.2. Licencimet**

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhënia e licencave për ushtrimin e veprimtarisë radiotelevizive ishte një nga funksionet kryesore të KKRT-së. Licencat jepeshin në bazë të kërkesave të subjekteve dhe disponibilitetit të frekuencave. KKRT, deri në datën 03 prill

2013, ka miratuar dhënien e licencës për veprimtari radiotelevizive për 6 subjekte, nga të cilat 4 operatorë radiofonikë privatë vendorë dhe 2 operatorë televizivë privatë mbështetur në rrjete kabllore.

### **2.2.1. Licencat Radio FM**

Mbështetur në kërkesat e palëve të interesuara, dhe pas kryerjes së studimit për disponibilitetin e frekuencave, KKRT ka miratuar vendimet për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë radiofonikë analogë vendorë si vijon:

1. Vendimi nr. 40, datë 01.02.2013, për rrethet Tiranë-Durrës (frekuenca 107.1 MHz);
2. Vendimi nr. 59, datë 20.02.2013, për rrethet Tiranë-Durrës (frekuenca 96.4 MHz);
3. Vendimi nr. 91, datë 27.03.2013, për qarqet Fier – Vlorë (frekuencat 104.4, 102.7, 88.9 dhe 88.6 MHz);
4. Vendimi nr. 161, datë 30.11.2012, për rrethin Tiranë (frekuenca 91.1 MHz).

Çelja e procedurës së konkurrimit për zonat e mësipërme është shpallur në mënyrë publike, në dy nga gazetatat e përditshme, si dhe në rubrikën e njoftimeve të operatorit publik RTSH.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, KKRT ka vendosur:

1. Licencimin e shoqërisë “J&P PRO” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, (*Radio Living*) në fushën e transmetimeve tokësore analogjike në rrethet Tiranë- Durrës (vendimi nr. 100, datë 03.04.2013);
2. Licencimin e shoqërisë “Vala 2013” sh.p.k, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, (*Radio Spektrum*) në fushën e transmetimeve tokësore analogjike në rrethet Tiranë- Durrës (vendimi nr. 101, datë 03.04.2013);
3. Zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “Radio Durrësi” sh.p.k., për radion vendore private “Radio Durrësi”, sipas licencës nr. 087/FML, në rrethin Tiranë dhe qarqet Fier-Vlorë (Vendimet nr. 37, datë 01.02.2013 dhe nr. 103, datë 03.04.2013).

### **2.2.2. Licencat për programet radiotelevizive me kabëll**

Bazuar në kërkesat e paraqitura nga subjektet e interesuara, me vendimet nr. 160, datë 30.11.2012 dhe nr. 85, datë 11.03.2013, KKRT ka vendosur të shpallë, në mënyrë publike, konkurrimin e kandidaturave për operatorë privatë radiotelevizivë kabllorë.

Bazuar në këto vendime, është shpallur në mënyrë publike çelja e procedurës së konkurrimit, në dy nga gazetatat e përditshme, si dhe në rubrikën e njoftimeve të operatorit publik RTSH.

Në përfundim të procedurës së konkurrimit, KKRT ka vendosur:

1. Licencimin e personit privat fizik Ervis Beqiri, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, (*TV Next Kabëll*) për të mbuluar Bashkinë Kamzë (vendimi nr. 36, datë 01.02.2013);
2. Licencimin e shoqërisë “Info Kabëll” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, (*TV Info Kabëll*) për të mbuluar rrethet Tiranë-Durrës (vendimi nr. 102, datë 03.04.2013).

### **2.2.3. Rinovimet**

Një tjetër kompetencë e KKRT-së, në përputhje me ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka qenë miratimi i vendimeve për rinovimin e licencave. Licencat për ushtrimin e veprimtarisë radiotelevizive kanë afate të përcaktuara me ligj dhe në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës, subjektet që kanë pasur interes për të vazhduar ushtrimin e veprimtarisë televizive, kanë paraqitur aplikimet përkatëse për rinovim licence. Shqyrtimi i këtyre kërkesave është bërë në mbështetje të parashikimeve ligjore dhe në zbatim të procedurave të përcaktuara në rregulloren “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 01, datë 29.01.2010 të KKRT-së.

Gjatë shqyrtimit të kërkesave për rinovimin e licencave është realizuar verifikimi i respektimit të kriterëve të përcaktuara në ligj, si realizimi i mbulimit të zonës së licencimit, (sipas territorit dhe sipas popullsisë) respektimi i kushteve të licencës për sa i përket programeve, detyrimet financiare për periudhën e ushtrimit të aktivitetit etj.

Subjektet, të cilave me vendim të KKRT-së gjatë periudhës raportuese, iu është rinovuar licenca, janë:

1. “Radio Alpo”;
2. “Radio Nacional”;
3. “Radio Club FM”;
4. “Radio RASH”;
5. “Radio Kontakt”;
6. “Radio Maria”;
7. “Radio Top Gold”;
8. “Radio 1”
9. “Radio Top Albania”

**2.2.4. Licenca të pavlefshme**

Për shkak të mosrespektimit të kushteve të licencës së miratuar, KKRT, ka bërë të pavlefshme licencat e disa subjekteve. Shumica dërmuese e vendimeve për pavlefshmëri janë dhënë për mosshlyerje të detyrimeve financiare.

Subjektet, të cilave iu është bërë licenca e pavlefshme, gjatë periudhës raportuese, janë:

1. “Radio Aldo 03” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
2. “Radio Magic Star” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
3. “Tv ABC” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
4. “Tv Shijak” (mosparaqitje e aplikimit për rinovim licence dhe mosshlyerje e detyrimeve financiare)
5. “Tv Tele 4” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
6. “Tv Arv” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
7. “Tv Kristal” (mangësi në dokumentacionin e paraqitur për rinovim licence)
8. “Tv Rex” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
9. “Tv D1” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
10. “Tv Futura Com” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
11. “Tv Flavio Cable” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
12. “Tv me kabëll Kamza” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
13. “Tv me kabëll Memaliaj” (mosparaqitje e aplikimit për rinovim licence dhe mosshlyerje e detyrimeve financiare)
14. “Tv me kabëll Elbasan” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
15. “Tv me kabëll Portëz” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
16. “Tv me kabëll Multivizion” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
17. “Tv me kabëll Kruja” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
18. “Tv me kabëll Voskop” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)
19. “Tv kabllor I-Miri Cable” (mosshlyerje e detyrimeve financiare)

**2.2.5. Miratimi i ndryshimeve në të dhënat e licencës**

Në periudhën raportuese, janë marrë një sërë vendimesh lidhur me miratimin e ndryshimeve në të dhënat e subjekteve të licencuara, në përputhje me nenet 22 dhe 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar. Në këto dispozita ligjore parashikohet detyrimi, që subjektet të njoftojnë KKRT-në, për çdo ndryshim të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës si: ndryshimet në pronësi, në administrimin apo drejtuesin e shoqërisë, emërtimin e radios ose televizionit, ndryshime në programet që transmeton, selinë apo adresën e subjektit, dhe të tjera kushte që kanë ndryshuar te subjekti, që nga momenti i licencimit.

Respektimi i këtij detyrimi ligjor i krijon mundësinë autoritetit rregullator të kontrollojë përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe kushteve të licencës nga ana e subjekteve, edhe kur ndryshojnë ndonjë nga të dhënat e tyre. Po ashtu, bëhet i mundur kontrolli dhe transparenca në pronësinë e licencës. Në këtë mënyrë realizohet roli mbikëqyrës i KKRT-së në kufizimet ligjore të pronësisë, që janë masat që sigurojnë dhe parandalojnë monopolet, përqendrimin dhe nxisin pluralizmin e medias.

Më konkretisht, në zbatim të këtyre dispozitave ligjore, janë miratuar vendimet e mëposhtme:

1. Vendimi nr. 56, datë 20.02.2013, me të cilin është vendosur kalimi i licencës së televizionit privat vendor “TV Klaudiana” te personi fizik Edlira Vogli;
2. Vendimi nr. 57, datë 20.02.2013, me të cilin janë miratuar disa ndryshime në licencën e miratuar për platformën numerike satelitore “Digitalb” (Ndryshime në strukturën programore);
3. Vendimi nr. 81, datë 11.03.2013, me të cilin janë miratuar disa ndryshime në të dhënat e subjektit privat Bilbil Hajdini (Ndryshime në emërtimin e televizionit kabllor);
4. Vendimi nr. 82, datë 11.03.2013, me të cilin janë miratuar disa ndryshime në të dhënat e shoqërisë “Radio Number One” sh.p.k., licencuar për radion private vendore “Radio Number One” (Ndryshime në pronësinë e kuotave të shoqërisë);
5. Vendimi nr. 84, datë 11.03.2013 me të cilin është miratuar kalimi i licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Epiri 2011” te subjekti person fizik Orjana Cenko;
6. Vendimi nr. 92, datë 27.03.2013 me të cilin janë miratuar disa ndryshime në të dhënat e subjektit radiofonik privat me përsëritës “CRI radio e Jashtme e Kinës“ (Ndryshimi i përfaqësuesit ligjor të subjektit).

### 2.3. Programacioni

Zbatimi i ligjshmërisë në përgjithësi dhe respektimi i parimeve themelore të ushtrimit të veprimtarisë radiotelevizive, ka qenë dhe mbetet synimi kryesor i monitorimit të strukturës programore, përmbajtjes, dhe sidomos të etikës së komunikimit në programet e llojeve të ndryshme të operatorëve radiotelevizivë, veçanërisht atyre kombëtarë. Në periudhën janar–prill 2013, janë marrë masa e janë mbajtur qëndrime për problematika të ndryshme të fushës së programacionit, të sugjeruara edhe nga publiku, organizmat e ndryshëm shtetërorë apo organizatat jo qeveritare. Këto problematika, të lidhura kryesisht me përmbajtjen dhe etikën e programeve audiovizive, janë të njohura dhe përfshijnë çështje që mbeten gjithnjë të mprehta dhe shqetësuese, si:

- Shkelja e të drejtës së privatësisë;
- Keqpërdorimi i gjuhës dhe dhunës në ekran;
- Cenimi i dinjitetit të fëmijëve në programet me dhe për fëmijë;
- Identifikimi i fëmijës e viktimave në programet informative e në intervistime;
- Keqpërdorimi i fjalorit dhe gjuhës në disa programe argëtuese;
- Transmetimi i disa filmave e programeve pa shenjat paralajmëruese;
- Shkeljet etike në reklamat, në komunikimet e ndryshme tregtare.

Për këto çështje, KKRT ka komunikuar me operatorët radiotelevizivë dhe ka bashkëpunuar me institucione dhe organizma të interesuara për zbatimin e ligjshmërisë dhe kërkesave etike në mbarëvajtjen dhe zbatimin e standardeve të transmetimit në programet audiovizive. Ndër to përmendim:

- *Tërheqje vëmendje* të gjithë operatorëve radiotelevizivë,<sup>5</sup> për respektimin e standardit letrar të gjuhës shqipe në transmetimin e reklamave.
- *Tërheqje vëmendje* për operatorët televizivë ABC News<sup>6</sup> dhe Tv Klan lidhur me transmetimet e reklamave të kafesë së markës “ama”, operatorit televiziv Supersonic për transmetimet e reklamës së kafesë të markës “Illy” dhe operatorit televiziv Tv Ora News për transmetimet e reklamës së kafesë të markës “Segafredo”, për shkak se, nuk kanë respektuar standardin letrar të gjuhës shqipe, janë bërë në gjuhë të huaj dhe në mungesë të subtitrimeve shqip<sup>7</sup>.

<sup>5</sup> Shkresa nr. 532 prot., datë 26.02.2013

<sup>6</sup> Shkresa nr. 253 prot. datë 04. 02. 2013

<sup>7</sup> Shkresa nr. 532 prot., datë 26.02.2013.

- *Tërheqje vëmendje* të gjithë operatorëve radiotelevizivë,<sup>8</sup> për shkak të transmetimit të reklamave të shoqërive të licencuara për zhvillimin e lojërave të fatit.
- *Kujtesë*<sup>9</sup> drejtuar të gjithë operatorëve radiotelevizivë, për shkelje etike në raportimin e gazetarit dhe për cenim të privatësisë së të miturve.
- *Tërheqje vëmendje*<sup>10</sup> për transmetim të reklamave të tërthorta për operatorët radiotelevizivë, A1 Report, Tv News 24 dhe Vizion Plus.
- *Tërheqje vëmendje*<sup>11</sup> TVSH-së, për respektimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me sponsorizimet.

Për periudhën raportuese, është vënë re një prirje drejt programeve informative, por janë shtuar edhe programet kulturore e argëtuese, dhe sidomos programet e emisionet që trajtojnë zhvillimet aktuale politike. Kjo ka ndikuar në larminë e cilësinë e programeve, duke shmangur njëtrajtshmëri dhe varfëri në programacion. Por, ndërkaq janë vënë re prirje për ndonjë program spekulues e komercial, larg interesave, formimit, kërkesave e shijeve të teleshikuesve. Veçanërisht programet për fëmijë janë të pakta në raport me programet kulturore e argëtuese, janë me mangësi në përmbajtje e me nivel jo të kënaqshëm në pikëpamje të gjuhës dhe etikës së transmetimeve audiovizive.

Duhet theksuar se pasurimi e zgjerimi i shumëllojshmërisë së programeve radiotelevizive, veçanërisht të operatorëve kombëtarë, ka ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e misionit edukues e formues të medias në përgjithësi. Përdorimi me efikasitet e profesionalizëm i teknologjisë së re mediatike ka rritur gjithashtu konkurrencën dhe standardet bashkëkohore të transmetimit. E ardhmja digjitale do të ndikojë edhe më tepër në përmbajtjen dhe etikën e shërbimeve që operatorët audiovizivë do t'i ofrojnë publikut.

Gjatë periudhës janar-mars 2013 janë monitoruar edicionet informative të operatorëve televizivë kombëtarë.

Më poshtë vijojnë tabelat me të dhënat e monitorimit për pasqyrimin e kohës së plotë dhe sinkron të subjekteve politike, kohës sinkron të figurave politike dhe tematikat e edicioneve informative.

---

<sup>8</sup> Shkresa nr. 507/1 prot. datë 15.03.2013

<sup>9</sup> Shkresa nr. 673 prot., datë 19 03. 2013

<sup>10</sup> Shkresa nr.711-713 prot., datë 26.03.2013

<sup>11</sup> Shkresa nr.714 prot., datë 26.03.2013



**Tab.1 Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qendrore**

<b>Koha e Plotë për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (koha në %)</b>			
	Nga	2013-01-01	2013-03-31
<b>Subjektet/Operatori</b>	<b>Top Channel</b>	<b>TV Klan</b>	<b>Televizioni Shqiptar</b>
Presidenti	1.31	1.66	3.10
Kryeministri	13.51	24.21	29.96
Qeveria	9.69	15.25	21.93
Parlamenti	3.64	5.76	6.59
Partia Demokratike	10.33	20.90	22.20
Partia Socialiste e Shqipërisë	42.93	16.86	8.63
Lëvizja Socialiste për Integrim	4.95	9.58	4.73
Partia Republikane	1.01	1.81	0.92
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.39	0.43	0.00
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.88	0.71	0.96
Kandidat i Pavarur	0.00	0.00	0.00
Aleanca Demokratike	0.00	0.00	0.13
Lëvizja Demokristiane	0.24	0.00	0.00
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0.00	0.22	0.00
Partia Agrare Ambientaliste	0.00	0.00	0.08
Partia Bashkimi Liberal Demokrat	0.00	0.20	0.11
Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	0.85	0.36	0.00
Partia Demokristiane	0.00	0.00	0.00
Partia e Ballit Kombëtar	0.00	0.00	0.00
Partia e Ballit Kombëtar Demokrat	0.00	0.00	0.16
Partia G99	0.00	0.00	0.00

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Partia Lëvizja e Legalitetit	0.00	0.07	0.32
Partia për Ligj dhe Drejtësi	0.22	0.00	0.00
Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	0.04	0.40	0.00
Partia Socialiste 91	0.08	0.00	0.00
Partia Komuniste e Shqipërisë	0.00	0.09	0.00
Partia Pensioniste	0.00	0.00	0.00
Partia Aleanca Kuq e Zi	5.62	0.00	0.00
Partia Fryma e Re Demokratike	4.25	0.40	0.00
Partia Aleanca Demokristiane	0.00	0.00	0.00
Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres	0.00	0.33	0.07
Bashkim Liberal Demokrat	0.00	0.00	0.00
Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	0.00	0.00	0.00
Aleanca Popullore	0.00	0.00	0.00
Aleanca Demokristiane	0.00	0.00	0.00
Partia Socialiste e Moderuar	0.00	0.00	0.00
<b>Shuma</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

**Tab.2 Koha sinkron për subjektet politike dhe institucionet qendrore**

<b>Koha Sinkron për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (koha në %)</b>			
	Nga	2013-01-01	2013-03-31
<b>Subjektet/Operatori</b>	<b>Top Channel</b>	<b>TV Klan</b>	<b>Televizioni Shqiptar</b>
Presidenti	0.28	0.83	2.12
Kryeministri	12.46	25.38	27.50
Qeveria	7.68	13.85	18.95
Parlamenti	0.73	2.73	2.54

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Partia Demokratike	13.12	27.85	30.74
Partia Socialiste e Shqipërisë	46.16	14.27	9.97
Lëvizja Socialiste per Integrim	5.28	10.03	5.29
Partia Republikane	0.79	1.47	0.69
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.33	0.52	0.00
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.61	0.66	1.14
Kandidat i pavarur	0.00	0.00	0.00
Aleanca Demokratike	0.00	0.00	0.21
Lëvizja Demokristiane	0.29	0.00	0.00
Lëvizja për Zhvillim Kombetar	0.00	0.24	0.00
Partia Agrare Ambientaliste	0.00	0.00	0.07
Partia Bashkimi Liberal Demokrat	0.00	0.24	0.14
Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	0.97	0.31	0.00
Partia Demokristiane	0.00	0.00	0.00
Partia e Ballit Kombetar	0.00	0.00	0.00
Partia e Ballit Kombetar Demokrat	0.00	0.00	0.27
Partia G99	0.00	0.00	0.00
Partia Lëvizja e Legalitetit	0.00	0.08	0.32
Partia për Ligj dhe Drejtësi	0.39	0.00	0.00
Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	0.09	0.44	0.00
Partia Socialiste 91	0.15	0.00	0.00
Partia Komuniste e Shqipërisë	0.00	0.00	0.00
Partia Pensioniste	0.00	0.00	0.00
Partia Aleanca Kuq e Zi	5.73	0.00	0.00
Partia Fryma e Re Demokratike	4.87	0.38	0.00
Partia Aleanca Demokristiane	0.00	0.00	0.00

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres	0.00	0.44	0.06
Bashkim Liberal Demokrat	0.00	0.00	0.00
Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	0.00	0.00	0.00
Aleanca Popullore	0.00	0.00	0.00
Aleanca Demokristiane	0.00	0.00	0.00
Partia Socialiste e Moderuar	0.00	0.00	0.00
<b>Shuma</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

**Tab.3 Koha sinkron për aktorët politikë**

<b>Koha sinkron për Aktorët Politikë (koha në %)</b>			
	Nga	<b>2013-01-01</b>	<b>2013-03-31</b>
<b>AKTORI SINKRON</b>	<b>TVSH</b>	<b>TV KLAN</b>	<b>TOP CHANNEL</b>
Bujar Nishani	1.11	0.83	0.28
Edi Rama	4.58	10.76	18.56
Ilir Meta	3.57	7.32	3.93
Lulzim Basha	0	0	0.18
Sali Berisha	38.33	35.28	18.28
Të tjerë	52.41	45.81	58.77
<b>Shuma</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

**Tab.4 Koha e plotë për temën e lajmit**

<b>Koha e Plotë për Temën e Lajmit (koha në %)</b>			
	Nga	<b>2013-01-01</b>	<b>2013-03-31</b>
<b>Temat</b>	<b>Top Channel</b>	<b>TV Klan</b>	<b>Televizioni Shqiptar</b>
Politikë	31.92	29.41	25.42
Veprimtaria e Presidentit	0.47	0.87	0.68
Veprimtari e Qeverisë	5.57	12.71	13.69
Veprimtari e Parlamentit	4.05	3.18	5.08
Veprimtari e Qeverisë Vendore	0.50	4.08	2.99
Veprimtaria e Drejtësisë	5.72	3.32	1.20
Sociale	10.37	13.68	24.45
Ekonomi	5.87	3.40	4.41
Kronika e Zezë / Rendi	5.50	5.50	0.97
Lajme nga Kosova / Rajoni	8.55	4.13	3.17
Lajme Ndërkombëtare	10.44	7.61	3.67
Art / Kulturë / Kuriozitetë	4.86	4.66	5.47
Sport	2.14	4.29	4.98
Të tjera	4.03	3.16	3.81
<b>Shuma</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

#### 2.4. Kontrolli i veprimtarisë së subjekteve

Gjatë periudhës raportuese, KKRT ka qenë aktive për të realizuar detyrimin ligjor të kontrollit të respektimit të kushteve të licencës, detyrim i cili është përmbushur nëpërmjet inspektimeve të herëpashershme të subjektet e licencuara. Objekti i kontrolleve ka qenë respektimi i kërkesave në fushën e programeve, përfshirë këtu reklamat, kushtet teknike, respektimin e të drejtës së transmetimit të programeve. Studioja e monitorimit në AMA, nuk ka kapacitet teknik të mjaftueshëm për të monitoruar gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari radio dhe televizive. Kjo studio monitoron vetëm subjektet që operojnë në zonën Tiranë-Durrës, duke mos arritur të realizojë mbikëqyrjen e përditshme të respektimit të kërkesave të ligjit nga subjektet e tjerë.

Ndaj subjekteve radio dhe televizive, kur janë konstatuar shkelje të ligjit dhe kushteve të licencës, janë vendosur sanksionet përkatëse. Transmetimi i programeve pa të drejta, është kundërvajtja administrative më e përsëritur dhe pjesa dërrmuese e sanksioneve gjobë të vendosura në vitin 2013, janë për mosrespektimin e të drejtës së transmetimit. Sanksione me gjobë janë vendosur edhe për kundërvajtje të tjera, si dalja në transmetim pa autorizimin/licencimin nga KKRT, moslejimi i hyrjes së inspektorëve në ambientet ku subjekti ushtron aktivitet, transmetimi në frekuenca të tjera të paautorizuara, mosnjoftimi i ndryshimeve të të dhënave, mosrespektimi i afateve të ruajtjes dhe regjistrimit të reklamave etj.

Bazuar në kompetencat ligjore, në rastet kur janë identifikuar subjekte, që kanë dalë në transmetim pa autorizimin/licencimin e KKRT-së, janë miratuar urdhrat për bllokimin me vulosje dhe sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të këtyre subjekteve.

Subjektet, ndaj të cilëve janë miratuar urdhra për bllokimin me vulosje dhe sekuestrimin e pajisjeve transmetuese, janë si më poshtë:

1. Urdhër nr. 37, datë 08.03.2013 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat vendor të palicencuar “Tv Shijak”;
2. Urdhër nr. 46, datë 25.03.2013 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të televizionit privat kabllor të palicencuar, në komunën Gosë të rrethit Kavajë”.

## **2.5. E drejta e transmetimit të programeve radiotelevizive**

Një mjet efikas, për garantimin e konkurrencës së ndershme në tregun mediatik, është mbikëqyrja nga KKRT e zbatimit të dispozitave ligjore lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit, mbrojtja dhe respektimi i të cilave përbën një nga detyrimet që Shqipëria duhet të plotësojë në kuadër të akteve ndërkombëtare, të cilat janë nënshkruar nga ana e saj. Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe lufta ndaj piraterisë televizive është detyrim ligjor, që rrjedh nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë e mediave elektronike në vendin tonë.

Neni 40/1 i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktonte detyrimin e operatorëve radio e televizivë për depozitimin e dokumentacionit të së drejtës së transmetimeve të programeve. Transmetimi i programeve pa të drejta, bazuar në nenin 137/4, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe ndëshkohet me sanksion me gjobë që varion nga 200.000 deri në 1.000.000 lekë.

Për të luftuar dukurinë e piraterisë televizive, KKRT, edhe përgjatë periudhës raportuese, ka vijuar bashkëpunimin dhe koordinimin e veprimtarisë, veçanërisht me Zyrën Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA). ZSHDA ka objekt të veprimtarisë, mbikëqyrjen dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të autorëve dhe të të drejtave të tjera, të lidhura me të, nga subjektet, persona fizikë/juridikë, private e publike, përdorues të pronësisë letrare, artistike shkencore.

Bazuar në kërkesat e ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 dhe ligjit nr. 9380, datë 28.4.2005 “Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të”, dokumentacioni i të drejtave të transmetimit (kontratë shitje, shkëmbimi, dhurimi), duhej të regjistrohej dhe certifikohet më parë në ZSHDA, e më pas të depozitohet në KKRT.

Edhe gjatë vitit 2013, ka vijuar puna për ndërgjegjësimin e operatorëve radiotelevizivë, mbi rëndësinë e respektimit të të drejtave të transmetimit dhe të autorit dhe zhdukjen e fenomenit të “piraterisë radiotelevizive”. Në mënyrë të përsëritur, KKRT u ka kërkuar subjekteve që ushtrojnë veprimtari radiotelevizive, nënshkrimin e kontratave me Agjencitë e licencuara të Administrimit Kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, të cilat janë përfaqësuese të ligjshme të autorëve/titullarëve të së drejtës.

Si rezultat i angazhimit të institucioneve, që kanë si objekt të veprimtarisë garantimin e të drejtës së autorit, gjatë vitit raportues konstatohet rritje e numrit të subjekteve që kanë nënshkruar kontrata për kalimin e të drejtës së transmetimit.

Më poshtë paraqitet lista e subjekteve radiotelevizive, të cilat kanë depozituar pranë institucionit, në periudhën janar–dhjetor 2013, vërtetim nga ZSHDA për përmbushjen e detyrimeve ndaj agjencive të administrimit kolektiv, si dhe subjektet që kanë depozituar pranë AMA-s autorizime nga këto agjenci.

Subjekte që kanë depozituar vërtetimin nga ZSHDA:

1. Radio Ime
2. Radio Energy
3. Radio Love
4. Radio Ora
5. Radio Alfa & Omega
6. Radio Kontakt
7. Radio 96.1
8. Radio Nacional
9. Radio Ngjallja
10. Radio Club fm
11. Radio Logos
12. City Radio Albania
13. Radio Travel
14. Radio Top Albania
15. Radio Scan
16. TV Elrodi
17. TV Lezha
18. TV 4+
19. TV Best
20. TV Mati
21. TV Bulqiza
22. TV kabllor Arten
23. TV kabllor Mamurras
24. TV kabllor Xhaçi
25. TV kabllor Toshkëz



## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

26. TV kabllor Cakrani
27. TV kabllor Ura Vajgurore
28. TV kabllor Lezha
29. TV kabllor Bulqiza
30. TV Tërbuf
31. TV kabllor Arten
32. TV kabllor Apollnet

### Subjekte që kanë depozituar autorizime nga agjencitë e administrimit kolektiv:

- |                              |                  |
|------------------------------|------------------|
| 1. Radio Love                | AKDIE            |
| 2. Radio 96.1                | AKDIE            |
| 3. Radio Nacional            | AMP              |
| 4. Radio Ngjallja            | AMP              |
| 5. Radio Club fm             | AKDIE            |
| 6. Radio Logos               | AMP              |
| 7. Radio Spektrum            | AMP              |
| 8. Radio Scan                | AMP              |
| 9. TV Lezha                  | AMP              |
| 10. TV AVN                   | AMP              |
| 11. TV 4+                    | AKDIE            |
| 12. TV Best                  | AKDIE, AMP, FMAA |
| 13. TV Mati                  | AMP              |
| 14. TV Kukësi                | AMP              |
| 15. TV kabllor Arten         | AKDIE, AMP, FMAA |
| 16. TV kabllor Orexh         | AMP              |
| 17. TV kabllor Ard&Net       | AMP, FMAA        |
| 18. TV kabllor Xhaçi         | AKDIE            |
| 19. TV Vlora Cable           | AMP              |
| 20. TV kabllor Toshkëz       | AKDIE, AMP       |
| 21. TV kabllor Vjosa         | AMP              |
| 22. TV kabllor Cakrani       | AMP, FMAA        |
| 23. TV kabllor Ura Vajgurore | AKDIE            |
| 24. TV kabllor Mati          | AMP              |
| 25. TV Maqellara             | AKDIE            |

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

26. TV kabllor Iliria	AKDIE, AMP
27. TV kabllor Pupa	AMP
28. TV kabllor Asparag	AMP
29. TV kabllor Kukës	AMP
30. TV kabllor Orikum	AKDIE
31. TV kabllor Divjaka	AKDIE
32. TV kabllor Kam	AKDIE
33. TV kabllor Danja	AKDIE
34. TV kabllor Lezha	AKDIE, AMP
35. TV kabllor Kuçova	AMP
36. TV kabllor TVM Devolli	AKDIE
37. TV kabllor Masa Grup	AMP
38. TV kabllor Lapardha	AKDIE
39. TV kabllor Lushnja	AMP, AKDIE.

Pavarësisht nënshkrimit të kontratave me agjencitë kolektive, një problem i ngritur vazhdimisht nga subjektet radiotelevizivë ka të bëjë me tarifat e aplikuara nga agjencitë e administrimit kolektiv, mbi vlerat e kontratave të blerjeve të të drejtave të transmetimit apo edhe certifikimit të tyre. Vendosja e tarifave reale dhe vjelja e tyre është e lidhur drejtpërdrejt edhe me shkallën e respektimit të të drejtave të autorit. Pikërisht në këtë drejtim kërkohet një bashkëpunim më i madh institucional midis AMA-s dhe ZSHDA-së.

Ligji i ri, ashtu sikurse ai i mëparshmi, parashikon disa dispozita në lidhje me respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të. Në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 97/2013 për respektimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me to, me vendimin e Këshillit të AMA-s nr. 21, datë 27.12.2013 është miratuar Rregullorja “Mbi procedurat e inspektimit/monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audiovizivë”. Në Kreun II të rregullores janë parashikuar rregulla të detajuara lidhur me procedurën e kryerjes së inspektimeve/monitorimeve, që kanë për objekt kontrollin e veprimtarisë programore të subjekteve, detyrimin e këtyre të fundit për të depozituar pranë AMA-s dokumentacionin për kalimin e të drejtës së transmetimit të programeve audio dhe/ose audiovizive, si dhe formën dhe afatet e depozitimit të tij.

Gjatë periudhës raportuese, inspektorët e KKRT-së, kanë vendosur 42 sanksione me gjobë për shkelje të nenit 137/4, pika 7, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe

televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, për shkak të transmetimit të programeve pa të drejta. Të gjitha sanksionet me gjobë, ankimimi i subjekteve dhe vendimet e KKRT-së pasqyrohen *në Aneksin I* të këtij Raporti.

## 2.6. Problematika në ekzekutimin e vendimeve

Sikurse e kemi vënë në dukje edhe në Raportet e viteve të kaluara, edhe në vitin raportues ka vijuar problematika për ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së. Neni 137/5 i ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, përcaktonte se organet shtetërore, të ngarkuara për ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së, duke pasur parasysh edhe ndryshimet në ligjin “Për Procedurat Tatimore”, janë Drejtoritë Rajonale Tatimore. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, midis KKRT-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit, e cila ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2011. Neni 2 i kësaj marrëveshjeje përcaktonte si objekt të saj pikërisht rregullimin e bashkëpunimit midis palëve, me qëllim mbështetjen e strukturave të KKRT-së, lidhur me ekzekutimin e vendimeve të marra ndaj subjekteve që shkelin legjislacionin e fushës. Vendimet e KKRT-së, ekzekutimi i të cilave kërkon patjetër mbështetjen e institucioneve të tjera ishin vendimet për heqjen e licencave, vendimet për mbylljen e stacioneve transmetuese dhe sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të subjekteve të ndryshme të licencuara apo jo, vendime të inspektorëve të kthyer në tituj ekzekutivë etj.

Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit, nga KKRT, janë njoftuar zyrtarisht Drejtoritë Rajonale Tatimore, duke ofruar, rast pas rasti, edhe ndihmën e nevojshme, nëpërmjet pranisë fizike të inspektorëve të KKRT-së. Megjithatë, bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë mes KKRT-së dhe Drejtorive Rajonale të Tatimeve nuk ka sjellë rezultatet e pritshme, pasi pjesa më e madhe e vendimeve të KKRT-së nuk janë ekzekutuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Përmirësime të dukshme për zgjidhjen e kësaj shtate kanë sjellë dispozitat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Ligji i ri, në nenin 80 përcakton që AMA bashkëpunon me autoritetet publike e lokale, përfshirë edhe Policinë e Shtetit dhe shërbimin përmbartimor për bllokimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të subjekteve të palicencuara ose të paautorizuara. Në dallim nga ligji i mëparshëm, ligji nr. 97/2013, parashikon se sanksionet me gjobë janë tituj ekzekutivë. Më konkretisht, sipas nenit 133 të ligjit nr 97/2013, “13. Gjoha është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbartimor dhe derdhet 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në buxhetin e AMA-s.” Bazuar

në këtë dispozitë ligjore, AMA kërkoi pranë gjykatave të rretheve të ndryshme gjyqësore lëshimin e titujve ekzekutivë për 103 sanksione me gjobë. Deri më tani, nga këto gjykata janë lëshuar titujt ekzekutivë për 56 sanksione me gjobë dhe për ekzekutimin e tyre janë nënshkruar kontratat me shërbimin përmbarimor.

Gjatë vitit 2013, disa nga vendimet e KKRT/AMA janë ankimuar në gjykatë. Po ashtu, KKRT/AMA ka investuar gjykatën në cilësinë e palës paditëse dhe kërkuese. Materiali i zgjeruar, për çështjet gjyqësore në proces, ku është palë KKRT/AMA, jepet në *Aneksin 2*.

## **2.7. Subjektet me transmetime të palicencuara**

### ***2.7.1. Transmetime analoge tokësore të palicencuara***

Siç është raportuar edhe në vitet paraardhëse, edhe këtë vit, vazhdojnë transmetimet e palicencuara të disa operatorëve televizivë vendorë. KKRT, gjatë periudhës raportuese ka pasur prioritet përgatitjen e elementeve teknike të zbatimit të Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në ato Numerike, përcaktimin e frekuencave për operatorin publik dhe licencimin e rrjeteve numerike të operatorëve kombëtarë dhe lokalë. Me përfundimin e këtij procesi, me mbylljen e transmetimeve analoge do të zgjidhet përfundimisht çështja e transmetimeve të palicencuara.

Subjektet me transmetime analoge të palicencuara, zonat e licencimit dhe zonat e paautorizuara të mbulimit të subjekteve të mësipërm jepen në *Aneksin 3/1*.

### ***2.7.2. Transmetimet numerike të paautorizuara***

Transmetimet numerike tokësore të palicencuara janë të pranishme në Shqipëri prej 10 vitesh. Me gjithë përpjekjet e KKRT-së, licencimi i tyre nuk është kryer, për shkak të mungesës së kuadrit të plotë ligjor.

Më poshtë paraqitet panorama e rrjeteve numerike në territorin e Shqipërisë, realitete të cilat janë marrë në konsideratë nga ligji nr.97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

#### ***2.7.2.1. Digitalb***

Shoqëria "Digitalb" ka filluar transmetimet prej korrikut 2004, pa licencën e KKRT-së. Sot "Digitalb" ka stacione të instaluar në 8 pika transmetimi, (Dajt, Tarabosh, Kodra e Marinës, Petresh, Zvërnec, Ardenicë, Çardhak dhe Tushemisht) të cilat transmetojnë në kanalet 62, 64,

67 dhe 69. Kanalet e okupuara bëjnë pjesë në brezin e caktuar për Dividentin Digjital (DD1) dhe duhet të lirohen brenda datës 17.06.2015.

Ky operator ofron një paketë programesh numerike të mbështetura në sisteme numerike tokësore (4 rrjete fikse). Kanali 29, që përdorej për transmetime DVB-H, aktualisht përdoret në rajonin Tiranë-Durrës për eksperimentimin e transmetimeve numerike në sistemin DVB-T2.

Zonat e mbulimit të subjektit “Digitalb” jepen në *Aneksin 3/2*.

Shoqëria “Digitalb”, e licencuar si platformë private numerike satelitore, ripërsërit një numër programesh, që transmetohen në rrjetin numerik tokësor të palicencuar.

#### **2.7.2.2. Tring**

Siç është raportuar edhe në raportet paraardhëse, shoqëria “Tring” prej vitit 2008 ka ndërtuar sistemin numerik tokësor, dy rrjete fikse, për të cilat përdor dy kanale UHF, (Kanalin 59 dhe kanalën 47), nëpërmjet stacioneve transmetues, të instaluar në malin e Dajtit, duke mbuluar zonën Tiranë-Durrës.

Në vitin raportues, shoqëria “Tring” ka zgjeruar mbulimin me sinjale numerike edhe në rrethet Burrel, Peshkopi, Kukës, Shkodër.

Zonat e mbulimit të subjektit “Tring” jepen në *Aneksin 3/2*.

Shoqëria “Tring”, e licencuar si platformë private numerike satelitore ripërsërit një numër programesh që transmetohen në rrjetin numerik tokësor të palicencuar.

**2.7.2.3. Transmetimet numerike në rajonin Tiranë- Durrës**

Gjendja e transmetimeve numerike në rajonin Tiranë-Durrës deri në fund të vitit 2013 dhe okupimi i kanaleve jepet nga tabela e mëposhtme:

Nr	Kanali	Emri i TV	Sistemi	Modulimi	G. Int
1.	21	Albanian Screen MUX 1	DVB-T	64 QAM	1/16
2.	66	Albanian Screen MUX 2	DVB-T	64 QAM	1/16
3.	62	Digitalb MUX 1	DVB-T	64 QAM	1/8
4.	64	Digitalb MUX 2	DVB-T	64 QAM	1/8
5.	67	Digitalb MUX 3	DVB-T	64 QAM	1/8
6.	69	Digitalb MUX 4	DVB-T	64 QAM	1/8
7.	29	Digitalb MUX 5	DVB-T2	256 QAM	1/128
8.	41	Klan MUX 1	DVB-T	64 QAM	1/32
9.	31	News 24 MUX 1	DVB-T	64 QAM	¼
10.	55	Ora News MUX 1	DVB-T	64 QAM	1/8
11.	53	RTSH MUX 1	DVB-T	64 QAM	1/8
12.	51	Top Channel MUX 1	DVB-T	64 QAM	?
13	47	Tring MUX 1	DVB-T	64 QAM	1/32
14	59	Tring MUX 2	DVB-T	64 QAM	1/32
15	56	Tring MUX 3	DVB-T	64 QAM	1/16

Shënim: Kanalet me ngjyrë blu janë pjesë e PNSH<sup>12</sup>.

Sistemet që përdorin operatorët e ndryshëm numerikë të palicencuar, në territorin e Shqipërisë, janë kryesisht **DVB-T/MPEG 2**, ku mbështeten deri në 10 programe. Bën përjashtim platforma “Digitalb”, i cili në rajonin Tiranë-Durrës ka okupuar kanalën 29 UHF dhe transmeton në sistemin DVB- T2 (Modulimi 256 QAM, G.I 1/16), ku mbështet 9 programe, të gjitha në HD me përjashtim të kanalit “Ndhima e klientit”. (Film 1 HD, Film 2 HD, SS1 HD, SS2 HD, Travel Channel HD, SS4 HD, Plus HD, SS3 HD, Ndhima e Klientit).

<sup>12</sup> Plani Numerik Shqiptar

**2.7.2.4. Transmetime numerike të verifikuara gjatë 2013-ës**

Gjatë vitit raportues, nga monitorimi në terren, kryer në periudhën dhjetor 2013 – janar 2014, AMA ka konstatuar se, përveç transmetimeve numerike të palicencuara, të konstatuara në vitet paraardhëse, është evidentuar një numër kanalesh të okupuara me transmetime numerike nga operatorë të ndryshëm:

**Kukës**

Kanali	TV	Niveli (dB $\mu$ V)	Modulimi	Drejtimi
44	Tring	54	DVBT	Kukës
45	Top Channel	54	DVBT	Kukës
47	TV Kukësi	52	DVBT	Kukës
48	Digitalb	48	DVBT	Kukës

Kanalet e mësipërme nuk bëjnë pjesë në PNSH

**Homesh (Peshkopi)**

Kanali	TV	Niveli (dB $\mu$ V)	Modulimi	Drejtimi
47	Tring	40	DVBT	Peshkopi

Kanali i mësipërm nuk bën pjesë në PNSH

**Sarandë**

Kanali	TV	Niveli (dB $\mu$ V)	Modulimi	Drejtimi
26	Kanale të Digitalb	40	DVBT	Lëkurës

Kanali i mësipërm nuk bën pjesë në PNSH

**Burrel**

Kanali	TV	Niveli (dB $\mu$ V)	Modulimi	Drejtimi
42	Tring	70	DVBT	Burrel
43	Mat TV	72	DVBT	Burrel
44	Kanal i pidentifikueshëm	42		Perëndim

Kanalet e mësipërme nuk bëjnë pjesë në PNSH.

Si konkluzion, situata e transmetimeve numerike tokësore vazhdon të jetë krejtësisht e parregulluar, për pasojë e pakontrolluar. Operatorët e transmetimeve numerike tokësore, operojnë pa licencat përkatëse, në të cilat do të përcaktoheshin rregullat dhe kushtet e shërbimit, si dhe detyrimet përkatëse financiare, duke shtrembëruar në këtë mënyrë tregun, në dëm të operatorëve të tjerë.

## **2.8. Mbulimi me sinjal analog tokësor i zonës së mbulimit**

Mbështetur në kompetencat ligjore, KKRT ka monitoruar, edhe përgjatë vitit raportues, respektimin nga operatorët privatë, por edhe nga RTSH, të detyrimit për mbulimin me sinjal të zonës së licencimit (në rastin e RTSH-së të territorit të Republikës së Shqipërisë).

Për shkak të konfiguracionit të thyer të terrenit shqiptar, ekziston një numër i madh zonash që nuk mbulohen me sinjal analog nga pikat ekzistuese të transmetimit (zona e Tropojës, Hasit, Fushë Arrësit, Bulqizës, Burrelit, Klosit, Bushat–Barbullushit, Përrenjasit, Përmetit, Ersekës, Gramshit, Leskovikut, Çorovodës etj.). Në këto zona merret, me nivel të ulët, vetëm një numër i kufizuar kanalesh, kryesisht kombëtarë. Gjatë vitit 2013, inspektimet kanë evidentuar edhe zona ku mungojnë edhe sinjalet e operatorëve analogë privatë kombëtarë, siç është zona e Skraparit, ku matjet kanë evidentuar se i vetmi kanal i shfrytëzuar nga gjithë spektri i transmetimeve audiovizive është kanali E 6 i zënë nga operatori publik (TVSH). KKRT vazhdimisht u ka kërkuar operatorëve privatë lokalë dhe kombëtarë respektimin e kushteve të licencës, lidhur me mbulimin e zonës së licencimit. Por duhet theksuar se, subjektet ekzistuese, të informuara mbi ndryshimin e kuadrit ligjor dhe mbi kalimin e pritshëm në transmetimet numerike, përgjatë vitit raportues, nuk kanë kryer investime për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonës së tyre të licencimit. Mbulimi i realizuar nga operatorët radio e televizivë, në zonën e tyre të licencimit, jepet nga hartat bashkëngjitur në *Aneksin 3/3*.

Të dhënat e mbledhura nga matjet e kryera për verifikimin e zonave të mbulimit, do të përdoren për planifikimin e rrjeteve numerike kombëtare dhe lokale.

### **2.8.1. Televizioni publik (RTSH)**

Siç është raportuar edhe në vitet paraardhëse, RTSH ka në funksionim 36 transmetues VHF, 29 transmetues UHF dhe një rrjet sekondar prej 210 përsëritësish.

Gjatë periudhës raportuese, TVSH nuk ka njoftuar ndryshime apo shtesa në numrin e transmetuesve apo përsëritësve.



Kombinimi i mbulimeve të realizuara nga transmetuesit, që emetojnë sinjal në VHF, transmetuesit e rrjetit primar në UHF dhe përsëritësve, bëjnë që mbulimi i territorit të Republikës me sinjalin e RTSH të arrijë në mbi 87 %.

Problem kryesor, edhe gjatë këtij viti, vazhdon të mbetet bashkërendimi i punës me organet e pushtetit lokal për mirëmbajtjen e përsëritësve (mungesë godinash, linjash elektrike dhe pagesa kujdestarësh).

RTSH, për shkak të ndryshimit të kuadrit ligjor dhe zbatimit të Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, përgjatë vitit raportues, nuk ka kryer investime për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonës së mbulimit.

Mbulimi i realizuar nga RTSH jepet në *Aneksin 3/3*.

### **2.8.2. Operatorët privatë kombëtarë**

Nga inspektimet e kryera gjatë vitit është konstatuar që disa stacione transmetuese të operatorëve privatë kombëtarë, në pika të caktuara, kanë rezultuar jashtë funksionit.

Subjekti radiofonik privat kombëtar “Radio +2”, edhe gjatë vitit 2013, ka pasur probleme në sigurimin e transmetimeve sistematike në disa zona të vendit. Nga inspektimet e kryera janë konstatuar mungesa të sinjalit të këtij subjekti, sidomos në zona të largëta.

Subjekti televiziv privat kombëtar “Klan” ka instaluar një numër transmetuesish në territorin e vendit (38 pika transmetimi) që mund të sigurojnë mbulimin e 78 % të territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal.

Subjekti televiziv privat kombëtar “Top Channel” ka instaluar një numër transmetuesish në territorin e vendit (34 pika transmetimi), që mund të sigurojnë mbulimin e 79% të territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal.

Por, gjatë inspektimeve të kryera për shfrytëzimin e spektrit, është konstatuar se disa stacione transmetuese të këtyre subjekteve nuk kanë qenë në funksionim. Kjo gjendje redukton përkohësisht zonën e mbulimit. Megjithatë, për të arritur në përfundime të sakta është i nevojshëm monitorimi i përditshëm i gjendjes reale të stacioneve transmetuese të subjektit. AMA, përveç zonës Tiranë-Durrës, aktualisht nuk ka kapacitete të mjaftueshme teknike për të monitoruar në kohë reale gjendjen e stacioneve transmetuese në gjithë territorin e vendit.

Mbulimi sipas pikave të transmetimit të dhëna në licencë për televizionet “Klan” dhe “Top Channel” jepet në *Aneksin 3/3*.

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Programet e televizioneve “Klan” dhe “Top Channel”, duke u mbështetur edhe në platformën satelitore dhe rrjetin numerik tokësor të shoqërisë “Digitalb”, mbulojnë gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### 3. VEPRIMTARIA E AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE GJATË PERIUDHËS PRILL-DHJETOR 2013

#### 3.1. Aktet e reja nënligjore

Një nga detyrat kryesore të Autoritetit të Mediave Audiovizive (në vijim AMA) në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, është hartimi i akteve nënligjore për plotësimin e kuadrit të nevojshëm për të garantuar përmbushjen e objektivave të AMA-s. Aktet nënligjore janë hartuar nga specialistë të AMA-s të organizuar në grupe pune sipas fushave përkatëse. Për hartimin e disa prej projektregulloreve më të rëndësishme, si rregullorja për licencimin e rrjeteve numerike sipas procedurës “*beauty contest*” dhe rregullorja për planin e renditjes së shërbimeve mediatike audiovizive, është bashkëpunuar edhe me ekspertë të huaj. Bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 97/2013, sipas të cilit “1. AMA, në procesin e përgatitjes së dokumenteve rregullatore, sipas kërkesave të këtij ligji, dhe përpara marrjes së vendimeve, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive, është e detyruar të marrë dhe të vlerësojë mendimin e palëve të interesuara nëpërmjet këshillimit publik”, procesi i hartimit të akteve nënligjore rregullatore i është nënshtruar konsultimit të gjerë publik, në të cilin, palët e interesuara kanë patur mundësinë të paraqesin sugjerime e propozime konkrete.

Aktet nënligjore të miratuara gjatë kësaj periudhe, renditen më poshtë:

1. Rregullorja “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës “*beauty contest*”<sup>13</sup>.

2. Rregullorja “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve”

AMA me vendimin nr. 3, datë 03.05.2013 ka miratuar rregulloren “Për kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimeve”. Ligji i ri për median, në dallim nga ligji i mëparshëm, parashikon që ofrimi i shërbimeve të programeve audio dhe audiovizive që mbështeten në rrjete kabllore, satelitore dhe shërbim online bëhet me autorizim të AMA-s, pa konkurrim, mbi bazën e kërkesës. Në këtë rregullore përcaktohen rregullat, kriteret dhe kërkesat juridike, financiare, programore dhe teknike që duhet të ndiqen dhe përmbushen nga subjektet e interesuara, për t’u pajisur me autorizimin përkatës për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv. Kjo rregullore është hartuar në zbatim të nenit 19 dhe nenit 64 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>13</sup> Kjo rregullore trajtohet hollësisht në Kreun 4.

Rregullorja parashikon llojet e autorizimeve për ofrimin e shërbimit të programit audio dhe audioviziv duke i klasifikuar në:

- a) satelitor, kur shërbimi mbështetet në një sistem satelitor;
- b) kabllor, kur shërbimi mbështetet në një sistem kabllor;
- c) shërbim online, kur shërbimi mbështetet në internet;
- d) ofrues shërbimi, përfshirë shërbimin e aksesit të kushtëzuar.

Rregullorja parashikon kërkesat që duhet të përmbajë aplikimi për marrje autorizimi si: dokumentet që vërtetojnë personalitetin juridik të aplikuesit, dokumentet që vërtetojnë të dhëna zyrtare e bankare mbi kapitalin financiar, emërtimin e programit dhe të rrjetit ku do të mbështetet, objektin dhe karakteristikat e përgjithshme të shërbimit, të dhëna për kohëzgjatjen e programeve dhe territorin që do të mbulojë, si dhe projektin teknik të instalimit dhe shfrytëzimit të aparaturave, përmbajtjen e programeve që do të transmetohen dhe strukturën programore të propozuar për transmetim etj. Në rregullore parashikohen rregullat e zbatueshme për shqyrtimin e aplikimeve. Gjithashtu, përcaktohet detyrimi për krijimin e Regjistrimit të Autorizimeve, ku do të pasqyrohen të dhënat për subjektet e autorizuar. Afatet e vlefshmërisë së autorizimeve për shërbimin audio dhe audioviziv janë 5 vjet.

### 3. Vendimi nr. 4, datë 22.05.2013 “Mbi miratimin e pagesave për licencë”

Neni 25 i ligjit nr. 97/2013, përcakton se:

*“1. Me qëllim mbulimin e shpenzimeve të nevojshme për realizimin e funksioneve të veta, AMA cakton me vendim të veçantë të gjitha pagesat për licencat dhe/ose autorizimet e ofruesve të transmetimeve audio dhe shërbimeve të programeve audiovizive, shërbimet e tjera si dhe pagesat për përpunimin administrativ...”.*

Mbështetur në dispozitën e mësipërme, AMA, në këtë vendim, ka respektuar parimet e objektivitetit, transparencës, jodiskriminimit dhe proporcionalitetit. Për llogaritjen e pagesave për licencë është marrë i pandryshuar numri aktual i operatorëve të rrjeteve analoge tokësore, si dhe zona në të cilën ata operojnë. Përllogaritja konsideron kalimin tërësor e të njëkohshëm të operatorëve nga rrjetet analoge në ato numerike dhe ka mbajtur parasysh edhe diversifikimin e përcaktimit të pagesave në raport me numrin e popullsisë së zonës së licencimit, nivelin ekonomik të zonave përkatëse, duke përdorur si burime informacioni të dhënat zyrtare të Ministrisë së Brendshme dhe INSTAT. Gjithashtu, është marrë në

konsideratë mënyra e shpërndarjes së sinjalit dhe mbulimi i popullsisë me sinjal sipas 11 allotmenteve. Po ashtu, është bërë kujdes në përcaktimin e drejtë të raporteve midis shërbimeve të ndryshme që licencohen, për promovimin e shërbimeve më me interes për publikun (shërbimet që ofrohen pa pagesë etj).

Në llogaritjen e pagesave vjetore për licencë është mbajtur parasysh kërkesa e ligjit, që të ardhurat e mbledhura nga licencimet të plotësojnë vetëm nevojat për funksionimin e autoritetit, duke bërë rishikimet përkatëse gjatë viteve.

Përcaktimi i pagesave për licencë është mbështetur në të dhënat financiare të disa prej operatorëve kombëtarë dhe vendorë ekzistues.

Më poshtë jepen disa nga pagesat vjetore të miratuara për licencat e transmetimit numerik dhe licencat e shërbimit të programit me mbulim kombëtar dhe rajonal<sup>14</sup>.

**a. Masa e pagesës vjetore për licencë kombëtare transmetimi numerik tokësor audioviziv (rrjet+programe)**

- Pagesë vjetore për licencë transmetimi audioviziv 15,800,000 lekë

**b. Masa e pagesës vjetore për licencë kombëtare shërbimi programi audio dhe audioviziv (vetëm programe)**

- Pagesë vjetore për licencë shërbimi programi audioviziv 1,700,000 lekë
- Pagesë vjetore për licencë shërbimi programi audio mbështetur në rrjete numerike audiovizive (DVB-T2) 200,000 lekë

**c. Masa e pagesës vjetore për licencë rajonale transmetimi numerik tokësor audio dhe audioviziv dhe audio analoge (rrjet+programe)**

Nr	Zonat	Transmetime audio	Transmetime audiovizive	Pagesa për operatorët Audio FM
1	Qark me popullsi deri në 250.000 banorë	60000	700000	21500
2	Qark me popullsi deri në 400.000 banorë	120000	1400000	34300
3	Qark me popullsi mbi 400.000 banorë	140000	1700000	40000
4	Për Tiranën dhe Durrësin	400000	4500000	140000
5	Vetëm për qytetin e Tiranës	60000	---	42300

<sup>14</sup> Tabelat e plota të pagesave për licencë jepen në *Aneksin 4/1*.

**d. Masa e pagesës vjetore për licencë shërbimi programi audio dhe audioviziv mbështetur në një rrjet rajonal numerik tokësor (vetëm program)**

Nr	Zonat	Transmetime audio	Transmetime audiovizive
1	Qark me popullsi deri në 250.000 banorë	30000	230000
2	Qark me popullsi deri në 400.000 banorë	40000	460000
3	Qark me popullsi mbi 400.000 banorë	88000	560000
4	Për Tiranën dhe Durrësin	250000	1500000
5	Vetëm për qytetin e Tiranës	45000	---

4. Vendimi nr. 5, datë 22.05.2013 “Mbi miratimin e pagesave për autorizim”

Për llogaritjen e pagesave vjetore për autorizim është marrë i pandryshuar numri aktual i operatorëve kabllorë, si dhe zona në të cilën ata operojnë, numri i familjeve, numri i abonentëve, mesatarja e të ardhurave vjetore etj. Për zonat me numër të njëjtë popullsie janë vendosur tre nivele pagesash, sipas numrit të programeve që ripërsëriten: deri në 20 programe; nga 21 deri në 40 programe dhe mbi 41 programe.<sup>15</sup>

5. Vendimi nr. 6, datë 22.05.2013 “Mbi miratimin e pagesave për shërbimet që kryhen nga Autoriteti i Mediave Audiovizive”

Në këtë vendim përcaktohet masa e pagesave për shërbime të ndryshme që kryhen nga AMA, si p.sh. për përgatitjen e dokumentacionit në rastin e aplikimit për licencë/autorizim, për lëshimin e materialeve autentike të transkriptuara, të cilat janë llogaritur bazuar në kostot administrative për përgatitjen e tyre.

6. Rregullorja “Mbi procedurat e inspektimit/monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv”.

AMA, me vendimin nr. 21, datë 27.12.2013, ka miratuar rregulloren "Mbi procedurat e inspektimit/monitorimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audioviziv". Me miratimin e saj, është plotësuar kuadri nënligjor për monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të subjekteve audiovizive. Në këtë rregullore parashikohen rregulla të detajuara për kryerjen e inspektimit, personat që kanë

<sup>15</sup> Tabelat me pagesat e miratuara për autorizimet jepet në *Aneksin 4/2*.

tagër për kryerjen e kontrollit, kohëzgjatjen e procedurave të kontrollit dhe të drejtat e subjekteve që inspektohen. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe procedurave për realizimin e të drejtës së të licencuarve dhe/ose të autorizuarve, në rastin kur AMA ushtron kontroll të veprimtarisë audiovizive të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Në krerët e rregullores, janë të përcaktuara shkeljet kryesore të ligjit, në fushën ekonomiko-financiare, të programacionit, të teknikës, si dhe veprimet që duhet të ndërmarrin specialistët (inspektorët) e AMA-s, për çdo rast konkret, sanksionet përkatëse si dhe procedurat dhe mjetet për ekzekutimin e tyre.

Bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, në përmbushje të detyrimit të këshillimit publik, ky projektakt i është përcjellë për mendim të gjithë subjekteve audio dhe audiovizive, por deri në datën e miratimit të rregullores, asnjë subjekt nuk depozitoi ndonjë koment apo sugjerim lidhur me të. Për marrjen e mendimit të palëve të interesuara dhe me qëllim përmirësimin e dispozitave të projektregullores, AMA, në datën 25.07.2013, ka zhvilluar tryezë të përbashkët me palët e interesuara.

## 7. Kodi i Transmetimit

Kodi i transmetimit, si akti më i rëndësishëm nënligjor, i hartuar për herë të parë, përveçse përmbush një detyrim ligjor, mbështetet në parimet themelore të veprimtarisë së transmetimeve audiovizive, në standardet më të arrira profesionale bashkëkohore, në normat dhe kërkesat morale dhe etike, si dhe në praktikën e deritanishme të veprimtarisë audiovizive në vendin tonë. Ai mban parasysh rolin e rëndësishëm të ofruesve të shërbimit mediatic audioviziv, si dhe rolin e funksionin e AMA-s si autoritet rregullator në fushën e transmetimeve audiovizive. Kodi i Transmetimit synon rregullimin e veprimtarisë audiovizive, pothuaj në të gjithë gamën e saj të shumanshme e të larmishme në stadin aktual. Kodi është strukturuar në seksione të ndryshme që përfshijnë parime e rregulla për programet informative, për mbrojtjen e të miturve në programet e të gjitha llojeve, kundër dhunës së skajshme në ekran, për komunikimet e ndryshme tregtare, respektimin e dinjitetit, mbrojtjen e të dhënave personale e të personave me aftësi të kufizuar, veprimtarinë e Këshillit të Ankesave etj. Kodi i Transmetimit është miratuar me vendimin e AMA-s nr.1, datë 27.01.2014.

Ky akt nënligjor, iu nënshtrua një procesi këshillimi publik disamujor, që përfshiu publikimin e projektit në faqen zyrtare të AMA-s, organizimin e konferencave të posaçme me grupet e

interesit në datat 25.07.2013 dhe 24.01.2014. Pjesëmarrës në këto takime ishin përfaqësues të OSHMA-ve, organizmave shtetërorë, organizatave e shoqatave të gazetarëve të medias audiovizive dhe asaj të shkruar. Kodi i Transmetimit është në përputhje me përcaktimet e akteve të legjislacionit shqiptar të fushës dhe është hartuar në bazë të kërkesave që lidhen me veprimtarinë audiovizive në Bashkimin Evropian, parashikuar nga Direktiva 2010/13 e BE-së.

Ndërkohë AMA, në zbatim të detyrimeve ligjore ka hartuar edhe projektakte të tjera, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të saj. Po ashtu, në kuadër të këshillimit publik janë zhvilluar disa konferenca e takime, ku është diskutuar mbi përmbajtjen e dispozitave të këtyre projektakteve, me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga grupet e interesit.

Më poshtë renditen projektregulloret, disa prej të cilave janë në proces miratimi ose në procesin e këshillimit publik.

1. *Projektregullore “Për planin e renditjes së shërbimeve mediatike audiovizive që mbështeten në rrjete numerike”*. Detyrimi për miratimin e këtij akti buron nga neni 86 i ligjit nr. 97/2013 dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike”. Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i planit të renditjes dhe procedurës së caktimit të dhënies së numrit identifikues për ofruesit e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv. Sipas projektregullores, formati i planit shqiptar të renditjes do të përbëhet nga 3 shifra, duke filluar nga: 000 deri në 999. Plani ndahet në 10 segmente. Shërbimeve të tjera të sistemit si Udhëzuesit Elektronik të Programit, programeve mozaike etj, u rezervohen numrat 000, 100, 200, 300, 400, 500, 600, 700, 800 dhe 900. Në projektregullore është përcaktuar struktura e programeve dhe struktura e segmenteve. Në segmentin I, II, V dhe VI, do të renditen programet që transmetohen pa pagesë (hapur). Këto programe do të jenë kombëtare, rajonale, lokale, të përgjithshme ose tematike, sipas rendit: 1. Fëmijë & Rini; 2. Filma, 3. Serialë & Telenovela, 4. Dokumentar & Shkencë; 5. Muzikë; Lifestyle & Reality; 6. Programe të mbartura të huaja; 7. Shqip, programe shqiptare; 8. Sport; 9. Informacion. Teleshitje. Në segmentet III, IV, IX dhe X do të renditen programet që do të transmetohen me pagesë (akses të kushtëzuar). Edhe këto programe do të jenë programe kombëtare, rajonale dhe lokale sipas rendit 1. Të përgjithshëm; 2. Fëmijë & Rini; 3. Filma, 4. Serialë & Telenovela; 5. Dokumentar & Shkencë; 6. Muzikë; Lifestyle & Reality; 7. Programe të mbartura të huaja; 8. Shqip, programe shqiptare; 9. Sport; 10. Informacion. Program kombëtar për të rritur. Në



segmentin VII dhe VIII do të renditen programet HD/SD, programet audio dhe shërbime të tjera.

Në projektregullore përcaktohet edhe procedura për dhënien e NLP<sup>16</sup>-së, duke theksuar që numrat e parë të listës së NLP-së u jepen programeve të operatorit publik (kombëtar, rajonal dhe lokal). Ndërsa, NLP-të e OSHMA-ve ekzistuese, përkatësisht, kombëtare, rajonale dhe lokale, do të përcaktohen sipas pikëve të fituara në procesin e vlerësimit, që do të realizohet nga AMA. Procedura e dhënies së NLP-së kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për dhënien e NLP-së, i emëruar nga Kryetari i AMA-s. Aplikimi për licencë shërbimi programi audio dhe/ose audioviziv konsiderohet edhe kërkesë për marrjen e NLP-së. NLP-ja jepet nga AMA, bazuar në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit të aplikimit për licencë transmetimi ose licencë shërbimi programi audio dhe/ose audioviziv. NLP-ja/të e OSHMA-së, do të jetë vendi i parë i lirë në segmentin e caktuar për kategorinë përkatëse të programit.

Ky projektakt i është përcjellë për mendim të gjithë subjekteve audio dhe audiovizive. Projekti i rregullores së mësipërme është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s. Në kuadër të procesit të këshillimit, për marrjen e mendimit të palëve të interesuara dhe, me qëllim përmirësimin e dispozitave të projektregullores, AMA, në datën 18.07.2013, ka zhvilluar tryezë të përbashkët.

2. *Projektregullore "Mbi ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar"*. Detyrimi për miratimin e këtij akti buron nga Kreu XI i ligjit nr. 97/2013, që rregullon shërbimet e mbrojtura. Objekti i kësaj projektregulloreje është përcaktimi i rregullave për ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar, për të siguruar lëvrimin e shërbimeve të mbrojtura tek abonentët me cilësi, në kushte të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese. Projektregullorja përkufizon shërbimin e aksesit të kushtëzuar (*conditional access*), që është çdo masë apo rregullim teknik që mundëson marrjen në formë të kuptueshme të shërbimeve të mbrojtura<sup>17</sup>, kundrejt një autorizimi individual paraprak. Në tregun audioviziv shqiptar forma më e përhapur e autorizimit paraprak është karta e parapaguar, por praktika botërore nuk përjashton edhe forma të tjera. Si shërbim, "aksesi i kushtëzuar" është një shërbim ndërmjetës, që realizon abonimin në shërbimet televizive. Ai mund të kërkohet edhe nga shërbimet pa pagesë (*free-to-air*). Ky shërbim ndryshon esencialisht nga shërbimet e tjera audiovizive, si ofrimi i shërbimit të programit audio apo audioviziv, si dhe ofrimi i rrjeteve të

<sup>16</sup> NLP-Numri Logjik i Programit

<sup>17</sup> Shërbime me akses të kushtëzuar

transmetimit audioviziv. Duke qenë se ofrimi i këtij shërbimi nuk kërkon përdorimin e burimeve natyrore të kufizuara, ligji përcakton që operimi i tij të realizohet mbi bazën e autorizimit. Ky shërbim konsiderohet si hallka që kryen lëvrimin e shërbimeve audiovizive të përdoruesit (shikuesit apo dëgjuesit). Ligji lejon që, në varësi të modelit të biznesit të zgjedhur, shërbimi mund të ofrohet nga vetë i licencuari për transmetime audiovizive (që nga ana e tij zotëron licencën për shërbimin e programit audioviziv dhe licencën e rrjetit), ose nga një subjekt tjetër, që zotëron autorizimin për ofrimin e këtij shërbimi.

Aksesi i kushtëzuar synon plotësimin e 5 objektivave:

- Kontrolli i teknologjisë së aksesit të kushtëzuar të mos përdoret për të shtrembëruar, kufizuar apo parandaluar konkurrencën në shërbimet televizive dhe shërbimet e tjera të përmbajtjes;
- Kontrolli i teknologjisë së aksesit të kushtëzuar nuk duhet të kufizojë zgjedhjen e konsumatorit, si në lidhje me pajisjet e konsumatorit, numrin e shërbimeve të këtyre pajisjeve apo në paketimin e këtyre shërbimeve;
- Të thjeshtohet aksesit i konsumatorit në më shumë se një mekanizëm lëvrimi, pa përdorur shpenzime të panevojshme shtesë;
- Të thjeshtohet zgjedhja nga ana e konsumatorit, duke siguruar aksesin e lehtë në një informacion të kuptueshëm mbi numrin e shërbimeve të disponueshme dhe zgjedhjen e lehtë të shërbimeve;
- Të sigurohet që kontrolli i teknologjisë së aksesit të kushtëzuar të mos shfrytëzohet nëpërmjet çmimeve të ekzagjeruara për përdorimin e kësaj teknologjie.

Guidat elektronike të programeve (EPG) kontrollojnë aksesin e shikuesve në shërbimet televizive. Ato janë një pjesë e sistemit të aksesit të kushtëzuar. Edhe këto shërbime rregullohen nga AMA dhe jepen në baza të ndershme, të arsyeshme dhe jodiskriminuese.

Edhe ky projektakt i është përcjellë për mendim të gjitha subjekteve audio dhe audiovizive. Projekti i rregullores së mësipërme është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s. Në kuadër të procesit të këshillimit, për marrjen e mendimit të palëve të interesuara dhe me qëllim përmirësimin e dispozitave të projektregullores, AMA, në datën 18.07.2013, ka zhvilluar tryezë të përbashkët. *Për shkak se rregullimi i shërbimit me akses të kushtëzuar është një koncept që futet për herë të parë, pjesëmarrësit në takime kanë pasur paqartësi, të cilat, të ndërthurura edhe me interesat e operatorëve, që tentojnë të monopolizojnë tregun në funksion të produkteve të tyre, në një kohë që ligji, në interes të konsumatorëve, kërkon të*

*kundërtën, evidentohet nevoja e vazhimit të punës së nisur për sqarimin e plotë dhe në detaje të kësaj projektregulloreje.*

*3. Projektregullore “Per komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare. Format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e tyre”.* Kjo projektregullore përfshin dhe saktëson, në mënyrë të detajuar, kërkesat e ligjit për transmetimin e reklamave, oraret dhe ndërprerjet, kushtet dhe kërkesat për mbrojtjen e konsumatorit dhe sidomos fëmijëve, respektimin e rregullave të etikës në përmbajtjen dhe mënyrën e transmetimit të reklamave dhe komunikimeve tregtare, të papërcaktuara më parë në legjislacionin shqiptar, si për shembull “vendosja e produktit” apo “dritaret e teleshitjeve” etj.

Ky projektakt i është përcjellë për mendim të gjithë subjekteve audio dhe audiovizive, si dhe është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s. Gjatë procesit të këshillimit, për marrjen e mendimit të palëve të interesuara dhe me qëllim përmirësimin e dispozitave të projektregullores, AMA ka zhvilluar takime të përbashkëta dhe është në pritje të mendimeve dhe sugjerimeve të operatorëve.

*4. Projektregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv dhe licencës së shërbimit të programit audioviziv”.* Kjo projektregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv dhe licencës së shërbimit të programit audioviziv. Në këtë projektakt parashikohen rregullat, kriteret dhe kërkesat juridike, financiare, programore dhe teknike, që duhet të respektohen nga subjektet, që do të aplikojnë për t’u pajisur me licencë kombëtare/rajonale/lokale transmetimi audioviziv. Në projektregullore përshkruhen në mënyrë të detajuar llojet e licencave të transmetimit audioviziv, kërkesat e përgjithshme të aplikimit për licencë transmetimi audioviziv, karakteristikat e rrjeteve private numerike kombëtare rajonale e lokale, struktura e shërbimeve të programeve që mbështeten në to, rregullat për shfrytëzimin e kapacitetit transmetues të rrjetit numerik për mbështetjen e programeve të veta, rregullat për shqyrtimin e aplikimeve për marrje licence, procedurat e vendimmarrjes, organizimi i konkurrimit të kandidatave etj.

Në dallim nga rregullorja “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës “*beauty contest*”, e cila rregullon licencimin e subjekteve ekzistuese dhe me eksperiencë në transmetimet numerike gjatë periudhës tranzitore<sup>18</sup>, projektregullorja

---

<sup>18</sup> Neni 139 i ligjit nr. 97/2013

”Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audioviziv dhe licencës së shërbimit të programit audioviziv” do të zbatohet në vazhdimësi nga AMA për licencimet me konkurrin të hapur.

Në përmbushje të detyrimit për këshillim publik gjatë procesit të përgatitjes së dokumentave rregullatore, ky projektakt iu është përcjellë për mendim të gjitha subjekteve audio dhe audiovizive dhe është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s.

5. *Projektregullore “Për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale”*. Detyrimi për miratimin e këtij akti buron nga neni 66 i ligjit nr. 97/2013. Kjo projektregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave të transmetimit audio për qëllime të përkohshme dhe nevoja institucionale, institucioneve publike dhe institucioneve të arsimit parauniversitar, arsimit të lartë etj. Kjo rregullore pritet të miratohet së shpejti.

6. *Projektregullore “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”*. Kjo projektregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat e licencimit për dhënien e licencës së transmetimit audio dhe licencës së shërbimit të programit audio. Në të parashikohen rregullat, kriteret dhe kërkesat juridike, financiare, programore dhe teknike që duhet të respektohen nga subjektet, që do të aplikojnë për t’u pajisur me licencë kombëtare/rajonale/lokale transmetimi audio. Në projektregullore përshkruhen në mënyrë të detajuar llojet e licencave të transmetimit audio, kërkesat e përgjithshme të aplikimit për licencë transmetimi audio, karakteristikat e rrjeteve private numerike kombëtare rajonale e lokale, struktura e shërbimeve të programeve që mbështeten në to, rregullat për shfrytëzimin e kapacitetit transmetues të rrjetit numerik për mbështetjen e programeve të veta, rregullat për shqyrtimin e aplikimeve për marrje licence, procedurat e vendimmarrjes, organizimi i konkurrimit të kandidaturave etj. Edhe ky projektakt i është përcjellë për mendim të gjitha subjekteve dhe është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s për këshillimit publik. Ky akt pritet të miratohet së shpejti.

7. *Projektregullore “Për transmetimin pa shpërblim të mesazheve me interes të lartë për publikun e gjerë”*. Projekti i rregullores së mësipërme është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s dhe është përcjellë për mendim të palët e interesuara. Kjo rregullore është në proces miratimi.

8. *Projektrregullore "Për përcaktimin e ngjarjeve me rëndësi të madhe dhe mënyrën e transmetimit të tyre dhe të drejtën e raportimit të lajmeve të shkurtra"*. Projekti i rregullores së mësipërme është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s dhe është përcjellë për mendim te palët e interesuara. Kjo rregullore pritet të miratohet së shpejti.

9. *Projektudhëzim "Për format dhe kategoritë e programeve për regjistrim dhe arkivim"*. Ky projektakt është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s dhe është përcjellë për mendim tek palët e interesuara. Ky udhëzim pritet të miratohet së shpejti.

10. *Projektrregullore "Mbi procedurat e rinovimit të licencave të transmetimit audio"*. Objekti i kësaj projektrregulloreje është përcaktimi i procedurave për rinovimin e licencës së transmetimit audio. Në projektrregullore përshkruhen në mënyrë të detajuar, kërkesat e aplikimit për rinovimin e licencës së transmetimit audio, rregullat për shqyrtimin e aplikimeve për rinovimin e licencës, procedurat e vendimmarrjes etj.

11. *Projektrregullore "Për monitorimin e spektrit të frekuencave"*. Detyrimi për miratimin e këtij akti buron nga nenet 79 dhe 80 të ligjit. Objekti i kësaj projektrregulloreje është përcaktimi i procedurave të monitorimit të spektrit të destinuar për transmetimet radio e televizive tokësore. Qëllimi i monitorimit të spektrit është mbështetja e procesit të administrimit të spektrit në përgjithësi, si dhe mbështetja e procesit të alokimit të frekuencave bazuar në planet frekuencore.

Në përmbushje të detyrimit të këshillimit publik gjatë procesit të përgatitjes së dokumentave rregullatore, ky projektakt i është përcjellë për mendim të gjitha subjekteve audio dhe audiovizive dhe pritet të miratohet së shpejti.

12. *Projektrregullore "Për kriteret dhe masat rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së"*. Detyrimi për hartimin e këtij akti buron nga neni 122 i ligjit, që parashikon infrastrukturën e transmetimit. Kjo projektrregullore përcakton rregullat dhe procedurat për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së nga ofruesit e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv të licencuar për transmetime audio dhe/ose audiovizive tokësore. Në projekt parashikohet se një subjekt i licencuar ose aplikues për transmetime audio dhe/ose audiovizive, kombëtare, rajonale apo lokale, ka të drejtë të kërkojë përdorimin e mjeteve të infrastrukturës së RTSH-së për shpërndarjen e sinjalit brenda zonës së tij të transmetimit, rregullat për lidhjen e kontratës së

bashkëpërdorimit, llojet e shërbimeve të ofruara, kriteret për caktimin e tarifave, procedurat që zbatohen në rast të mosmarrëveshjeve etj.

Hartimi i akteve të mësipërme përbën një punë voluminoze të kualifikuar, e cila është realizuar brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e ligjit. Gjatë kësaj periudhe është punuar intensivisht jo vetëm për hartimin e projektakteve, por edhe për të tërhequr mendimin e grupeve të interesit, si dhe ekspertëve vendas dhe të huaj. Gjatë procesit të këshillimit publik është vënë re mungesa e angazhimit të disa operatorëve, përfshirë edhe operatorët kombëtarë, me ndikim të madh në tregun mediatik.

Miratimi i akteve nënligjore siguron ushtrimin e plotë të kompetencave të AMA-s në përputhje me ligjin.

### **3.2. Akte të tjera**

Përveç punës për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore, të përmendura më sipër, në zbatim të ligjit të ri, AMA ka marrë edhe vendime të tjera që lidhen me dhënien e autorizimeve për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv, për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në subjektet e licencuara/autorizuara, si vijon:

- Vendimi nr. 8, datë 22.05.2013, me të cilin është miratuar ofrimi i shërbimit të programit audioviziv satelitor “TV Agon Channel”;
- Vendimi nr. 11, datë 02.07.2013, me të cilin është miratuar kalimi i licencave të subjekteve “Tv kabllor Star” dhe “Tv kabllor Trio” te subjekti “ABCom” sh.p.k;
- Vendimi nr. 13, datë 11.10.2013, me të cilin janë miratuar disa ndryshime në të dhënat e shoqërisë “UTV Education” sh.p.k., licencuar për subjektin televiziv “UTV” (ndryshime në pronësinë e kuotave të shoqërisë);
- Vendimi nr. 16, datë 11.10.2013, me të cilin është miratuar kalimi i të drejtave të licencës së shoqërisë “Telesport” sh.p.k. te shoqëria “Agonset” sh.p.k. dhe miratimi i ndryshimeve në strukturën programore;
- Vendimi nr. 20, datë 27.11.2013, me të cilin është miratuar kalimi i të drejtave të licencës së shoqërisë “Media 99” sh.a., te shoqëria “Belkisa” sh.p.k.;
- Vendimi nr. 24, datë 27.12.2013, me të cilin është miratuar ofrimi i shërbimit të ripërsëritjes së programit audioviziv të të tretëve “TV M- Devolli” ;
- Vendimi nr. 2, datë 29.04.2013, “Për shqyrtimin e sanksionit me gjobë të vendosur ndaj subjektit “TV Shijak”;
- Vendimi nr. 9, datë 22.05.2013, “Për shqyrtimin e sanksionit me gjobë të vendosur

ndaj subjektit “TV Shijak”;

- Vendimi nr. 22, datë 27.12.2013 “Për shqyrtimin e sanksionit me gjobë të vendosur ndaj subjektit “Tirana TV”.

Pas kontrolleve dhe inspektimeve të kryera nga inspektorët e AMA-s, për shkeljet e konstatuara, janë lëshuar urdhrat si vijon:

- Urdhër nr. 59, datë 10.04.2013 “Për sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të subjektit të palicencuar “Tv Shijak”;
- Urdhër nr. 81, datë 15.05.2013 “Për sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të subjektit të palicencuar “Tv Real”;
- Urdhër nr. 99, datë 05.06.2013 “Për bllokimin dhe ndalimin e funksionimit të pajisjeve transmetuese të subjektit audioviziv të palicencuar “TV AOS”.

Menjëherë, pas miratimit të Rregullores “Mbi procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit medatik audioviziv”, AMA ka ndërmarrë një fushatë të gjerë inspektimi pranë subjekteve në gjithë territorin e vendit. Kontrollat e ushtruara kanë konsistuar veçanërisht në respektimin e të drejtës së transmetimit të programeve nga subjektet audiovizive, kryesisht kabllore. Përgjatë një periudhe 1 mujore janë ushtruar kontrolle në 45 subjekte audiovizive, vendore dhe kabllore, ndaj të cilave ka nisur procedura administrative.

### **3.3. Zëvendësimi i licencave**

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, i cili parashikon ndryshime thelbësore për autorizimin e veprimtarive audiovizive të mbështetura në rrjete kabllore, lindi domosdoshmëria për harmonizimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve të licencuara sipas ligjit të mëparshëm me dispozitat e ligjit të ri.

Më konkretisht, në nenin 138 të ligjit nr. 97/2013 të sipërcituar, përcaktohet se:

“ ...2. *Licencat për transmetim të programeve televizive kabllore të dhëna sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, zëvendësohen me autorizimet e mëposhtme:*

- a) autorizimin për shërbimin e programeve audio dhe/ose shërbimin e programeve audiovizive lëshuar nga AMA;*
- b) autorizimin e përgjithshëm, sipas përcaktimit të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, kundrejt njoftimit të*

*AKEP-it. Zëvendësimet e mësipërme kryhen brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. ...”*

Në zbatim të sa më sipër, AMA me shkresat nr. 1016, datë 30.05.2013 dhe nr. 1598 prot, datë 10.10.2013, u kërkoi zyrtarisht subjekteve kabllore të licencuara depozitimin e certifikatës së autorizimit të përgjithshëm të lëshuar nga AKEP.

Deri tani, nga 90 subjekte televizive private kabllore, 65 prej tyre kanë depozituar certifikatën e autorizimit të përgjithshëm të AKEP-it.

Pas depozitimit të certifikatës së autorizimit të përgjithshëm, AMA, me vendimin nr. 23, datë 27.12.2013, ka vendosur të zëvendësojë licencat e 60 subjekteve televizive private kabllore ekzistuese, me autorizim për ripërsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve.

### **3.4. Mbi përmbajtjen dhe etikën e programeve**

Gjatë periudhës raportuese, në lidhje me çështjet e programacionit, AMA, në përputhje me kërkesat e ligjit të ri, është përqendruar në këto drejtime kryesore:

1. Konceptimi, hartimi dhe miratimi i akteve themelore nënligjore si detyrim i drejtpërdrejtë i ligjit.
2. Përfshirja në mënyrë aktive e operatorëve në procesin e këshillimit publik, jo vetëm për marrjen e mendimeve të tyre, por edhe për ndërgjegjësimin mbi rrisitë e ligjit të ri.
3. Vizionimi, monitorimi dhe ndjekja në vijueshmëri e programeve të transmetuara, me synim respektimin e parimeve themelore të ushtrimit të veprimtarisë audiovizive.
4. Përqendrimi në respektimin e rregullave etike e morale për mbrojtjen e fëmijëve në media, tashmë të mirërregulluara nga ligji i ri.

Për sa më sipër, AMA, në përmbushje të funksioneve të veta, ka bashkëpunuar në vijimësi me institucionet publike, organizma e shoqata të ndryshme, për të koordinuar, konsultuar dhe vlerësuar çështje dhe problematika me interes të përbashkët që lidhen me veprimtarinë audiovizive.

#### **3.4.1. Mbrojtja me përparësi e të drejtave të fëmijëve**

Gjatë vitit 2013, AMA i ka kushtuar një kujdes të veçantë respektimit të privatësisë dhe të drejtave të të miturve, kërkesave morale e etike për mbrojtjen e tyre nga “rreziku mediatik”. Format e propozuara e të ndjekura për komunikimin me operatorët dhe opinionin publik, që kanë synuar vendosjen në qendër të vëmendjes ruajtjen e shëndetit fizik dhe mendor të të



miturve, formimin dhe edukimin e shëndetshëm të tyre, kujdesin e vazhdueshëm për respektimin e etikës në programet me dhe për fëmijë, kanë qenë të ndryshme:

- *Shqyrtim e vlerësim në kohë i ankesave të teleshikuesve.* Ankesat vijnë nga individë, grupe individësh, forume apo shoqata e organizma të ndryshme, kryesisht për shkelje që lidhen me cenimin e dinjitetit, të drejtat e grave dhe të të miturve, si dhe raportime të pasakta dhe joetike.
- *Konferenca e seminare tematike të organizuara nga AMA me pjesëmarrje të operatorëve, institucioneve publike, shoqatave të medias, gazetarëve etj., sidomos konferencat për aktet e reja nënligjore, për mbrojtjen e fëmijëve në media, për Kodin e Transmetimit etj.*
- *Sanksione me gjobë:* Vendimi i AMA-s nr. 22. datë 27. 12. 2013, për sanksion me gjobë 40 000 lekë, ndaj subjektit “Tirana TV”, u mor pas një procesi të gjatë vizionimi e monitorimi të programeve të këtij operatori vendor.
- *Propozime për hartime aktesh në mbrojtje të fëmijëve në media, memorandume bashkëpunimi etj.* Në këtë drejtim ka pasur një bashkëpunim frytdhënës me Komisionerin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Zyrën e Avokatit të Popullit, ZSHDA-në, Unionin e Gazetarëve, por kjo nuk mund të thuhet për shoqatat e gazetarëve të medias audiovizive dhe operatorët kombëtarë.

Me interes të veçantë është projekti i inicuar nga AMA, për Kartën e Mbrojtjes së Fëmijëve në Media.<sup>19</sup> Kjo Kartë, i drejtohet institucioneve publike, grupeve mediatike audiovizive dhe të shkruara, dhe organizatave joqeveritare (Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, UNICEF, Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë, Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë). Karta mbështetet në nenin 17 të Konventës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve (KNMF), sipas së cilës “Vendet anëtare inkurajojnë përpunimin e direktivave për sa i takon mbrojtjes së fëmijëve nga informacione dhe materiale që dëmtojnë mirëqenien e tyre”. Karta ka si objektive të risjellë në vëmendjen e aktorëve mediatikë të drejtat e fëmijëve dhe detyrat përkatëse në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe imazhit të tyre në media, të përcaktojë angazhimin e mediave në këtë fushë dhe të sensibilizojë opinionin publik ndaj “rrezikut mediatik” për fëmijët. Karta përmban parime themelore dhe standardet që duhet të synojnë mediat audiovizive për të

<sup>19</sup> Nisma u lancua me Propozimin për hartimin e Kartës për Mbrojtjen e Fëmijëve në Media, nr.743 prot., datë 03.20.2013. Ajo u rikonfirmua në konferencën për mbrojtjen e fëmijëve, 17 janar 2013.

mbrojtur të drejtat e patjetërsueshme të të miturve dhe mbrojtjen e shëndetit të tyre fizik dhe mendor. Në lidhje me Kartën u dhanë mendime nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta<sup>20</sup> dhe Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.<sup>21</sup>

Për mbrojtjen e fëmijëve në media dhe prej medias, rëndësi të dorës së parë merr respektimi i të drejtës së privatësisë; shmangia e dhunës dhe e keqpërdorimit të gjuhës në ekran; moscenimi i dinjitetit të fëmijëve në programet me dhe për fëmijë; mosidentifikimi i fëmijëve dhe viktimave në programet informative, në intervistimet, si dhe kujdesi për t'u ruajtur nga keqpërdorimi i fjalës në disa programe argëtuese; ndalimi i transmetimit për disa filma e programe pa shenjat paralajmëruese, respektimi i etikës në reklama dhe në komunikimet e ndryshme tregtare etj.

Kjo problematikë ka kushtëzuar bashkëpunimin dhe komunikimin e AMA-s me operatorët, me publikun, si dhe përfshirjen e sugjerimeve përkatëse në rregulloret e reja e sidomos në Kodin e transmetimit. Mbetet me rëndësi parësore dhe duhet ritheksuar fakti që operatorët audiovizivë kanë detyrim e synim kryesor edhe edukimin e publikut, dhe te ky i fundit fëmijët janë pjesa më e rëndësishme.

### **3.4.2. Personat me aftësi të kufizuara**

Problematik paraqitet qëndrimi i medias audiovizive në raport me personat me nevoja të veçanta shqisore apo paraqitja në programe të ndryshme e personave me aftësi të kufizuara. Nuk është e rrallë dukuria mediatike e mungesës së vëmendjes, cenimit të dinjitetit, të të drejtave apo diskriminimit të këtyre personave apo familjarëve të tyre.

Ligji i ri në dispozita të veçanta trajton në mënyrë specifike, masat, që ofruesit e shërbimit audioviziv, duhet të marrin për të realizuar marrjen e programeve në një nivel të kënaqshëm nga personat që kanë një shkallë të caktuar paaftësie dëgjimi ose shikimi dhe një përqindje e caktuar e këtyre programeve mund të vendoset si detyrim në rregulloret e transmetimit. Në këtë rregullore, do të përfshihet edhe detyrimi, që çdo OSHMA të sigurojë shërbime si: gjuhën e shenjave, shërbime të teletekstit, titrimin dhe përkthimin me zë etj. Kjo rregullore do të miratohet së shpejti.

Kodi i transmetimit, në nene të posaçme trajton kërkesat dhe rregullat që duhet të zbatojnë OSHMA-të, lidhur me kujdesin ndaj personave me aftësi të kufizuara. OSHMA duhet të

<sup>20</sup> Shkresa nr. 686/3 prot., 16.04.2013.

<sup>21</sup> Shkresa nr.358/1 prot., 30.04.2013.

respektojnë imazhin e personave me aftësi të kufizuar, të mos çënojnë apo denigrojnë ata, të mos i shfrytëzojnë apo përdorin për qëllime reklamuese, si dhe të marrin masa për të siguruar që shërbimet e transmetimit të jenë të aksesueshme edhe nga këto persona.

### ***3.4.3. E drejta e përgjigjes***

Ligji parashikon dhe siguron edhe të drejtën e përgjigjes. Çdo person, dinjiteti dhe reputacioni i të cilit janë prekur nga publikimi i fakteve dhe informacioneve jo të sakta në një transmetim, ka të drejtën e përgjigjes. Realiteti i transmetimeve audiovizive dëshmon se e drejta e përgjigjes nuk respektohet. Për këtë arsye, AMA po përgatit rregulloren e posaçme, që përcakton procedurat që ndiqen për të drejtën e përgjigjes, afatet lidhur me të, si dhe detyrimet për OSHMA-të në këto raste. E drejta e përgjigjes, në çdo rast, duhet të paraqesë se në çfarë mase informacioni i paraqitur gjatë transmetimit është jokorrekt dhe mashtrues dhe të përqendrohet në pohimin e fakteve të nevojshme për korrigjimin e fakteve apo informacioneve të pavërteta.

### ***3.4.4. Këshilli i Ankesave***

Me ligjin e ri, pranë AMA-s krijohet Këshilli i Ankesave, si organizëm me kohë të plotë dhe i specializuar për të mbikëqyrur zbatimin e Kodit të Transmetimit dhe akteve nënligjore të miratuara nga AMA, që kanë të bëjnë kryesisht me respektimin e dinjitetit e të drejtave të tjera themelore të njeriut, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e të miturve, respektimin e normave morale dhe etike në programet e transmetuara nga OSHMA-të etj. Po ashtu, shqyrton ankesa të ndryshme me tematikën e sipërcituar dhe propozon tek AMA masat përkatëse në rast shkeljesh; përgatit dhe publikon udhëzime për OSHMA-të, përgatit anketime etj.

Këshilli i Ankesave caktohet nga AMA me shumicë të cilësuar, por për shkak se ende nuk janë plotësuar vendet vakante në përbërjen e AMA-s, ky detyrim ligjor nuk është përmbushur. Mungesa e këtij Këshilli bllokoi vendimmarrjen e AMA-s për evidentimin dhe sanksionimin e shkeljeve të të drejtave themelore të njeriut dhe, veçanërisht, të të miturve.

### 3.5. Disa dukuri të programeve informative

Gjatë monitorimit të edicioneve kryesore informative të transmetuara nga operatorët televizivë kombëtarë, janë siguruar të dhëna statistikore, që kanë të bëjnë me kohën e plotë apo sinkron, të vënë në dispozicion nga këta operatorë për subjektet politike e institucionet qendrore apo për aktorët e ndryshëm politikë. Gjithashtu, janë përcaktuar edhe të dhëna lidhur me vendin që zënë në këto edicione tema të tilla, si: politika, veprimtaria e Presidentit, Parlamentit e Qeverisë, si dhe tema sociale, lajmet ndërkombëtare, ekonomia, arsimi, kultura, kronika e zezë dhe tema të tjera me interes për publikun. Gjatë këtyre monitorimeve është konstatuar se, në edicionet informative, vendin kryesor e zë tema e politikës, e ndjekur nga temat sociale. Edhe renditja e lajmeve ka një rëndësi të madhe. Kështu, në përgjithësi lajmet e para janë ato që flasin për veprimtarinë e Qeverisë dhe Kryeministrit, më pas ato me përmbajtje sociale, ekonomike, kulturore etj.

Tabelat e monitorimit përcaktojnë të dhëna statistikore të krahasueshme për tremujorin e parë (janar-mars 2013) dhe tremujorin e fundit (tetor-dhjetor 2013) mbi kohën e vënë në dispozicion nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative për subjektet e politikës, institucionet publike etj. Po ashtu jepen të dhëna të hollësishme mbi prezencën sinkron të tyre.

**Tab.1 Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qendrore**

<b>Koha e plotë për subjektet politike dhe institucionet qendrore (koha në %)</b>						
<b>Subjektet/Operatori</b>	<b>Top Channel</b>		<b>TV Klan</b>		<b>Televizioni Shqiptar</b>	
	<b>Janar-Mars 2013</b>	<b>Tetor-Dhjetor 2013</b>	<b>Janar-Mars 2013</b>	<b>Tetor-Dhjetor 2013</b>	<b>Janar-Mars 2013</b>	<b>Tetor-Dhjetor 2013</b>
Presidenti	1.31	2.06	1.66	3.34	3.10	4.63
Kryeministri	13.51	18.54	24.21	17.73	29.96	18.41
Qeveria	9.69	33.21	15.25	12.19	21.93	33.91
Parlamenti	3.64	7.44	5.76	10.58	6.59	12.99
Partia Demokratike	10.33	28.16	20.90	46.61	22.20	25.15
Partia Socialiste e Shqipërisë	42.93	7.86	16.86	5.27	8.63	3.00
Lëvizja Socialiste për	4.95	0.93	9.58	2.19	4.73	0.91

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Integrim						
Partia Republikane	1.01	0.51	1.81	0.82	0.92	0.17
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.39	0.15	0.43	0.00	0.00	0.06
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.88	0.77	0.71	0.25	0.96	0.39
Kandidat i pavarur	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Aleanca Demokratike	0.00	0.00	0.00	0.00	0.13	0.04
Lëvizja Demokristiane	0.24	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Levizja per Zhvillim Kombetar	0.00	0.00	0.22	0.00	0.00	0.00
Partia Agrare Ambientaliste	0.00	0.00	0.00	0.00	0.08	0.00
Partia Bashkimi Liberal Demokrat	0.00	0.00	0.20	0.00	0.11	0.00
Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	0.85	0.04	0.36	0.53	0.00	0.00
Partia Demokristiane	0.00	0.02	0.00	0.00	0.00	0.09
Partia e Ballit Kombetar	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia e Ballit Kombëtar Demokrat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.16	0.02
Partia G99	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Lëvizja e Legalitetit	0.00	0.00	0.07	0.00	0.32	0.00
Partia për Ligj dhe Drejtësi	0.22	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	0.04	0.00	0.40	0.11	0.00	0.00
Partia Socialiste 91	0.08	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Partia Komuniste e Shqipërisë	0.00	0.00	0.09	0.00	0.00	0.00
Partia Pensioniste	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Aleanca Kuq e Zi	5.62	0.00	0.00	0.37	0.00	0.00
Partia Fryma e Re Demokratike	4.25	0.13	0.40	0.00	0.00	0.00
Partia Aleanca Demokristiane	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres	0.00	0.00	0.33	0.00	0.07	0.00
Bashkim Liberal Demokrat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Aleanca popullore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.06
Aleanca Demokristiane	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Socialiste e Moderuar	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>Shuma</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

**Tab.2 Koha sinkron për subjektet politike dhe institucionet qendrore**

Koha Sinkron për Subjektet Politike dhe Institucionet Qëndrore (koha në %)						
Subjektet/Operatori	Top Channel		TV Klan		Televizioni Shqiptar	
	Janar-Mars 2013	Tetor-Dhjetor 2013	Janar-Mars 2013	Tetor-Dhjetor 2013	Janar-Mars 2013	Tetor-Dhjetor 2013
Presidenti	0.28	1.26	0.83	1.47	2.12	3.17
Kryeministri	12.46	19.75	25.38	18.25	27.50	20.76
Qeveria	7.68	30.51	13.85	11.82	18.95	32.32
Parlamenti	0.73	3.06	2.73	4.27	2.54	5.34

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Partia Demokratike	13.12	32.99	27.85	53.04	30.74	32.45
Partia Socialiste e Shqipërisë	46.16	9.46	14.27	6.44	9.97	4.33
Lëvizja Socialiste për Integrim	5.28	0.94	10.03	2.73	5.29	1.03
Partia Republikane	0.79	0.57	1.47	0.87	0.69	0.18
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.33	0.18	0.52	0.00	0.00	0.09
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.61	0.84	0.66	0.34	1.14	0.18
Kandidat i pavarur	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Aleanca Demokratike	0.00	0.00	0.00	0.00	0.21	0.00
Levizja Demokristiane	0.29	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Lvizja për Zhvillim Kombëtar	0.00	0.00	0.24	0.00	0.00	0.00
Partia Agrare Ambientaliste	0.00	0.00	0.00	0.00	0.07	0.00
Partia Bashkimi Liberal Demokrat	0.00	0.00	0.24	0.00	0.14	0.00
Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	0.97	0.08	0.31	0.21	0.00	0.00
Partia Demokristiane	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.03
Partia e Ballit Kombëtar	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia e Ballit Kombëtar Demokrat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.27	0.00
Partia G99	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Lëvizja e Legalitetit	0.00	0.00	0.08	0.00	0.32	0.00

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Partia për Ligj dhe Drejtësi	0.39	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	0.09	0.00	0.44	0.21	0.00	0.00
Partia Socialiste 91	0.15	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Komuniste e Shqipërisë	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Pensioniste	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Aleanca Kuq e Zi	5.73	0.00	0.00	0.36	0.00	0.00
Partia Fryma e Re Demokratike	4.87	0.12	0.38	0.00	0.00	0.00
Partia Aleanca Demokristiane	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Lidhja per Drejtësi dhe Progres	0.00	0.00	0.44	0.00	0.06	0.00
Bashkim Liberal Demokrat	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Aleanca per Demokraci dhe Solidaritet	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Aleanca popullore	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.11
Aleanca Demokristiane	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Partia Socialiste e Moderuar	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<b>Shuma</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>



**Tab.3 Koha sinkron për aktorët politikë**

Koha sinkron për aktorët politikë (koha në përqindje)						
AKTORI SINKRON	TVSH		TV KLAN		TOP CHANNEL	
	Janar- Mars 2013	Tetor- Dhjetor 2013	Janar- Mars 2013	Tetor- Dhjetor 2013	Janar-Mars 2013	Tetor-Dhjetor 2013
Bujar Nishani	1.11	3.17	0.83	1.47	0.28	1.26
Edi Rama	4.58	22.4	10.76	21.31	18.56	21.36
Ilir Meta	3.57	5.48	7.32	4.69	3.93	3.35
Lulzim Basha	0	12.23	0	20.61	0.18	13.56
Sali Berisha	38.33	2.52	35.28	6.23	18.28	3.32
Të tjerë	52.41	54.2	45.81	45.69	58.77	57.15
Shuma	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

**Tab.4 Koha e plotë për temën e lajmit**

Koha e Plotë për Temën e Lajmit (koha në përqindje)						
Temat	Top Channel		TV Klan		Televizioni Shqiptar	
	Janar- Mars 2013	Tetor- Dhjetor 2013	Janar- Mars 2013	Tetor- Dhjetor 2013	Janar- Mars 2013	Tetor- Dhjetor 2013
Politikë	31.92	16.42	29.41	19.82	25.42	12.56
Veprimtaria e Presidentit	0.47	0.39	0.87	1.38	0.68	1.52
Veprimtari e Qeverisë	5.57	10.27	12.71	9.00	13.69	17.39
Veprimtari e Parlamentit	4.05	8.45	3.18	7.13	5.08	8.49
Veprimtari e Qeverisë Vendore	0.50	1.27	4.08	3.80	2.99	2.98
Veprimtaria e drejtësisë	5.72	6.95	3.32	2.64	1.20	1.83
Sociale	10.37	10.55	13.68	11.76	24.45	20.36
Ekonomi	5.87	6.16	3.40	4.05	4.41	2.71
Kronika e zezë / Rendi	5.50	7.65	5.50	5.66	0.97	2.28

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Lajme nga Kosova / Rajoni	8.55	6.34	4.13	1.58	3.17	3.41
Lajme ndërkombëtare	10.44	10.67	7.61	10.35	3.67	4.14
Art / Kulturë / Kuriozitete	4.86	5.13	4.66	8.03	5.47	10.06
Sport	2.14	3.35	4.29	6.88	4.98	6.49
Të tjera	4.03	6.40	3.16	7.91	3.81	5.76
<b>Shuma</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>	<b>100%</b>

### 3.6 Mbi regjistrimin dhe monitorimin e programeve

Studio e Monitorimit është pjesë përbërëse e Drejtorisë së Programeve në AMA, ku kryhet regjistrimi dhe monitorimi i subjekteve televizive dhe i subjekteve radiofonike që transmetojnë në zonën Tiranë-Durrës, duke përfshirë edhe tri platformat Digitalb, Tring dhe Abcom. Në terma statistikore në Studion e Monitorimit janë regjistruar në total gjatë këtij viti rreth 80 000 orë transmetime televizive dhe rreth 1 500 orë transmetime radiofonike.

Në periudhën maj–qershor 2013, Studio e Monitorimit u angazhua në monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare 2013 në mbështetje të Bordit të Monitorimit të Medias, detyrë kjo e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.

Fushat e monitorimit në Studion e Monitorimit për vitin 2013 kanë qenë: detyrimet programore, reklamat dhe edicionet informative, të cilat, në terma statistikore, do të përmblihdeshin në:

- Monitorimi i rreth 14 000 orë programeve të subjekteve televizive, në lidhje me detyrimet programore.
- Monitorimi i rreth 9 700 orë reklamave të transmetuara nga këto subjekte.
- Monitorimi i 720 edicioneve informative.

Janë monitoruar, gjithashtu, edhe 39 subjekte radiofonike në lidhje me respektimin e strukturës programore dhe zbatimin e të drejtave të transmetimit.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet krahasimi i orëve të monitoruara në tre vitet e fundit.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Nr	Subjekti i monitoruar	Orë të monitoruara		
		2011	2012	2013
1	TVSH	3000	3200	4000
2	KLAN	3000	3200	4000
3	TOP CHANNEL	3000	3200	4000
4	VIZION PLUS	3000	3200	4000
5	CHANNEL ONE	2000	1800	3400
6	AS	-	-	3000
7	SHIJAK	-	-	400
8	KOHA	800	400	600
9	MUZIKORE	500	400	72
10	NTV	-	-	400
11	RADIO	-	-	90
12	TV LOKALE	-	160	-

## 4. KALIMI NË TRANSMETIMET NUMERIKE

### 4.1. Vështrim i përgjithshëm

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë (tetor 2013), thekson se *“Duhet bërë përpjekje për zbatimin në kohë të Strategjisë së kalimit në digjital për mbylljen e transmetimeve analoge që duhet të përfundojnë në qershor 2015. Përpjekje të mëtejshme kërkohen për të liruar frekuencat që përdoren në mënyrë të paligjshme...”*

Për herë të parë në një projekt raport të Komisionit Evropian i vihet theksi lirimit të frekuencave, që përdoren në mënyrë të paligjshme, çka nënkupton rëndësinë që i kushtohet procesit të mbylljes së transmetimeve analoge.

Transmetimet numerike tokësore në Shqipëri janë edhe sot të parregulluara. Përpjekjet për rregullimin e këtyre transmetimeve kanë filluar me miratimin e ligjit nr. 9742, datë 28.05.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj plotësoi pjesërisht legjisllacionin e medias elektronike dhe hapi rrugën për mundësinë e licencimit të transmetimeve numerike. Bazuar në këtë ligj, KKRT filloi procedurën e konkurrimit publik të kandidaturave për subjektet e interesuara për t'u licencuar për operatorë privatë rrjeti numerik tokësor kombëtar. Konkurrimi u çel për 3 rrjete numerike dhe afati i fundit, për paraqitjen e aplikimeve, ishte caktuar data 24.11.2008. Me kërkesë të shoqërisë "Digitalb", KKRT, për t'i dhënë kohën e mjaftueshme përgatitjes së dokumentacionit prej të gjithë kandidatëve, vendosi të shtyjë konkurrimin për në datën 05.12.2008. Me kërkesë të subjektit “Vizion+”, KKRT vendosi përsëri shtyrjen e datës së konkurrimit për në datën 05.01.2009.

Datën e zhvillimit të konkurrimit u paraqit vetëm një kandidat, e konkretisht shoqëria “Tring”. Këtij subjekti iu njoftua shtyrja e garës për në datën 21.01.2009. Edhe në datën 21.01.2009, nuk u paraqit asnjë aplikim, nga asnjë subjekt që kishte tërhequr dokumentacionin për konkurrim në KKRT.

Disa nga shkaqet e dështimit të procedurës së licencimit, të evidentuara nga KKRT-ja edhe pas konsultimeve me kandidatët, janë:

1. Ligji i 2007-ës nuk përcaktonte qartë dallimin dhe marrëdhëniet ndërmjet operatorëve të rrjetit dhe shërbimeve programore;
2. Pretendimet mbi aplikimin e pagesave të larta për licencë dhe asetet e kërkuara nga ligji;
3. Hezitimi i operatorëve për të aplikuar kodimin MPEG-4;
4. Pretendimi për të siguruar subvencione nga shteti për dekoderët.

## 4. 2. Administrimi i frekuencave numerike

### 4.2.1. Planifikimi i rrjeteve televizive numerike

Edhe përgjatë vitit 2013, AMA ka vazhduar përpjekjet për nxitjen e ndërtimit të rrjeteve numerike, kombëtare, rajonale e vendore, nëpërmjet licencimit të tyre, mbështetur në frekuencat e planifikuara e të regjistruara tashmë në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave në ITU.

Siç është raportuar në raportet vjetore paraadhëse të KKRT-së, në datën 20.08.2009, janë shkarkuar në WISFAT 342 caktime frekuencore, që përfaqësojnë të gjitha frekuencat UHF të parashikuara në Planin GE06 për Shqipërinë.

Caktimet frekuencore numerike shqiptare të regjistruara në sistemin WISFAT<sup>22</sup> janë pasqyruar në BRIFIC<sup>23</sup>-et e lëshuara periodikisht nga ITU, deri në datën 17.06.2012, që ishte data finale e caktuar nga ana jonë në formularët e njoftimit. Me kalimin e afatit të mësipërm, caktimet frekuencore numerike të Shqipërisë u fshinë nga baza e të dhënave të ITU-së (pa i hequr të drejtën Shqipërisë të shfrytëzonte kapacitetet sipas marrëveshjes GE-06, pasi në plan vazhdonin të figuronin allotmentet e planifikuara). Fshirja e caktimeve të regjistruara është bërë për t'i hapur rrugë procedurës së notifikimit të caktimeve frekuencore për futjen në përdorim të këtyre caktimeve, në përputhje me pikën 5.1.1 të akteve finale të GE-06 që përcakton:

“5.1.1 Kur një administratë propozon të sjellë në përdorim një caktim për një stacion transmetimi, ajo duhet të njoftojë *Byronë*<sup>24</sup>, në përputhje me dispozitat e nenit 11 të *Radio Rregulloreve*<sup>25</sup>, karakteristikat e këtij caktimi, siç specifikohen në Aneksin 3 të *Marrëveshjes*<sup>26</sup>.

<sup>22</sup> WISFAT- Web Interface for Submission of Frequency Assignments/allotments (Terrestrial Services) Ndërfaqe Web për Aplikimin e Caktimeve Frekuencore (Shërbime Tokësore)

<sup>23</sup> The BR International Frequency Information Circular (BR IFIC) Terrestrial Services është një publikim rregullator i lëshuar çdo dy javë nga Byroja e Radiokomunikacioneve (Radiocommunication Bureau), sipas Radio Rregulloreve (Radio Regulations ) Nr. 20.1 deri tek 20.6 dhe Nr. 20.15 si dhe disa Marrëveshjeve Rajonale. Ai përmban informacion mbi caktimet/allotmentet frekuencore të paraqitura nga Administratat në Byronë e Radiokomunikacioneve për regjistrimin në Master Regjistrin e Frekuencave Ndërkombëtare (Master International Frequency Register) dhe në Plane/marrëveshje rajonale apo ndërbotërore. Informacioni i publikuar i korrespondon caktimeve/allotmenteve si dhe të gjitha notifikimeve në process. Formatu DVD-ROM u jep përdoruesve mundësinë e konsultimit të BR IFIC-ut direkt nga DVD-ROM, pa instaluar të dhënat (rreth 4 Gbytes) në hard disk.

<sup>24</sup> Byroja - Byroja e Radiokomunikacioneve e Bashkimit ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU)

<sup>25</sup> Radio rregulloret – rregulloret e ITU sipas neni 31 të Kushtetutës së ITU.

<sup>26</sup> Marrëveshja- Marrëveshja GE-06.

Për shkak të miratimit me vonesë të Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike (miratuar në maj 2012) si dhe të ligjit për mediat, (miratuar në mars 2013) gjatë vitit 2012, nuk u bë i mundur licencimi i rrjeteve numerike (kombëtare, rajonale dhe lokale). Këto vonesa bënë të pamundur dërgimin e notifikimeve (njëra nga të dhënat, që duhej dërguar për regjistrim ishte edhe emri i stacionit, që nuk mund të regjistrohej pa u bërë licencimi në përputhje me nenin 11 të RR<sup>27</sup>).

Në këto kushte, për t'i paraprirë procesit të digjitalizimit, në mënyrë që të shmangeshin vonesat në kryerjen e notifikimit, në bashkëpunim edhe me Byronë e Radiokomunikacioneve (BR) të ITU-s, duke përdorur një program të ITU-s, u krye konvertimi i njoftimeve të kryera në vitin 2009, në njoftime GT1 (GT1 notices), duke u lënë pa u plotësuar vetëm emri i stacionit, që do të njoftohet pasi të kryhet procesi i licencimit. Këto njoftime, tashmë në formatin e duhur u regjistruan në sistemin WISFAT gjatë muajit nëntor 2012. Viti i skadimit të këtyre caktimeve frekuencore tashmë është viti 2024, që siguron mbrojtje të mjaftueshme të caktimeve frekuencore shqiptare.

Sipas procedurave standarde të ITU-s, njoftimi i caktimeve frekuencore nuk do të thotë se janë plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara në planin e frekuencave numerike. Ndër kushtet përfshihen edhe shënimet (remarks) lidhur me koordinimin me vendet, të cilat afektohen nga Caktimet Frekuencore (CF) të planit numerik shqiptar (kolona R-1<sup>28</sup> në planin numerik). Detyra e BR është të shqyrtojë plotësimin e këtyre kushteve. BR-ja, pas shqyrtimit të njoftimeve të KKRT-së të dërguara në 2 nëntor 2012, ka publikuar në pjesën III të BRIFIC-ut, no. 2735 të 8 janarit 2013, njoftimet që janë gjetur “unfavorable” dhe që konsiderohen si të kthyera, në përputhje me procedurën e përshkruar në Nenin 11 të Radio Rregulloreve (RR). Lista e njoftimeve të kthyera jepet bashkëngjitur (170 CF) (*Aneksi 3/4*).

KKRT, pasi analizoi CF-të e kthyera, përgatiti materialin ku përcaktohen administratat, me të cilat duhet kryer procesi i koordinimit dhe caktimet frekuencore përkatëse, të cilat duhet të miratohen bashkërisht. Të dhënat janë nxjerrë nga Plani Numerik Shqiptar i miratuar në Konferencën GE-06 dhe njoftimet GT-1 dërguar në BR në 2 nëntor 2012.

Ky proces koordinimi vazhdoi gjatë gjithë vitit 2013.

---

<sup>27</sup> RR-Radio Rregulloret e ITU-s.

<sup>28</sup> Në Kolonën R-1 jepen simbolet e ITU-s për administratat, të cilave u preken caktimet analoge me futjen në punë të caktimit numerik

Edhe administratat e tjera, që janë të interesuara për futjen në punë të CF numerike, duhet të marrin miratimin e administratës shqiptare për caktimet e tyre frekuencore. Administrata italiane, që i ka futur në punë caktimet e saj frekuencore, është interesuar për përfundimin e procesit të koordinimit, por për shkak të pretendimeve të tyre të njohura, akoma nuk është arritur formalizimi. Sidoqoftë, procesi i koordinimit me Italinë është proces i hapur. Mbetet për t'u kryer koordinimi me Bosnjë e Hercegovinën, Malin e Zi, Serbinë, Kroacinë, Maqedoninë dhe Greqinë.

AMA, me anë të mjeteve të komunikimit (faks dhe email) ka njoftuar administratat e huaja për Caktimet Frekuencore “unfavorable” dhe është në pritje të komenteve të tyre për të vazhduar procedurat e përcaktuara në Aktet Finale të RRC-06. Sipas procedurave të paracaktuara, njëkohësisht me dërgimin e kërkesave për koordinim me secilën administratë, bëhet edhe njoftimi i BR-së.

#### **4.2.2. Koordinimi me vendet fqinjë**

##### **4.2.2.1. Koordinimi me Italinë**

Italia ka nënshkruar Marrëveshjen GE-06, por ende nuk e ka ratifikuar atë. Sidoqoftë, licencat e lëshuara për TV digjitale në Itali përfshijnë një deklaratë lidhur me nevojën për të respektuar Marrëveshjen GE-06.

Gjatë vitit 2013 janë kryer disa matje të spektrit në ndjekje të detyrave të lëna nga viti i kaluar për koordinimin e frekuencave (sidomos atyre për transmetime televizive numerike tokësore) me Italinë, pas takimit të zhvilluar në muajin prill 2012, në Romë.<sup>29</sup>

Nga matjet e zhvilluara në pikën e Llogorasë (shih tabelën), rezulton se administrata italiane ka lejuar transmetime numerike në pothuaj gjithë spektrin e transmetimeve audiovizive në UHF (470-790 MHz). Niveli i matur i sinjalit në këtë pikë arrin edhe 59 dB $\mu$ V, që është nivel jashtëzakonisht i lartë. Okupimi i brezit të frekuencave në pikën e Llogorasë, nga kanali 21 deri te kanali 60 jepet në tabelën e mëposhtme:

---

<sup>29</sup> Shih Raportin Vjetor KKRT 2012

**Tab. Okupimi i spektrit të frekuencave në VHF në pikën e Llogorasë**

Nr.	Kanali	Emri I TV	PËR (dB $\mu$ V)	Sistemi	Modulim	G. Int	Drejtimi
1	21	Digital IT / An GR	55 / 46	DVB-T	64 QAM	1/4	245° / 240°
2	22	Dig IT Telerama	55.9	DVB-T	64 QAM	?	245°
3	23	Digital IT	25.2	DVB-T	64 QAM		260°
4	24	Anal IT / DT Greke	28 / 22	?			280° / 140°
5	25	Zhurme	22	DVB-T			0-360°
6	26	Digital IT RAI	51.2	DVB-T	64 QAM		290°
7	27	Dig IT Telenorba	57	DVB-T	64 QAM		280°
8	28	Digital IT Jet srl	52.9	DVB-T	64 QAM		290°
9	29	Zhurme		DVB-T			0-360°
10	30	Digital IT RAI	58.2	DVB-T			280°
11	31	Digital	28.9	DVB-T			300° dobet
12	32	Digital IT RAI	62.9	DVB-T	64 QAM		290°
13	33	Dig IT Telenorba	57.1	DVB-T	64 QAM		270°
14	34	Zhurme					
15	35	Digital IT 7GOLD	52.6	DVB-T	64 QAM		270°
16	36	Dig IT Mediaset2	51.2	DVB-T	64 QAM		280°
17	37	Digital IT LA3	46.6	DVB-T	64 QAM		275°
18	38	Dig IT Mediaset3	49.1	DVB-T	64 QAM		260° 11 prog
19	39	Digital IT Ottagono	44.2	DVB-T	64 QAM		255° 12 prog
20	40	Digital IT RAI	53.5	DVB-T	64 QAM		265°
21	41	Zhurme					



AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

22	42	Digital IT Rete A2	61.5	DVB-T	64 QAM		265°
23	43	Zhurme	26.5	DVB-T			
24	44	Digital IT Rete A1	63	DVB-T	64 QAM		265°
25	45	Dig IT AntennaSud	56.5	DVB-T	64 QAM		265°
26	46	DigIT Canale Italia	53.5	DVB-T	64 QAM		265°
27	47	Digit IT TIMB1	54	DVB-T	64 QAM		265°
28	48	Digit IT TIMB3	50.6	DVB-T	64 QAM		265°
29	49	Digit IT Mediaset4	44.3	DVB-T	64 QAM		265°
30	50	Digit IT Dfree	48.9	DVB-T	64 QAM		265°
31	51	Analog grek	60				
32	52	Digit IT Mediaset1	57.5	DVB-T	64 QAM		265°
33	53	Dig IT Tele Dehon	51	DVB-T	64 QAM		265°
34	54	Digital i dobët		DVB-T			sinjal i dobët
35	55	Analog	29				
36	56	Digit IT Mediaset5	59.6	DVB-T	64 QAM		265°
37	57	Digit IT BS	41.2	DVB-T	64 QAM		265°
38	58	Analog Shqip (TVSH?)	54.5				130°
39	59	Digital IT Telenorba	50.6	DVB-T	64 QAM		265°
40	60	Digit IT TIMB2	48	DVB-T	64 QAM		265°

*Shënim:* Kanalet në rreshtat e ngjyrosur bëjnë pjesë në Planin Numerik Shqiptar.

Përdorimi i frekuencave, nga pala italiane, që në planin GE06 bëjnë pjesë në planin numerik shqiptar, është në kundërshtim me dispozitat e marrëveshjes GE06. Pala italiane insiston se përdorimi i këtyre kanaleve nuk do të shkaktojë interferencë në stacionet numerike shqiptare për shkak të fuqisë së ulët të rrezatuar, lartësisë efektive të vogël dhe drejtimit të antenave marrëse. Por, rezultatet e sjella në tabelën e mësipërme dëshmojnë që interferencat janë të

konsiderueshme. Kjo gjendje e konstatuar dikton përshpejtimin e koordinimit me palën italiane, për të siguruar një implementim të suksesshëm të rrjeteve numerike shqiptare.

#### 4.2.2.2. Koordinimi me Maqedoninë

Nga matjet në pikën e Qafë Thanës rezulton se edhe Maqedonia ka ndërtuar një numër të konsiderueshëm rrjetesh numerike. Megjithatë, ekzistojnë edhe disa kanale analoge. Maqedonia e ka respektuar planin e frekuencave numerike, duke transmetuar vetëm në kanalet e përcaktuara nga ky plan për Maqedoninë (8 kanale të evidentuara në 2 allotmente fqinjë me Republikën e Shqipërisë):

#### Qafë Thanë

Tab. Transmetimet numerike dhe Plani Numerik Shqiptar në pikën e Qafë Thanës.

Kanali	Emri i TV	ERP	Sistemi	Modulim	G. Int	Drejtimi	Plani Numerik
21							PN SH
22	Digital	53.2					PN M
23	Zhurme		DVB-T	64QAM	1/4	0 - 360°	PN G
26	Digital	35	DVB-T	64QAM	1/4	0 - 360°	PN M
27	Zhurme	22	DVB-T			0 - 360°	PN SH
28	Zhurme	22.2	DVB-T			0 - 360°	PN SH
32	Digital	61.2	DVB-T	64QAM	1/16	Ohri	PN M
36	Digital	59.6	DVB-T	64QAM	1/16	Ohri ?	PN M
37	Digital	55	DVB-T	64QAM	1/16		PN M
39	Digital	55.6	DVB-T	64QAM	1/16	130 Ohri	PN M
41	Digital		DVB-	64QAM	1/16		PN M

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

			T				
43	Zhurme	22.1				Ohri	PN SH
44	Digital	57.9	DVB-T	64QAM	1/16		PN M
45	Zhurme	22.1				0 - 360°	PN SH
51	Zhurme	21.8				0 - 360°	PN SH
52	Zhurme	21.8				Ohri ?	
53	Itel	21.8					
54	Zhurme	21.7				0 - 360°	
55	Zhurme	21.7				0 - 360°	PN SH
57	Zhurme	21.8				0 - 360°	PN SH
59	Zhurme	21.9				0 - 360°	PN SH
64	Zhurme	22.1				Ohri	PN SH

Shënim: Kanalet në rreshtat e ngjyrosur bëjnë pjesë në Planin Numerik të Shqipërisë.

Homesh

Tab. Transmetimet numerike dhe Plani Numerik Shqiptar në pikën e Homeshit (Peshkopi)

Kanali	TV	Niveli i sinjalit (dB $\mu$ V)	Sistemi	Modulimi	Drejtimi
24	Tv Bulqiza	49	A		Perendim
25					
30					
38					
41	Maqedoni	44	DVBT&H		Maqedoni
43	MPT (Maqedoni)	65	DVBT&H		Maqedoni
45	Ennsport Vitex	41	DVBT&H		Maqedoni
47	Tring	40	DVBT&H		Peshkopi
48	Drini 1	46	DVBT&H		Dibra Madhe

51	MPT (Maqedoni)	55	DVBT&H		Dibra Madhe
54					
55					
57	Sport Club 1	49	DVBT&H		Dibra Madhe
59	Sport Club 2	60	DVBT&H		Dibra Madhe
60					
69					
E8					

Transmetimet numerike maqedonase nuk afektojnë PNSH.

#### **4.2.2.3. Koordinimi me Greqinë**

Nga matjet në pikat që afektohen nga transmetimet greke (Bilisht, Leskovik, Kakavijë, Fushë Dropull, Ksamil, Sarandë, Llogora), rezulton se në Greqi vazhdojnë të jenë mbizotëruese transmetimet analoge, të cilat vijnë në pikat e matjeve brenda territorit shqiptar me nivele të konsiderueshme. I vetmi rrjet numerik grek u konstatua në pikën e matjes pranë doganës në Kakavijë (ch 23, 28.2 dB $\mu$ V, 16 QAM , GI i pamatshëm, drejtimi 155<sup>0</sup>).

#### **4.2.2.4. Koordinimi me Malin e Zi**

Në pikën e Taraboshit është konstatuar një numër kanalesh të Malit të Zi, ku kryhen transmetime numerike të sistemit DVB-T2. Në total me këto transmetime janë okupuar gjithsej 11 kanale, nga të cilat 4 i përkasin planit numerik malazez për allotmentin fqinjë me allotmentin shqiptar të Shkodrës, 2 i përkasin Planit Numerik të Malit të Zi për allotmente jo fqinjë me Shqipërinë dhe 5 (në brezin VHF) nuk i përkasin Planit Numerik të Malit të Zi.

Theksojmë se transmetime numerike malazeze konstatohen edhe në kanalin E 9, që bën pjesë në Planin Numerik Shqiptar (GE -06 D).

Kanalet numerike të Malit të Zi të marrë në pikën e Taraboshit

Kanali	Stacioni	ERP	Sistemi	Drejtimi	Plani Numerik
21	Malazez	44 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	PN MZ
23	Malazez	40 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	PN MZ jo fqinjë
24	Malazez	62 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	PN MZ
35	Malazez	60 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	PN MZ
E12	Digital Mali i Zi	34 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	-
E11	Digital Mali i Zi	34 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	-
E10	Digital Mali i Zi	35 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	-
<b>E9</b>	<b>Digital Mali i Zi</b>	<b>38 Db<math>\mu</math>v</b>	<b>DVBT2</b>	<b>Mali i Zi</b>	<b>PNSH</b>
E8	Digital Mali i Zi	38 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	PN MZ
E7	Digital Mali i Zi	60 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	PN MZ jo fqinjë
E5	Digital Mali i Zi	50 Db $\mu$ v	DVBT2	Mali i Zi	-

Okupimi i kanalit 9 VHF i caktuar për Shqipërinë, sipas GE06 do të jetë objekt i negociatave të ardhshme me Malin e Zi.

#### 4.2.3. Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve

Dividendi Digjital (DD) kompenson kërkesën në rritje për shërbimet me bandë të gjerë dhe hap një spektër të mjaftueshëm për aplikimet në këtë fushë.

Sipas vendimeve të Konferencave Botërore të Komunikacioneve, të vitit 2007 (WRC-07) dhe të vitit 2012 (WRC -2012), përdorimi i spektrit 470-862 MHz, i destinuar deri tani për transmetime televizive (sipas Planit Kombëtar të Frekuencave) është ndryshuar, duke caktuar një pjesë të tij (790-862) për transmetime me bandë të gjerë.

Siç përmendet edhe në Raportin e vitit të kaluar, brezi i frekuencave 790 – 862 MHz (Kanalet 61-69 UHF), aktualisht nën administrimin e AMA-s<sup>30</sup>, në territorin e Shqipërisë shfrytëzohet nga:

1. transmetime analoge ekzistuese (28 caktime frekuencore).

<sup>30</sup> Bazuar në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”

2. transmetime digjitale ekzistuese (jashtë planit GE-06) (28 caktime frekuencore të Digitalbit dhe 1 i Albanian Screen);
3. transmetime digjitale të planifikuara në Marrëveshjen GE-06 (17 caktime).

Bazuar në vendimet e Konferencave botërore të cituara më sipër, që janë bërë pjesë e legjislacionit shqiptar<sup>31</sup>, ky brez, në vitin 2015, duhet të jetë i liruar nga çdo lloj transmetimi televiziv, për t'u vënë në dispozicion të AKEP-it, i cili do të kryejë administrimin e tij, për t'i hapur rrugë licencimit të operatorëve të telekomunikacioneve. Nga lirimi i brezit të DD-së preken dy mbulime kombëtare, pasi nuk mund të përdoren dy frekuenca në allotmentin e Lezhës dhe dy frekuenca në allotmentin e Vlorës.

Nga punimet përgatitore për Konferencën WRC 2015, pritët që, në këtë konferencë, të miratohet edhe një brez i dytë i Dividendit Digjital (DD2) që do të prekë frekuencat 694-790 MHz. Shumë vende po operojnë në këtë drejtim duke marrë masa për lirimin paraprak të këtij brezi. Ndonëse implementimi i DD2 nuk është imediat (shumë vende e planifikojnë implementimin e DD2 pas vitit 2020), edhe Shqipëria duhet të përgatitet për këtë ndryshim.

#### ***4.2.4. Përgatitja e Planeve të frekuencave për fazën e parë për krijimin e rrjeteve numerike (MUX32 1 - MUX 5).***

##### ***4.2.4.1. Dokumentacioni Teknik i Rrjeteve Numerike MUX 1 dhe MUX 2***

Në përmbushje të kompetencave ligjore, AMA ka përgatitur dokumentacionin teknik të secilit prej rrjeteve numerike, të parashikuara të ndërtohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Dokumentacioni teknik i rrjeteve numerike përmban të dhënat teknike të nevojshme për ndërtimin e rrjeteve televizive numerike tokësore, (frekuencat (kanalet), fuqitë efektive të rrezatuara, lartësitë efektive të antenave, koordinatat dhe parametra të tjerë teknikë, sipas formularëve GT1 të regjistruar në MIFR (Regjistri Kryesor i Frekuencave Ndërkombëtare).

Edhe kjo punë voluminoze, mbështetur në përpjekjet disavjeçare të KKRT/AMA-s, u zhvillua me intensitet gjatë periudhës janar 2012- janar 2013 dhe u kurorëzua me miratimin e

---

<sup>31</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 466 datë 27.02.2013 "Për miratimin e planit kombëtar të frekuencave" Neni 70 i ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"

<sup>32</sup> "Multipleks" është një pajisje teknike për vijimin e sinjaleve numerike dhe bashkimin e tyre në një fluks numerik të dhënash. Në këtë rast përdoret për të identifikuar rrjetet numerike.

Vendimit nr. 27, datë 01.02.2013 “Për miratimin e frekuencave të Planit Numerik të dy rrjeteve numerike të RTSH (MUX1 dhe MUX 2).

Tabela e mëposhtme paraqet kanalet e akorduara për ndërtimin e MUX 1 dhe MUX 2.

Rrjetet Shqipëria	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korcë	Gjirok.	Vlorë
Rrj.1 TVSH (MUX-1)	28	26	38	43	34	23	27	25	43	26	23
Rrj.2 TVSH (MUX-2)	41	32	24	23	21	33	31	30	45	37	39

#### 4.2.4.2. Dokumentacioni Teknik i Rrjeteve Numerike MUX 3, MUX 4 dhe MUX 5

Me vendimin e AMA-s, nr.12, datë 02.07.2013 “Për çeljen e konkurrimit të dhënies së licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik, sipas procedurës *beauty contest*”<sup>33</sup> janë miratuar frekuencat e planit numerik për rrjetet kombëtare private MUX 3, MUX 4 dhe MUX 5 si dhe dokumentacioni teknik.

Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike përcakton që numri i rrjeteve private kombëtare do të jetë 3. Ky numër bazohet në kapacitetet e Planit Kombëtar të Transmetimeve Numerike, miratuar në GE-06.

<sup>33</sup> Kjo çështje trajtohet gjerësisht në pikën 4.2 të këtij kreu “Procedura e licencimit sipas “Beauty contest”.

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tabela e mëposhtme paraqet kanalet e akorduara për ndërtimin e MUX 3, MUX 4 dhe MUX 5.

Rrjetet Shqipëria	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korcë	Gjirok.	Vlorë
Rr.1 Komb.Priv. (MUX 3)	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46
Rr.2 Komb.Priv. (MUX 4)	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
Rr.3 Komb.Priv. (MUX 5)	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43

### 4.2.5. Përgatitja e specifikimeve teknike të marrësit numerik

Për realizimin e procesit të digjitalizimit, për të shmangur mospërputhjet midis rrjeteve të reja digjitale dhe marrësve që ndodhen në përdorim, është e domosdoshme të përcaktohen specifikimet e marrësve dhe specifikimet e testeve të përputhshmërisë.

Qëllimi i adoptimit të specifikimeve kombëtare është të mbrohen përdoruesit fundorë dhe operatorët e rrjetit, gjatë përdorimit të marrësve dhe gjatë ndërtimit të rrjeteve audiovizive. Këto specifikime shërbejnë si mbështetje teknike për prodhuesit dhe shitësit nga njëra anë dhe për autoritetet rregullatore nga ana tjetër.

Specifikimet teknike për marrësit janë hartuar mbështetur në rekomandimet e Projektit DigiTV dhe paraqesin kërkesat minimale të rekomanduara për marrësit DVB-T dhe DVB-T2 në rajonin e Evropës Juglindore.

### 4.3. Procedura e licencimit sipas “beauty contest”

Një nga objektivat prioritare të AMA-s gjatë vitit 2013, ishte licencimi i rrjeteve numerike private kombëtare dhe programeve që mbështeten në to.

Realizimi i kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike është një proces me rëndësi kombëtare dhe ndër më të rëndësishmit në fushën e transmetimeve radiotelevizive. Afati



përfundimtar i vendosur nga aktet ndërkombëtare<sup>34</sup> dhe legjislacioni kombëtar<sup>35</sup> për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike, është data 17 qershor 2015.

Procedura për digjitalizimin e rrjeteve analoge tokësore të operatorëve privatë kombëtarë parashikohet në nenin 139 të ligjit nr. 97/2013. Në këtë dispozitë ligjore parashikohet se: “ *b) AMA, bazuar në zhvillimet e tregut të transmetimeve audiovizive, përcakton operatorët privatë historikë kombëtarë, si dhe operatorët ekzistues, me eksperiencë në transmetimet numerike, që ftohen të marrin pjesë në procedurën e përzgjedhjes, sipas beauty contest-it për rrjetet numerike kombëtare. AMA, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bën njoftimin publik dhe fton operatorët për të marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes;*”.

#### **4.3.1.Puna përgatitore për hartimin e rregullores**

Projekti i rregullores “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to, nëpërmjet procedurës së “*beauty contest*”-it, me shkresën nr. 1001 prot., datë 23.05.2013, u dërgua për mendim te palët e interesuara, duke u kërkuar dhënien e komenteve, sugjerimeve dhe propozimeve konkrete mbi projektaktin. Projekti i rregullores u publikua edhe në faqen zyrtare të AMA-s. Subjektet televizive, që paraqitën vërejtje dhe sugjerime mbi projektin, ishin:

1. Platforma private “Tring” (shkresa nr. 0179 prot., datë 05.06.2013)
2. Subjekti televiziv privat kombëtar “Top Channel” (shkresa nr. 650 prot., datë 12.06.2013).
3. Platforma private “Digitalb” (shkresa nr.780/1 prot., datë 03.06.2013) propozoi mbajtjen e një tryeze të përbashkët me palët e interesuara, për diskutimin e çështjeve të projekt rregullores.

Propozimet dhe vërejtjet kryesore të platformës “Tring” ishin:

1. Kërkesa për t’u licencuar për 2 rrjete kombëtare (2 frekuenca);
2. Propozime për ndryshimin e raportit midis programeve hapur dhe programeve me akses të kushtëzuar nga 30% hapur që parashikonte projektregullorja në 10% hapur;
3. Mbështetja e operatorëve të tretë në platformat numerike të bëhet me marrëveshje me mbajtësit e licencës për transmetime numerike (kërkesë në kundërshtim me nenin 63 të ligjit nr. 97/2013 që përcakton raportin 60% me 40%);

<sup>34</sup> Marrëveshja GE-06, ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr. 9851 datë 26.12.2007 (Fletorja zyrtare nr. 187, datë 24.01.2008, faqe 588).

<sup>35</sup> Ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, neni 136.

4. Afati i garancisë bankare të mos jetë 1 vit sipas projektregullores, por 3 muaj dhe vlera e garancisë bankare të rishikohej nga 10% në 2% të vlerës së kapitalit;
5. Të rishikoheshin kriteret e hartimit të strukturës së programacionit, veçanërisht për programet sportive;
6. Afati i vlefshmërisë së licencës të bëhet 30 vjet (nga 15 vjet sipas ligjit 97/2013);
7. Përcaktimi në mënyrë të qartë i pagesave për licencë.

Disa nga propozimet dhe vërejtjet e subjektit televiziv “Top Channel” ishin:

1. *“... Top Channel ka shprehur me kohë vërejtjet dhe kundërshtitë e veta për vijimin e procesit, që në fazën e përgatitjes të dokumentit të strategjisë së kalimit në teknologjinë e re digjitale, strategji e cila duhet të ishte në themel të hartimit të ligjit dhe më pas në përgatitjet e rregulloreve përkatëse.*
2. *... në dokumentin strategjik është përcaktuar arbitrarisht numri i rrjeteve digjitale;*
3. *...pikat e transmetimit janë caktuar apriori, pa bërë asnjë llogaritje radioelektrike, sinkronizim të SFN, përcaktim të interferencës së rrjetit etj”.*
4. Kalimi nga sistemi DVB-T MPEG-2 në sistemin DVB-T2 dhe MPEG paraqet vështirësi;

Në këtë shkresë, Top Channel mes të tjerash, sugjeron: *“2. Të rishikojmë dokumentin strategjik, megjithëse formalisht i miratuar, për të përmirësuar procesin e kalimit. (...) Të përcaktohet realisht sasia e rrjeteve numerike që mund të ndërtohen, të cilët në rastin e rrjeteve kombëtare e rajonale rezulton se janë më shumë se 7”.*

Në vijim të procesit të këshillimit publik, për të diskutuar mbi projektregulloren “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to, nëpërmjet procedurës së *beauty contest-it*, bazuar edhe në kërkesën e platformës “Digitalb”, AMA organizoi 2 tryeza të përbashkëta me grupet e interesit, në datat 17 qershor 2013 dhe 28 qershor 2013. Në këto tryeza morën pjesë vetëm përfaqësues të operatorëve privatë “Vizion+” dhe “Tring” ndërsa, pavarësisht ftesës, nuk morën pjesë përfaqësues të subjekteve “Top Channel”, “Klan” dhe të platformës “Digitalb”. Këto tryeza u asistuan nga përfaqësues të OSBE-së dhe Delegacionit të BE në Tiranë.

Pas diskutimeve të zhvilluara në këto tryeza, pasi u bënë sqarimet, interpretimet dhe u parashtruan alternativat përkatëse, u arrit që, në disa prej neneve të projektregullores, të pasqyroheshin reflektimet e propozuara nga operatorët “Vizion+” dhe “Tring”, duke u bërë përmirësimet e duhura në tekstin e saj. Konkretisht, u pranua propozimi për ndryshimin e

përqindjes së raportit midis programeve që transmetohen hapur dhe atyre me akses të kushtëzuar nga 30% hapur, që parashikonte projektregullorja, në 10%, propozimi për rishikimin e kompozimit të platformës numerike etj.

Lidhur me pretendimet e televizionit kombëtar “Top Channel”, AMA nënvizon se vërejtjet dhe propozimet e këtij subjekti nuk lidheshin me përmbajtjen e projektregullores, por ishin vërejtje mbi Strategjinë e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe Ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Si pasojë, këto kërkesa dilnin jashtë kompetencave të AMA-s. Në çdo rast, AMA u ka kujtuar operatorëve që autoriteti rregullator zbaton vetëm kuadrin ligjor në fuqi.

Përcaktimi i numrit të rrjeteve numerike është bërë në përputhje me Strategjinë e miratuar, e cila përcakton licencimin e 3 rrjeteve numerike private kombëtare.

Dokumentacioni i licencimit, pjesë e së cilës janë pikat e transmetimit dhe karakteristikat teknike të stacioneve transmetuese, do të jepeshin pas shpalljes së konkurrimit sipas projektregullores. Llogaritjet radioelektrike janë përfunduar dhe caktimet frekuencore shqiptare janë regjistruar në regjistrin bazë të frekuencave ndërkombëtare (MIFR) të ITU-së (koordinatat, ERP, lartësitë efektive të antenave etj).

Kalimi nga sistemi DVB-T/MPEG-2 në sistemin DVB-T2/MPEG-4, ku përfshihet edhe pajisja me dekoderë të rinj është parashikuar në nenin 139 të ligjit 97/2013, i cili cakton një afat tranzitor deri në 3 vjet, për këtë kalim.

Pas kalimit të afatit 30 ditor të procesit të këshillimit publik, si dhe në zbatim të nenit 139 të ligjit sipas të cilit: “AMA, brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, bën njoftimin publik dhe fton operatorët për të marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes...”, (04 prill 2013 – 4 korrik 2013), AMA me vendimin nr. 10, datë 02.07.2013, ka miratuar rregulloren “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës *beauty contest*”.

Theksojmë se operatorët privatë “Top Channel” dhe “Digitalb”, që në procesin e konsultimit, por edhe pas miratimit të kësaj rregulloreje, kanë kundërshtuar vijimin e procesit të licencimit në mënyrë publike dhe konstante, duke arritur në propozime si propozimi i bërë me shkresën nr. 782 prot., datë 03.07.2013 (Top Channel) dhe shkresën nr. 984 prot, datë 03.07.2013 (Digitalb) në të cilin sugjerojnë: “*pezullimin e rregullores për një afat disa mujor dhe*

*rishikimin e plotë nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik pas rifillimit të punës nga ana e Kuvendit të Shqipërisë në legjislaturën e ardhshme".*

Është qartësisht e kuptueshme që sugjerime të tilla tejkalonin kompetencat e Autoritetit të Mediave Audiovizive që ushtron veprimtarinë e tij në përputhje dhe në zbatim të kuadrit ligjor.

#### **4.3.2. Rregullorja e licencimit sipas “beauty contest”**

Rregullorja “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre, nëpërmjet procedurës “beauty contest” përcakton kërkesat ligjore, financiare, teknike dhe programore që duhet të plotësojnë subjektet që do të ftohen nga AMA për t’u licencuar për transmetime kombëtare numerike. Gjithashtu, në rregullore parashikohen dispozitat lidhur me organizimin e konkurrimit sipas “beauty contest”, njoftimin e subjekteve, njoftimi publik, kërkesat për pjesëmarrje, afatet nga shpallja e konkurrimit deri në datën e hapjes së aplikimeve, rregullat për shqyrtimin e aplikimeve të subjekteve dhe afate për vendimmarrjen përkatëse.

Në rregullore parashikohet se në procesin e licencimit sipas “beauty contest”, ftohen të marrin pjesë operatorët privatë historikë kombëtarë, si dhe operatorët ekzistues, me eksperiencë në transmetimet numerike, ku përfshihen subjekte që operojnë njëkohësisht si operatorë rrjeti dhe programi dhe subjektet që ofrojnë shërbimin e programit të mbështetur në këto rrjete. Gjatë hartimit të rregullores u mbajt parasysh situata e programeve ekzistuese me qëllim përshtatjen me kërkesat dhe kriteret e ligjit në kompozimin e programeve të mbështetura në rrjete numerike, që është një nga funksionet më të rëndësishme të autoritetit rregullator.

Në rrjetet ekzistuese numerike, si Tring apo Digitalb, përveç programeve të konsideruara si të vetat (Top News, Digi +, Digi Film, Tring Comedy, Tring Max etj) transmetohen edhe programe të të tretëve, ku përfshihen:

- a) Programet e subjekteve televizive të licencuara për transmetime analoge vendore (Ora News, News 24, Tirana TV etj);
- b) Programe të huaja (Italia Uno, Alpha, BBC, CNN, Euronews, Fox Crime etj);
- c) Programe të hapura dhe me akses të kushtëzuar.

Kriteret e licencimit të programeve të mësipërme përcaktohen nga AMA.

Në rregullore përcaktohet se numri i licencave të transmetimeve numerike private kombëtare, që i nënshtrohet rregullimit sipas *beauty contest*, është 3 (tre). Ky përcaktim është në përputhje edhe me Strategjinë e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, e cila parashikon se: “... Bazuar në kapacitetet e Planit Kombëtar të Transmetimeve Numerike, gjendjen ekzistuese dhe kërkesat e tregut, duke llogaritur edhe perspektivën, paraprakisht numri i rrjeteve private kombëtare për fazën e parë do të jetë 3”.

Në rast se në përfundim të procedurës së licencimit sipas *beauty contest*, rezulton se nuk është dhënë 1 ose më shumë licenca kombëtare për transmetime audiovizive, AMA organizon konkurrimin e hapur sipas procedurave të licencimit, të përcaktuara në ligj.

Lidhur me mënyrën e ofrimit të shërbimit për publikun, rregullorja përcakton që ky shërbim të ofrohet mbështetur në situatën aktuale, duke shtuar detyrimin që programet e destinuar për t’u transmetuar pa pagesë të merren nga publiku pa paguar asnjë tarifë.

Përveç detyrimeve të parashikuara në ligj, këto subjekte duhet të përmbushin edhe kushtet e mëposhtme:

- a. lirim të frekuencave të zëna arbitrarisht, nëse operojnë në kushte të tilla, dhe të migrojnë në frekuencat e përcaktuara në Planin Numerik (GE 06), sipas specifikimeve të AMA-s, brenda një kohe të përcaktuar në licencë;
- b. secili operator licencohet për një rrjet kombëtar numerik DVB-T2 me standard kompresioni MPEG-4. Në licencë vendosen afate të përcaktuara kohore për kalimin në DVB-T2 dhe MPEG-4, por jo më shumë se tre vjet nga momenti i licencimit;
- c. mbështetjen e rrjeteve të operatorëve vendorë për programet, si dhe për bashkëpërdorimin;
- d. sigurimin e aksesit të barabartë, mosdiskriminimin dhe transparencën;
- e. standardizimin e sistemeve të aksesit të kufizuar për mbrojtjen nga programet me karakter dëmtues për të miturit;
- f. aplikimin e shërbimeve të reja dhe interaktive.

Në rregullore parashikohet që subjekti, i cili do të pajiset me licencë për transmetim audioviziv kombëtar, konsiderohet i autorizuar për ofrimin e shërbimit të aksesit të kushtëzuar për programet e veta dhe të të tretëve, që mbështeten në rrjetin e tij.

#### 4.3.3 Ecuria e procedurës së licencimit sipas “*beauty contest*”

Me vendimin nr. 12, datë 02.07.2013 “Për çeljen e procedurës së dhënies së 3 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik sipas *beauty contest*”, AMA, ka vendosur të ftojë për paraqitjen e aplikimit për licenca të shërbimit të programeve të veta audiovizive dhe licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit tokësor, subjektet e mëposhtme:

1. Shoqëria “Digitalb” sh.a.,
2. Shoqëria “Media 6” sh.a.,
3. Shoqëria “Media Vizion” sh.a.,
4. Shoqëria “Top Channel” sh.a. dhe
5. Shoqëria “Tring TV” sh.a.

Bazuar në vendimet e mësipërme, çelja e procedurës të dhënies së 3 licencave private kombëtare transmetimi audioviziv numerik, sipas *beauty contest*, u shpall në mënyrë publike në datën 05.07.2013, (njoftim në gazetat Panorama, Standard, Shekulli, Mapo dhe Gazeta Shqiptare, rubrikat e njoftimeve të operatorit publik RTSH) duke caktuar si afat përfundimtar të paraqitjes së aplikimeve, datën 15.08.2013, ora 10.00.

Disa prej subjekteve të ftuara për paraqitjen e aplikimit, konkretisht shoqëria “Digitalb” sh.a., shoqëria “Media 6” sh.a., dhe shoqëria “Top Channel” sh.a., pasi janë njoftuar për zhvillimin e konkurrimit, kanë investuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar anulimin e akteve administrative të AMA-s, si dhe pezullimin e zbatimit të tyre. Më konkretisht, objekti i padisë së tyre është:

1. Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të akteve administrative: Nenit 16 të rregullores “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre nëpërmjet procedurës “*beauty contest*”; Vendimit nr. 12, datë 02.07.2013 “Për çeljen e konkurrimit të dhënies së licencave private kombëtare për transmetimin audioviziv numerik sipas procedurës “*beauty contest*”; Të procedurave të nisura në zbatim të këtij vendimi (të nxjerra në bazë të rregullores) si dhe detyrimin e AMA-s për të nxjerrë rregulla për organizimin e Beauty Contest konform ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”.

2. Marrjen e masës së pezullimit të zbatimit të akteve administrative, vendimit nr. 12, datë 02.07.2013 “Për çeljen e konkurrimit të dhënies së licencave private kombëtare për transmetimin audioviziv numerik sipas procedurës “*beauty contest*”, si dhe të procedurave të nisura në zbatim të këtij vendimi, si dhe nenit 16 të rregullores “Për licencimin e rrjeteve

numerike dhe programeve të tyre nëpërmjet procedurës “*beauty contest*”, miratuar me vendimin nr. 10, datë 02.07.2013 (në bazë të së cilës ka dalë edhe vendimi nr. 12, datë 02.07.2013), deri në përfundim të gjykimit.

Neni 16 i rregullores përcakton “Kërkesat Financiare”, që duhet të plotësojnë subjektet aplikues për t’u pajisur me licencë për transmetime numerike kombëtare audiovizive, duke përcaktuar se: “1. *Licenca kombëtare e transmetimit audioviziv u jepet subjekteve që kanë kapital të deklaruar e të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, në vlerën jo më pak 1 miliard lekë. 2. “Subjekti aplikues duhet të paraqesë garanci bankare në masën 2% të vlerës së preventivit të parashikuar për ndërtimin e rrjetit apo situacionit për punimet e kryera për rrjetet ekzistuese”.*

Gjatë gjykimit të çështjes, AMA, kërkoi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, pasi çështja objekt gjykimi duhej të ishte objekt i juridiksionit administrativ. Pala paditëse nuk kishte paraqitur ankim administrativ ndaj vendimeve të AMA-s objekt gjykimi, por në shkelje të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile investoi gjykatën duke mos ezauruar fillimisht rrugën administrative. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin e datës 30.07.2013, vendosi rrëzimin e kërkesës së AMA-s. Kundër këtij vendimi, AMA, ka paraqitur rekurs të veçantë pranë Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 16090 Akti, datë 31.07.2013, pavarësisht pretendimeve të AMA-s, vendosi marrjen e masës së pezullimit të zbatimit të akteve administrative, objekt shqyrtimi gjyqësor, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes. Kundër këtij vendimi, nga ana e AMA-s është depozituar ankimi përkatës pranë Gjykatës së Apelit Tiranë dhe çështja është ende në shqyrtim gjyqësor.

Aktualisht, kjo çështje gjyqësore është duke u gjykuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

Në vlerësimin e AMA-s, vendimi i gjykatës është i paargumentuar dhe i pambështetur në ligj për shkak se:

a) Asnjë prej palëve paditëse nuk arritën të provonin para gjykatës dëmin e rëndë dhe të pazëvendësueshëm që do të pësonin nëse këto akte administrative do të prodhonin efektet e tyre. Ky dëm duhet të ishte eminent, i lindur dhe aktual, i cili të sillte një risk të madh dhe jo imagjinar për palën paditëse.

Po ashtu, gjykata nuk mori parasysh dëmin e rëndë që pësohet për shkak të pezullimit të zbatimit të këtyre akteve:

b) penalizohet shteti shqiptar për shkak të shkeljes së afateve të përcaktuara në aktet ndërkombëtare dhe kombëtare, që përcaktojnë datën 17 qershor 2015 si afatin përfundimtar për kalimin në transmetimet numerike.

Vonesa në licencimin e rrjeteve numerike pengon mbylljen e transmetimeve analoge dhe për pasojë pengon lirimin e brezit të DD. Shfrytëzimi i këtij brezi për shërbime mobile me bandë të gjerë do t'i krijonte shtetit të ardhura të konsiderueshme që arrijnë më miliona euro. (nga licencimi dhe pagesat vjetore për licencë). Vetëm Gjermania, nga ankandi i zhvilluar në vitin 2010 për dhënien në përdorim të spektrit 2x30 MHz, ka siguruar një të ardhur prej 3.47 miliardë euro.

c) Pezullimi i procesit të licencimit sipas procedurës së “*beauty contest*” sjell moszbatimin e ligjit 97/2013 “Per mediat audivizive në Republikën e Shqipërisë” duke i shkaktuar një dëm të madh ekonomik jo vetëm AMA-s, por edhe buxhetit të shtetit, për shkak të mosrealizimit të të ardhurave të parashikuara nga licencimi i tre rrjeteve numerike private kombëtare.

Për shkak të vendimit të gjykatës, me të cilin u vendos pezullimi i zbatimit të vendimeve të AMA-s, konkurrimi i parashikuar për datën 15.08.2013, nuk u zhvillua.

Pretendimet mbi vlerën e lartë të kapitalit financiar dhe garancisë bankare, nuk janë paraqitur asnjëherë nga palët paditëse gjatë procesit të konsultimit dhe komunikimeve shkresore.

Kërkesat financiare janë miratuar bazuar në nenet 56 dhe 71 të ligjit 97/2013 të sipërcituar, si dhe në koston e përafërt të ndërtimit të një rrjeti numerik kombëtar. Strategjia e Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike, ka përcaktuar se vlera e përafërt për ndërtimin e një rrjeti numerik kombëtar është 12.8 milionë euro. Për pasojë, kërkesa për kapital financiar prej rreth 7.2 milionë euro është plotësisht e justifikuar. Për më tepër, në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 9742, datë 28.5.2007, KKRT ka licencuar, në vitin 2009, shoqërinë “Tring” sh.a., shoqërinë “Digitalb” sh.a. dhe shoqërinë “Supersport” sh.a., si platforma private numerike satelitore me kërkesat për kapital financiar të njëjta me kërkesat e përcaktuara në rregulloren “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve të tyre nëpërmjet procedurës “*beauty contest*”, e cila sot kundërshtohet (po 1 miliard lekë).



Siç aplikohet në çdo procedurë licencimi, sidomos për përdorimin e burimeve natyrore të kufizuara, është e domosdoshme paraqitja e garancive të nevojshme për të siguruar realizimin e investimit. Garancia bankare kërkohet për të shmangur humbjet që shkaktohen nga dështimi eventual i ndërtimit të rrjetit nga një subjekt që ka fituar licencën pa patur mjetet e nevojshme financiare. Në variantin fillestar të projektregullores, kjo tarifë ka qenë 10% e preventivit të ndërtimit të rrjetit, por më pas gjatë procesit të konsultimit publik me propozim të operatorëve “Vizion+” dhe “Tring”, vlera minimale e garancisë bankare është vendosur 2% e vlerës së preventivit të parashikuar për ndërtimin e rrjetit apo situacionit për punimet e kryera për rrjetet ekzistuese (rreth 256.000 euro).

Pezullimi i procesit të licencimit të rrjeteve numerike private kombëtare sipas procedurës së *beauty contest*, ka bllokuar të gjithë procesin e kalimit në transmetimet numerike, proces i cili përbën një angazhim ndërkombëtar të shtetit shqiptar.

#### **4.4 Puna për përgatitjen e kalimit në transmetimet numerike tokësore të operatorëve ekzistues analogë privatë lokalë**

Digjitalizimi i rrjeteve analoge vendore ekzistuese, përbën detyrim që buron nga ligji nr. 97/2013 dhe Strategjia për Kalimin nga Transmetimet Analoge në ato Numerike.

Këto akte juridike përcaktojnë që kalimi në transmetimet numerike të realizohet pa prishur strukturën ekzistuese të tregut mediatik lokal që funksionon si treg i programeve të transmetuara hapur (pa pagesë) dhe që financohet nga reklamat. Operatorët privatë lokalë, duke qenë më pranë komuniteteve lokale, përfaqësojnë vlera të pluralizmit të mendimeve, programeve, minoriteteve, etj, vlera që duhen ruajtur e promovuar. Krijimi i mundësive për mbështetjen e programeve të tyre në platforma numerike pa sforcime të fuqishme ekonomike, i shërben edhe ruajtjes së strukturës ekzistuese të tregut, ku përdoruesit janë mësuar të marrin disa programe hapur (pa pagesë). Transmetimi hapur parandalon fenomenin e “ndarjes digjitale” (digital divide), ku publiku në nevojë, privohet nga marrja e programeve audiovizive.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, lindi domosdoshmëria për harmonizimin e të drejtave dhe detyrimeve të subjekteve analoge ekzistuese të licencuara sipas ligjit të mëparshëm, me dispozitat e ligjit të ri.

Për të orientuar subjektet analoge ekzistuese në përgatitjen për mbështetjen e programeve të tyre në rrjete numerike, me shkresën nr. 986 prot., datë 17.05.2013, AMA, ka kërkuar nga

këto subjekte zgjedhjen e një prej alternativave të ligjit, me qëllim nxitjen e një kalimi të lehtë të transmetimit nga teknologjia analoge në atë numerike. Në nenin 139 të ligjit të lartpërmendur përcaktohen alternativat që mund të përzgjidhen nga operatorët vendorë analogë ekzistues.

Këto alternativa janë:

a. Mbështetja e programeve analoge ekzituese vendore në rrjetin numerik të televizionit publik ose rrjetet e tjera numerike, të cilat do të licencohen sipas procedurës së *beauty contest-it*;

b. Aplikimi bashkërisht për një licencë rrjeti numerik vendor brenda një zone të planifikuar për t'u mbuluar nga një rrjet SFN, sipas planit të frekuencave numerike;

Në rastin e zgjedhjes së kësaj alternative, operatorët ekzistues analogë, që përfshihen brenda një allotmenti, duhet të negociojnë për përgatitjen e marrëveshjes midis tyre për ndërtimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të rrjetit dhe të njoftojnë zyrtarisht Autoritetin e Mediave Audiovizive për arritjen e marrëveshjes. Në rastin e arritjes së marrëveshjes prej të paktën 70 për qind të operatorëve, AMA miraton dhënien e licencës për transmetime numerike lokale, shoqërisë së re të krijuar nga bashkimi i subjekteve ekzistuese, pa kaluar në procesin e konkurrimit.

c. Pjesëmarrje në konkurrimin publik për licencë për rrjetin numerik vendor

Në rast se marrëveshja për ndërtimin e përbashkët të rrjetit numerik nuk arrihet prej të paktën 70 për qind e operatorëve ekzistues analogë dhe se operatorët analogë ekzistues nuk do të mbështesin programin e tyre në rrjetin numerik të TVSH-së ose rrjetet e tjera numerike, atëherë AMA organizon konkurrimin e hapur për licencim për transmetime numerike lokale në 11 allotmentet, në përputhje me përcaktimet e nenit 70 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë".

Shkresës së mësipërme të AMA-s i janë përgjigjur 28 subjekte vendore dhe rajonale (deri në 4 qarqe) nga 63 operatorë ekzistues gjithsej. Nga këta:

- 12 subjekte kanë zgjedhur mbështetjen në rrjetin numerik të TVSH-së;
- 11 subjekte kanë zgjedhur ndërtimin bashkërisht të rrjeteve lokale;
- 2 subjekte kanë zgjedhur mbështetjen në operatorë privatë;
- 3 subjekte nuk kanë vendosur akoma dhe kërkojnë shtesë afati.

Për shkak të pezullimit të ndërtimit të rrjetit të operatorit publik dhe pezullimit të procesit të licencimit të operatorëve privatë kombëtarë, disa nga operatorët vendorë nuk kanë vendosur për alternativën që do të zgjedhin.

Zhblllokimi i proceseve të digjitalizimit të rrjeteve të RTSH-së dhe të operatorëve historikë dhe me eksperiencë numerike, do të hapë rrugë edhe për licencimin e rrjeteve numerike vendore.

#### ***4.4.1 Impakti i RTSH-së në procesin e kalimit në transmetimet numerike tokësore***

Radio e Televizioni Shqiptar (RTSH) ka rol kyç në procesin e kalimit në transmetimet numerike dhe konsiderohet si mbështetësja kryesore e programeve të operatorëve ekzistues analogë vendorë.

Duke patur në konsideratë këtë rol të RTSH-së dhe bazuar në kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, AMA ka kërkuar kontributin dhe bashkëpunimin e RTSH-së, për koordinimin e masave të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të përbashkëta.

Me qëllim arritjen e rezultateve konkrete, AMA me shkresën nr. 1151 prot., datë 11.06.2013, ka kërkuar nga RTSH:

- a. Përcaktimin e kriterëve dhe numrit të programeve me karakter publik që do të transmetohen hapur (pa pagesë). Përmbushja e kësaj detyre kërkon përcaktimin e kriterëve për klasifikimin e programeve si program me karakter publik, përgatitjen e listës me programet e propozuara si programe publike, organizimin e konsultimit publik, vendimmarrjen mbi numrin dhe emërtimin e kanaleve publike si dhe shpenzimet e nevojshme për mbështetjen e këtyre programeve.
- b. Përcaktimin e kriterëve dhe numrit të programeve me akses të kushtëzuar (me pagesë) Përmbushja e kësaj detyre kërkon përcaktimin e kriterëve dhe tematikës për programet me akses të kushtëzuar, përgatitjen e biznes planit për rentabilitetin e programeve me akses të kushtëzuar, vendimmarrjen mbi numrin dhe biznes planin e shërbimeve me akses të kushtëzuar.
- c. Koordinimi me operatorët privatë lokalë për mbështetjen e tyre në MUX 1. E drejta e operatorëve vendorë analogë për t’u mbështetur në rrjetin e operatorit publik, garantohet edhe nga neni 139 i ligjit (cituar më lart). Përmbushja e kësaj detyre kërkon hartimin e kontratës tip midis RTSH-së dhe operatorëve privatë lokalë,

modeli i së cilës do të miratohet nga AMA, koordinimin me operatorët privatë për përcaktimin e detajeve teknike të sjelljes së sinjaleve të tyre në qendrat e allotmenteve, ndjekjen e problemeve teknike gjatë periudhës simulcast, caktimin e ambjenteve të RTSH-së në qendrat e allotmenteve, nënshkrimin e marrëveshjes me operatorët lokalë për sjelljen e sinjaleve të tyre në MUX.

Pavarësisht, komunikimeve të vazhdueshme shkresore, konstatojmë se RTSH nuk ka reaguar, duke u bërë pengesë për mbarëvajtjen e procesit të kalimit në transmetimet numerike.

#### **4.5 Drejtimi i procesit të digjitalizimit**

Për zbatimin e Strategjisë dhe ndjekjen e gjithë procesit deri në kalimin e plotë në transmetimet numerike, me Urdhrin nr. 70 datë 12.06.2012, të Kryeministrit është ngritur Komiteti Ndërmintor, i cili kryesohet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit. Ky Komitet është përgjegjës për koordinimin e veprimtarive lidhur me implementimin e Strategjisë deri në mbylljen e transmetimeve analoge, si dhe propozimin e të gjitha vendimmarrjeve të nevojshme për realizimin në afat të këtij procesi tek organet kompetente.

Pas zgjedhjeve të 23 qershorit dhe formimit të Qeverisë së re, Komiteti Ndërmintor nuk është mbledhur. Kontributi i Komitetit Ndërmintor, për realizimin e procesit të digjitalizimit është i domosdoshëm, për shkak se disa nga çështjet e strategjisë, si subvencionimi i dekodeve, financimi i ndërtimit të rrjetit të RTSH-së, organizimi i fushatës për informimin e publikut, etj, janë çështje për të cilat kërkohet vendimmarrje nga Qeveria.

##### ***4.5.1 Grupi i punës për studimin e mundësisë për rritjen e numrit të mbulimeve me rrjete numerike tokësore***

Në periudhën raportuese, me urdhrin nr. 4086, datë 03.12.2013, “Për studimin e mundësisë për rritjen e numrit të mbulimeve me rrjete numerike tokësore në përputhje dhe pa cënuar planin e frekuencave numerike të miratuar nga Marrëveshja GE-06” të Ministrit për Inovacionin dhe Administratën Publike, është ngritur grupi i punës me objekt studimin e mundësive për ndryshimin e kapaciteteve transmetuese bazuar në planin e frekuencave numerike.

Në grupin e punës merrnin pjesë përfaqësues të Ministrisë për Inovacionin dhe Administratën Publike, të AMA-s, AKEP-it, përfaqësues të subjekteve televizive kombëtare (Top Channel,

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

TV Klan, Vizion Plus), përfaqësues të platformave numerike (Digitalb, Tring) dhe përfaqësues nga RTSH. Mbledhjet e grupit të punës janë asistuar dhe nga përfaqësuesit e OSBE dhe Këshillit të Europës.

Në përmbushje të qëllimit për të cilin është ngritur grupi i punës, janë kryer matjet e shfrytëzimit të spektrit të radiofrekuencave për transmetimet televizive në të gjithë vendin, nga ekipe të përbashkëta të përbëra nga specialistë të AMA-s dhe AKEP-it.

**5. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE FINANCIARE****5.1. Burimet njerëzore dhe administrative**

Kalimi nga transmetimet analoge në ato numerike, që është përcaktuar si proces prioritar në të gjitha vendet evropiane, anëtare të Bashkimit Evropian, përbën një nga sfidat madhore në fushën e medias dhe është një proces me ndikim të gjerë në gjithë shoqërinë shqiptare.

Zhvillimet e rëndësishme të ndodhura në fushën e medias në Shqipëri, duke filluar me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Kalimin nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike (maj 2012), si dhe me miratimin në mars 2013 edhe të ligjit të ri nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, duhet të shoqërohen domosdoshmërisht me ndryshimet e nevojshme strukturore, për t’iu përgjigjur me efikasitet nevojave dhe kapaciteteve që kërkon ky kalim.

Forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike të Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), ka qenë dhe mbetet një angazhim i përhershëm, duke synuar realizimin në mënyrë të suksesshme dhe të plotë të detyrimeve funksionale, që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit, si dhe plotësimin e standardeve dhe praktikave më të mira evropiane në këtë fushë.

Aktualisht, burimet njerëzore dhe financiare të AMA-s mbeten të kufizuara, gjë që vështirëson dhe krijon vonesa në respektimin e afateve kohore të vendosura nga legjislacioni kombëtar dhe aktet ndërkombëtare për kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike (17 Qershor 2015).

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe forcimi i kapaciteteve administrative vazhdon të mbetet pjesë e rekomandimeve të dhëna nga shërbimet e Komisionit Evropian, në kuadër të takimeve të formateve të ndryshme, të zhvilluara në kuadër të procesit të integritit evropian. Edhe rekomandimet e dala nga takimi i pestë i Nën-Komitetit BE-Shqipëri “Inovacioni, Shoqëria e Informacionit dhe Politikat Sociale”, të zhvilluar më datë 29-30 tetor 2013, në Tiranë, theksonin, ndërmjet të tjerash, nevojën e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative të AMA-s. Forcimi i kapaciteteve administrative dhe teknike është theksuar edhe në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2013, ku në mënyrë të përsëritur konstatohet se “... AMA vazhdon të mos ketë kapacitete të mjaftueshme....”.

Për rrjedhojë, menjëherë pas hyrjes në fuqi të ligjit të ri (prill 2013), AMA zyrtarisht i paraqiti Kuvendit të Shqipërisë kërkesën<sup>36</sup> për miratimin e projektstrukturës, organikës dhe numrit të punonjësve të administratës së AMA-s.

Ndryshimet strukturore të paraqitura, kanë si qëllim pasjen e një strukture eficiente dhe me fleksibilitet më të madh për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet dhe çështjet që hasen si pasojë e zhvillimeve teknologjike në fushën e medias, si dhe përshpejtimin e proceseve të kalimit në sistemin numerik, duke qenë në një linjë me filozofinë rregullatore të disa vendeve të Bashkimit Evropian, si dhe duke iu përshtatur kërkesave dhe nevojave që kërkon realizimi i detyrimeve të parashikuara nga Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive.

Me fillimin e Legjislaturës së re, AMA iu drejtua<sup>37</sup> përsëri Kuvendit të Shqipërisë, duke nënvizuar faktin se është e domosdoshme që të trajtohej me përparësi maksimale nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, diskutimi dhe miratimi i strukturës së re të AMA-s.

Pavarësisht se kjo kërkesë është dërguar që në 1 tetor 2013, deri më sot nuk është marrë asnjë hap konkret për diskutimin dhe miratimin e kësaj strukture.

Gjithashtu, duhet të theksohet fakti se, që prej disa vitesh AMA ka disa vende vakante. Edhe për këtë çështje është informuar zyrtarisht disa herë Kuvendi i Shqipërisë. Mungesa e anëtarëve të AMA-s vështirëson punën e institucionit, por pavarësisht kujtesave të institucionit, kjo çështje vazhdon të mbetet e pazgjidhur.

Gjatë vitit raportues, Kryetarja Endirë Bushati dhe anëtarët Suela Musta dhe Zylyftar Bregu kanë marrë pjesë në 19 mbledhjet e zhvilluara, zëvendëskryetari Sami Nezaj ka marrë pjesë në 18 mbledhje dhe anëtari Gent Ibrahimimi ka marrë pjesë në 13 mbledhje.

Gjithashtu, institucioni brenda kapaciteteve të tij të kufizuara financiare, është përpjekur të mundësojë trajnimin e stafit nëpërmjet pjesëmarrjes në aktivitete dhe takime të ndryshme, kombëtare dhe ndërkombëtare, gjë që ka mundësuar njohjen me standardet dhe praktikat më të mira, sidomos për sa i përket çështjeve të kalimit nga sistemi analog në atë numerik.

Veçanërisht, këtu duhet të përmenden takimet dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit “Televizioni Digjital i Evropës Juglindore (*SEE Digi TV*)”, brenda Programit të

---

<sup>36</sup> Shkresa nr.864 prot, datë 11.04.2013

<sup>37</sup> Shkresa nr.1563, datë 1.10.2013

Bashkëpunimit Ndër-nacional të Evropës Juglindore, të financuar nga Bashkimi Evropian.

Takimet dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të këtij projekti nxitën komunikimin, shkëmbimin e informacionit, ideve, eksperiencat e ndërsjellta dhe praktikatat më të mira ndërmjet vendeve partnere. Ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe më tej, duke pasur parasysh fazat e ndryshme të procesit të digjitalizimit, në të cilat ndodhen vendet e rajonit.

Autoriteti i Mediave Audiovizive është përpjekur në maksimum për realizimin e detyrimeve të marra në kuadër të Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), 2012-2015, angazhimeve dhe rekomandimeve të dala nga takimet e zhvilluara me përfaqësues të Bashkimit Evropian, nëpërmjet raportimit të vazhdueshëm dhe periodik, për ecurinë e zbatimit të tyre, pranë Ministrisë së Integrimit Evropian.

Ashtu siç kemi raportuar edhe më parë, kapacitetet monitoruese të institucionit vazhdojnë të jenë të njëjta. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të mundësuar realizimin e një projekti për përmirësimin e kapaciteteve monitoruese, nëpërmjet buxhetit të shtetit apo donacione të ofruara nga partnerë ndërkombëtarë, deri më sot nuk është arritur që të sigurohen burimet e nevojshme financiare.

Pajisja me ambiente të reja pune vazhdon të mbetet një tjetër shqetësim permanent. Me keqardhje konstatojmë se, pavarësisht reagimit të vazhdueshëm për situatën në të cilën ndodhet institucioni, pas vendimit gjyqësor për lirimin e ambienteve të punës dhe kthimit të tyre një subjekti privat, nuk është marrë asnjë veprim për të adresuar dhe zgjidhur këtë problem.

### **5.2. Marrëdhëniet me jashtë**

Forcimi i marrëdhënieve me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë në fushën e medias elektronike, vazhdon të mbetet një nga prioritetet e punës së Autoritetit të Mediave Audiovizive. Për rrjedhojë, edhe gjatë vitit 2013, konstatohet një rritje e kontakteve dhe takimeve me organizmat ndërkombëtarë, ku AMA është palë, si dhe me partnerë të tjerë rajonalë dhe më gjerë, me synim shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave evropiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Liria e medias konsiderohet një element mjaft i rëndësishëm, që ka një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në kuadër të proceseve integruese. Në këtë aspekt, takimet e zhvilluara me përfaqësues të Shërbimeve të Komisionit Evropian, vazhdojnë të mbeten prioritare. Gjatë



vitit 2013, në kuadër të zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA) janë zhvilluar 2 takime, në axhendën e të cilave përfshiheshin edhe çështjet e medias, dhe më konkretisht:

- *Takimi i Katërt i Komitetit të Stabilizim-Asociimit*, që u zhvillua në Bruksel, më datë 8 mars 2013, i fokusuar, ndërmjet te tjerash, edhe në çështjet e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe medias.
- *Takimi i Pestë i Nën-komitetit BE-Shqipëri “Mbi inovacionin, shoqërinë e informacionit dhe politikën sociale”*, që u zhvillua në Tiranë, më datë 28-29 tetor 2013, në axhendën e të cilit përfshihen çështje, ndërmjet të tjerash, që lidheshin me zhvillimet më të fundit në fushën e medias (ecuria e procesit të digjitalizimit, zhvillimet legjislative/rregullatore, pavarësia e AMA-s etj).

Në këto takime morën pjesë përfaqësuesit më të lartë të AMA-s, të cilët paraqitën progresin e bërë nga institucioni, hapat që po ndërmerren, si dhe problematikat e hasura në kuadër të procesit të digjitalizimit.

Në datat 14-15 shkurt 2013, u zhvillua në Tiranë takimi i 9-të në kuadër të projektit “Televizioni Digjital i Evropës Juglindore (SEE Digi TV)”, brenda Programit të Bashkëpunimit Ndër-nacional të Evropës Juglindore, të financuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet Programit IPA. Ky takim u organizua nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, si partner në këtë projekt.

Takimi u fokusua kryesisht në diskutimet ndërmjet autoriteteve rregullatore partnere në lidhje me ecurinë e zbatimit të aktiviteteve të ndryshme, që përfshihen brenda paketës ligjore, teknike, ekonomike, si dhe paketës së ndërgjegjësimit të publikut, statusin aktual të tyre, si dhe hapat dhe aktivitetet, që parashikoheshin për t’u realizuar deri në përfundim të projektit.

Gjithashtu, edhe gjatë vitit raportues, një rëndësi e veçantë i është kushtuar zbatimit të aktiviteteve në kuadër të projektit “Televizioni Digjital i Evropës Jug-lindore (SEE Digi TV)”. Kjo rezultoi në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me autoritetet rregullatore të vendeve të rajonit dhe më gjerë, shkëmbimin e përvojave, sidomos për sa i përket procesit të kalimit në sistemin numerik.

Pas përfundimit zyrtar të projektit (16 gusht 2013), AMA nisi punën për hartimin e raportit narrativ dhe financiar, i cili përfshiu të gjitha aktivitetet e realizuara në kuadër të këtij

projekti. Ky raport u dërgua pranë Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, më datë 18 nëntor 2013.

Një vend të veçantë ka zënë edhe forcimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me organizmat apo strukturat ndërkombëtare, ku AMA është palë. Këtu vlen të përmendet roli dhe pjesëmarrja gjithnjë e më aktive e AMA-s në organizma të tilla si EPRA (Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore); RIRM (Rrjeti i Autoriteteve Rregullatore Mesdhetare); REFRAM (Rrjeti Frankofon i Autoriteteve Rregullatore); ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve); BRAF (Autoritetet Rregullatore të Vendeve të Detit të Zi) etj.

Ndërkohë, një rëndësi e veçantë i është dhënë edhe forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve bilaterale me autoritetet rregullatore të vendeve të rajonit dhe më gjerë, në funksion të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira në fushën e medias.

Gjatë vitit 2013, përfaqësuesit e AMA-s kanë qenë të pranishëm dhe kanë dhënë kontributet e tyre në takimet e mëposhtme:

- Seminari “Media në botën digjitale” zhvilluar në datën 6 mars 2013, në Lubjanë (Slloveni), të organizuar nga Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike të Sllovenisë (APEK). Ky seminar u zhvillua në kuadër të takimit plenar të Strukturës së Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike (BEREC), strukturë e cila kontribuon në zhvillimin dhe funksionimin më të mirë të tregut të brendshëm për rrjetet dhe shërbimet e komunikimeve elektronike.
- Konferenca e tretë Trans-nacionale dhe Takimi i 10-të i Bordit Drejtues në kuadër të projektit Digi TV, zhvilluar në datat 17-18-19 prill 2013, në Budapest (Hungari).
- Pjesëmarrja në konferencën e 37-të të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA) , në 09-10 maj 2013 në Krakov, Poloni. Thelbi i diskutimit dhe qendra e debatit të takimit të radhës të EPRA-s ishte impakti i medias së re, jo-lineare, për sa i përket mbrojtjes së të miturve në një mjedis të ndërvarur.
- Takimi me Këshillin Audiovizual të Katalonjës si dhe takimi për “Krijimin e grupit të punës të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore (MNRA). Takimi me Këshillin Audiovizual të Katalonjës u zhvillua në datën 13 qershor 2013, në Barcelonë, Spanjë, me qëllim vendosjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave në fushën e digjitalizimit. Takimi i MNRA-së, i cili u zhvillua në 14 qershor 2013 në Sevilje, Spanjë, u fokusua në luftën kundër stereotipive gjinore në median audiovizive.

- Takimi i Katërt i Forumit të Autoriteteve Rregullatore të Medias të Vendeve të Detit të Zi (BRAAF), zhvilluar në 5-6 shtator 2013, në Kiev, Ukrainë. Ky takim u fokusua në miratimin e një deklaratë të përbashkët mbi mbrojtjen e të miturve, prezantimin e analizës krahasuese të realizuar nga Sekretariati Permanent i BRAAF-it, në lidhje me vlerësimin e peizazhit audioviziv në të gjitha vendet anëtare të BRAAF-it, si dhe në çështjet që lidheshin me shërbimet e reja mediatike, impakti i tyre në transmetimet si dhe perspektivat e autoriteteve rregullatore.
- Takimi i organizuar nga “Organizata Ndërkombëtare e Frankofonisë”, zhvilluar në datat 17-18 shtator 2013 në Paris, Francë, takim i cili u fokusua në masat që duhet të merren për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Konferenca e 38-të e Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA) zhvilluar në datat 3-4 tetor 2013 në Vilnius, Lituani. Tema e këtij takimi ishte “Shërbimet e reja”, fokusuar kryesisht në VOD (videot me kërkesë), praktikat më të mira dhe metodologjia.
- Konferenca Rajonale me temë "Forcimi i pavarësisë së institucioneve rregullatore", organizuar nga Këshilli i Evropës, në kuadër të projektit "Promovimi i lirisë së shprehjes dhe informacionit dhe lirisë së medias në Evropën Juglindore", zhvilluar në datat 14-15 nëntor 2013, në Malin e Zi.

### ***5.2.1. Rezultatet e projektit “Televizioni Digjital i Evropës Juglindore (SEE Digi TV)”, i financuar nga Bashkimi Evropian***

Puna intensive e partnerëve të projektit SEE-Digi TV, rezultoi në një tërësi analizash, raportesh, direktivash, specifikimesh dhe rekomandimesh, të cilat synuan aspekte dhe faza të ndryshme të procesit të kalimit në sistemin digjital. Duke marrë në konsideratë nevojat e qytetarëve në vendet e përfshira në projekt, rezultatet e projektit janë fokusuar kryesisht tek autoritetet rregullatore dhe politikëbërësit, por janë me interes gjithashtu edhe për palët e interesuara, të cilat janë të përfshira në procesin e kalimit në sistemin digjital.

Partneriteti i projektit u zhvillua në një platformë të tillë, që lehtësoi dhe nxiti komunikimin, shkëmbimin e informacionit, ideve, eksperiencat e ndërsjella dhe praktikat më të mira. Një nga arritjet kryesore të projektit, që ishte bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet autoriteteve rregullatore dhe palëve të tjera të interesuara, nga rajoni, do të vazhdojë edhe pas përfundimit të projektit.

Bazuar në analizën krahasuese të legjislacionit në 10 vendet e përfshira në projekt, u përgatitën udhëzuesit mbi legjislacionin, mbi përdorimin e dividendit digjital, dhe mbi skemën e ndihmës. Analizat kanë treguar se kushtet lidhur me kalimin nga televizioni analog në televizionin tokësor digjital ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njëri vend në tjetrin përgjatë gjithë vendeve të rajonit.

Pavarësisht faktit se paketat e punës nuk mund të ofronin rekomandime, të cilat do të ishin njësoj të rëndësishme për të gjitha vendet, janë nxjerrë disa konkluzione dhe rekomandime të përbashkëta, në lidhje me planifikimin e procesit (përfshirë përcaktimin e roleve, përgjegjësi dhe masat e zbatimit), së pari, se si do të zhvillohen dokumentet e politikave duke iu kushtuar vëmendje të veçantë përputhshmërisë me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian (acquis communautaire), dhe, së dyti, se si masat e financimit publik duhet të marrin parasysh situatën specifike lokale në secilin vend.

Një paketë speciale pune i është dedikuar aspekteve teknike të procesit të kalimit në sistemin digjital, në mënyrë që të mundësojë shmangien e fragmentimit teknik të transmetimeve digjitale në rajon. Fillimisht, është vlerësuar gjendja aktuale e teknologjisë së transmetimit në vendet e përfshira dhe u hartuan udhëzuesit rajonalë, duke përfshirë një sërë rekomandimesh teknike për përdorimin e pajisjes së rrjetit të transmetimit dhe pajisjes së përdoruesit. Udhëzuesit e testeve laboratorike të konformitetit shërbyen si bazë për krijimin e proceseve përkatëse, si në nivel kombëtar ashtu dhe rajonal.

Pavarësisht nga ecuria e ndryshme e procesit të digjitalizimit në vendet e përfshira në projekt, analizat e strategjive kombëtare të kalimit në transmetimet digjitale, kanë treguar shumë ngjashmëri konceptuale. Ndryshimet u identifikuan gjatë hartimit të planit të veprimit. Shumë strategji adresojnë aspektet ekonomike të procesit të kalimit në sistemin digjital, si impaktet financiare për palët e interesuara, mundësitë për futjen e shërbimeve të reja dhe perspektivat e dividendit digjital.

Procesi i digjitalizimit ndikon ndjeshëm në jetën dhe prirjet e qytetarëve dhe kërkon ndërmarrjen e një sërë aktiviteteve dhe iniciativave të koordinuara dhe efektive që i bëjnë njerëzit të ndërgjegjshëm për kalimin në transmetime digjitale. Plani i veprimit për ndërgjegjësimin publik ofron udhëzime për mënyrën sesi mund të krijohet një fushatë e plotë komunikimi. Ai mbështet palët e interesuara në zhvillimin dhe zbatimin e një fushate informuese rajonale, të një plani komunikimi me konsumatorin dhe të një programi edukimi rajonal për konsumatorin. Një udhëzues i dedikuar, lehtëson krijimin e një instrumenti të

duhur analizues për matjen e ndërgjegjësimit, në lidhje me procesin e kalimit në transmetimet digjitale. Ai përmban udhëzues teorik dhe shembuj praktikë.

Këto outpute janë një kontribut mjaft i rëndësishëm për ecurinë e procesit të kalimit në sistemin numerik në Shqipëri, duke pasur parasysh fazën në të cilën ndodhet ky proces. Njohja me praktikën dhe eksperiencat më të mira nga vendet e rajonit, shërben si instrument për të pasur një kalim të suksesshëm në transmetimet numerike. Analizat e kryera, udhëzimet dhe specifikimet e hartuara në nivel projekti, janë një bazë dhe mbështetje e fuqishme për përcaktimin e hapave dhe rrugëve konkrete drejt finalizimit të këtij procesi.

Pjesëmarrja në këtë projekt e vendeve që tashmë e kanë përfunduar këtë proces, ishte një eksperiencë mjaft e dobishme dhe shumë frytdhënëse për vendet që janë në procesin e realizimit apo në fazat/hapat fillestarë të tij, si vendi ynë. Mundësia për të diskutuar, këshilluar njëri-tjetrin në lidhje me ato se çfarë hapash duhet të merren apo të shmangen në lidhje me elementë të caktuar të këtij procesi, është një tjetër impakt dhe kontribut i ofruar nga ky projekt. Çdo veprim apo mosveprim i kryer jo në drejtimin dhe kohën e duhur, përbën rrezik për dështimin e procesit, si dhe krijimin e kostove dhe impakteve sociale dhe ekonomike për të gjitha grupet e përfshira në proces.

### **5.3. Marrëdhëniet me publikun dhe grupet e interesit**

Transparenca e vazhdueshme e veprimtarisë së AMA-s, si dhe zhvillimi i një komunikimi të pandërprerë, me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e medias, ka qenë dhe mbetet një objektiv parësor i këtij institucioni. Gjatë vitit 2013, një vëmendje e veçantë i është kushtuar realizimit të takimeve dhe seminareve të ndryshme me të gjithë grupet e interesit. Disa nga aktivitetet më kryesore në këtë drejtim, janë si më poshtë:

Miratimi dhe hyrja në fuqi e ligjit të ri të medias, nxiti Autoritetin Rregullator (AMA), që më datë 5 prill 2013, të organizojë takimin me temë “Prezantimi i ligjit të ri në fushën e mediave audiovizive”, me qëllim informimin e operatorëve televizivë, kombëtarë dhe vendorë, mbi të rejtat që sjell kuadri i ri ligjor, për sa i përket procesit të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike, si dhe mundësinë për të diskutuar dhe qartësuar dispozita të caktuara të ligjit të ri në fushën e mediave audiovizive.

Më 7 qershor 2013, AMA organizoi seminarin me temë “Zbatimi i dispozitave të ligjit të ri në fushën e mediave audiovizive. Format dhe mënyrat e kalimit në transmetimet numerike”, me synim prezantimin e procedurave ligjore dhe teknike që duhet të ndërmerren nga

operatorët audiovizivë. Në këtë seminar u diskutua gjithashtu rreth kalimit në transmetimet digjitale dhe licencimit të rrjeteve numerike kombëtare.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri, AMA ngriti një grup pune, ngarkuar me hartimin e akteve rregullatore për zbatimin e plotë të ligjit të ri të medias. Në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, aktet e hartuara u publikuan për këshillim publik në faqen zyrtare të AMA-s ([www.ama.gov.al](http://www.ama.gov.al)), me qëllim marrjen e opinioneve dhe rekomandimeve nga të gjitha grupet e interesit.

Në datën 17 qershor 2013, AMA organizoi tryezën e parë të përbashkët, ku u ftuan të merrnin pjesë televizionet private kombëtare, platformat private numerike dhe organizatat ndërkombëtare. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i sugjerimeve dhe vërejtjeve të bëra në lidhje me rregulloren “Për licencimin e rrjeteve numerike dhe programeve që mbështeten në to, përmes procedurës *beauty contest*”, përpara miratimit të saj. Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues nga OSBE dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë.

Më datë 28 qershor 2013, AMA organizoi një tryezë të dytë të rrumbullakët, me qëllim vazhdimin e mëtejshëm të diskutimeve. Sugjerimet e dala nga kjo tryezë u pasqyruan në projekt-rregullore, e cila iu ridërgua si subjekteve pjesëmarrëse, ashtu edhe atyre që munguan në këtë takim. Edhe në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga OSBE dhe Delegacioni i Bashkimit Evropian në Tiranë.

Në datën 18 korrik 2013, në kuadër të procesit të këshillimit publik për të gjitha aktet rregullatore, të cilat kanë një ndikim të ndjeshëm në ofrimin e shërbimeve audio dhe audiovizive, AMA organizoi një takim të përbashkët me të gjitha subjektet e interesuara. Objekt i diskutimit të këtij takimi ishin projekt-rregulloret “Për planin e renditjes të shërbimeve mediatike audiovizive që mbështeten në rrjete numerike”, dhe “Për ofrimin e shërbimeve me akses të kushtëzuar”.

Në datën 25 korrik 2013, në vijim të takimeve të mëparshme, AMA zhvilloi takimin e radhës me të gjithë aktorët e interesuar, duke u fokusuar në diskutimin e projekt-rregulloreve “Mbi të drejtën e transmetimit të programeve audiovizive” dhe “Kodi i transmetimit”.

Qëllimi i këtyre tryezave ishte prezantimi dhe diskutimi rreth përmbajtjes së këtyre projektakteve, duke synuar marrjen e komenteve dhe sugjerimeve nga pjesëmarrësit.

Gjithashtu, AMA u ka kërkuar zyrtarisht të gjitha subjekteve audiovizive dhënien e mendimeve dhe komenteve me shkrim për aktet nënligjore të hartuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, si dhe ka shprehur gatishmërinë për të organizuar takime të tjera të përbashkëta pune me të gjithë aktorët e interesuar.

Edhe gjatë vitit 2013, një vëmendje e veçantë i është kushtuar pasurimit dhe përditësimit të faqes zyrtare të institucionit, nëpërmjet rifreskimit të vazhdueshëm me informacione dhe rubrika të reja, për të mundësuar funksionimin e një sistemi komunikimi sa më efektiv me të gjithë grupet e interesit.

#### **5.4. Aktiviteti ekonomik dhe financiar**

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 42, datë 23.01.2013, “Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2013” miratoi fondin limit si dhe strukturën e shpenzimeve.

*Treguesit financiarë për vitin 2013, sipas strukturës, janë si më poshtë:*

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>Në milionë lekë</b>
1	Të ardhura të krijuara në vitin 2013	112,95
2	Shpenzime korente	103,10
3	Shpenzime për investime	5

##### **5.4.1 Të ardhurat**

Treguesit kryesorë për krijimin e të ardhurave të institucionit janë detyrimet e operatorëve radiotelevizivë, që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit përkatës.

Detyrimet financiare për operatorët radiotelevizivë janë: pagesat vjetore për licencë dhe tarifatat për shërbimet radiotelevizive. Këto detyrime llogariten mbi bazën e numrit të popullsisë sipas zonave të licencimit, numrit të transmetuesve të operatorëve dhe fuqisë së rrezatimit të tyre.

**5.4.1.1. Realizimi i treguesve financiarë**

Struktura e zërit “Të ardhura”, e parashikuar dhe e realizuar për vitin 2013, paraqitet si vijon:

Në milionë lekë

Nr	Zërat e të ardhurave	Plani	Realizimi	Në %
1	Të ardhura nga pagesat vjetore për licencë	107,45	78,76	73
2	Të ardhura nga pagesa për marrjen e licencës dhe rinovimin e licencës	1,50	0,30	20
3	Të ardhura nga përpunimi i dokumenteve të licencës	1,60	0,67	42
4	Të ardhura nga përfitimet si agjent tatimor	1,20	0,90	75
5	Të ardhura nga interesa bankare për depozitat në bankë	1,00	0,36	36
6	Të ardhura të tjera	0,20	0,024	12
	<b>Gjithsej të ardhura</b>	<b>112,95</b>	<b>81,03</b>	<b>72</b>

**5.4.1.2. Realizimi i zërit “Të ardhura”**

Për vitin 2013, realizimi i të ardhurave nga pagesat për licencë është realizuar në masën 78,754,923 lekë ose 73%, nga 107,450,000 lekë të planifikuara.

Nga realizimi i të ardhurave të mësipërme, 30,873,381 lekë janë të ardhura nga faturat e pagesave për licencë për vitin 2013 dhe 47,881,542 lekë nga të ardhurat e faturuara në vitet paraardhëse.

Nga 234 operatorë, të cilët operojnë në fushën e mediave audiovizive, kanë kryer pagesat për licencë 114 prej tyre, nga të cilët, 46 operatorë radiofonikë, 30 operatorë televizivë, 37 operatorë me kabëll dhe 1 operator platforme numerike satelitore. Në bazë të periudhës së licencimit, në vitin 2013 kanë paguar detyrimet e vitit 2012 rreth 90% e operatorëve, të cilët e kishin afatin përfundimtar të shlyerjes së pagesave vjetore të vitit 2012, në gjashtë mujorin e parë ose të dytë të vitit 2013.


Të ardhurat për marrjen dhe rinovimin e licencës janë realizuar në shumën 305.000 lekë ose 20% e shumës së planifikuar. Të ardhurat nga përpunimi i dokumenteve për marrjen dhe rinovimin e licencave janë realizuar në shumën 675,000 lekë ose 42%. Mosrealizimi i zërave të mësipërm ka ardhur si rezultat i moslicensimit dhe rilicensimit të operatorëve për shkak të mungesës së shumicës së cilësuar të AMA-s.



Të ardhurat nga agjenti tatimor janë realizuar në shumën prej 902,440 lekë ose 75% të shumës së planifikuar. Të ardhurat nga interesa bankare janë realizuar në shumën 364,122 lekë ose 36% të shumës së planifikuar.

Për sa më lart, gjatë vitit 2013, në llogarinë e AMA-s janë arkëtuar gjithsej të ardhura në shumën prej 81,032,242 lekë ose 72 % nga të ardhurat e planifikuara.

Në fushën e mediave elektronike, për vitin 2013, rezultojnë të licencuar 234 operatorë, të klasifikuar sipas llojit të aktivitetit si më poshtë:



Për vitin 2013, u morën një sërë masash për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura. Për rrjedhojë, nga 101,129,366 lekë që ishte gjendja e debitorëve në fillim të vitit 2013, u arkëtua shuma prej 47,881,542 lekë. Sqarojmë edhe një herë se, këto diferenca të debitorëve krijohen për shkak se, pagesa vjetore për licencë llogaritet për vit licencimi dhe faturohet në vitin paraardhës, por paguhet në vitin pasardhës. Një shkak tjetër është edhe neglizhenca e operatorëve për shlyerjen në afat të detyrimeve. Për penalizimin e këtyre rasteve, AMA ka marrë masat përkatëse, deri në shpalljen e pavlefshmërisë së licencës.

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

Më konkretisht, subjektet ndaj të cilave janë marrë masa për detyrimet e papaguara paraqiten më poshtë:

<b>Nr</b>	<b>EM Ë R T I M I</b>	<b>Qyteti</b>	<b>Vlera në ALL</b>
1	TV privat vendor "Tv 4"	Berat	690,000
2	TV privat vendor "Tv ABC"	Korçë	489,000
3	TV privat vendor "Tv Rex"	Korçë	833,400
4	TV privat vendor "Tv D1"	Peshkopi	245,400
5	TV privat vendor "Tv ARV"	Pogradec	327,600
6	TV privat vendor "Tv Shijak"	Tiranë	4,184,000
7	TV kabllor privat "Elba-Sat"	Elbasan	2,175,000
8	TV kabllor privat "Tv Portez"	Fier	400,000
9	TV kabllor privat "Multivizion"	Kavajë	833,330
10	TV kabllor privat "Krujë"	Krujë	466,670
11	TV me kabëll Memaliaj	Memaliaj	500,000
12	TV kabllor privat "Tv Flavio Cable"	Peshkopi	691,670
13	TV kabllor privat "Tv Kamëz"	Tiranë	1,920,830
14	TV kabllor privat "Tv Kabllor Voskop"	Korçë	400,000
15	TV kabllor privat "I-Miri Cable"	Korçë	2,050,000
16	Radio private vendore "Aldo 03"	Tiranë	127,400
17	Radio private vendore "Magic Star"	Korçë	137,100

Për operatorët, të cilëve iu është bërë licenca e pavlefshme, AMA ka bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale Tatimore, me qëllim vjeljen e detyrimeve të prapambetura, si dhe është duke përgatitur dokumentacionin përkatës për paraqitjen pranë gjykatave të kërkesë padive me objekt ekzekutimin e detyrimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i shfuqizuar, detyrimet e faturuara dhe të papaguara në vitin kalendarik mbarteshin për t’u likuiduar në vitin pasardhës. Kjo mangësi u përmirësua në

ligjin e ri, ku në pikën 4 të nenit 25 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se: “...4. *Pagesa për marrjen e licencave ose autorizimit bëhet në momentin e marrjes së licencës ose autorizimit. Pagesat vjetore kryhen brenda tremujorit të parë të çdo viti kalendarik*”.

Gjithashtu, në zbatim të nenit 25 të ligjit të sipërcituar, AMA ka miratuar vendimet për pagesat për licencë ose autorizim. Në këto vendime parashikohet se, në rast të moslikuidimit në afatin e përcaktuar me ligj, do të aplikohen kamatëvonesa si më poshtë: “... *Në rastin kur pagesa kryhet pas kalimit të këtij afati, aplikohet një kamatë vonese në masën 0.1% të vlerës së pagesës vjetore për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 30% e vlerës së detyrimit financiar*”.<sup>38 39</sup>

#### **5.4.1.3. Të ardhurat nga agjenti tatimor**

Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ngarkon AMA-n, në rolin e agjentit tatimor, për transferimin në buxhetin e shtetit të tarifës vjetore për shërbimet radiotelevizive të ofruesve të shërbimit mediatic. Për këtë shërbim, AMA përfiton 5% të vlerës së arkëtuar dhe të transferuar në Drejtorinë Rajonale të Tatim Taksave Tiranë, vlerë, e cila përdoret nga institucioni për shpërblimin e punonjësve, të cilët janë të ngarkuar me llogaritjen, arkëtimin dhe transferimin e tarifës së shërbimit radioteleviziv.

Gjithsej për vitin 2013, shuma e detyrimeve të tarifës për shërbimet radiotelevizive llogaritet në 30,755,619 lekë, shumë, e cila përfshin detyrimet e papaguara për vitin 2011 dhe 2012 (16,722,960 lekë), si dhe tarifën e llogaritur për vitin 2013 (14,032,659 lekë).

Në vitin 2013, nga shuma totale e detyrimeve të tarifës për shërbimet radiotelevizive, janë arkëtuar 24,619,200 lekë dhe janë transferuar në buxhetin e shtetit 18,408,500 lekë, ndërkohë që shuma e mbetur nga arkëtimi prej 6,510,700 lekë është transferuar në muajin janar 2014. AMA si agjent tatimor ka përfituar 902,440 lekë.

<sup>38</sup> Pika 3, Vendim i AMA-s nr. 4, datë 22.05.2013

<sup>39</sup> Pika 6, Vendim i AMA-s nr. 5, datë 22.05.2013

#### 5.4.2. Shpenzimet

Këshilli i Ministrave, me vendimin nr. 42, datë 23.01.2013, “Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit për vitin 2013”, miratoi fondin limit të shpenzimeve për këtë vit, të detajuar si më poshtë:

Shpenzime konkrete	103,1	milione lekë
Shpenzime për investime	5	milione lekë
<b>Gjithsej</b>	<b>108,1</b>	<b>milione lekë</b>

Për periudhën janar–dhjetor 2013, realizimi i shpenzimeve paraqitet si më poshtë:

Në milionë lekë

Nr	Emërtimi i Shpenzimeve	Plan	Realizim	%
1.	Shpenzime korente (operative)	103,1	76,7	74
	a) Paga e kontribute	58,5	53,5	91
	b) Shpenzime materiale e të tjera	44,6	23,2	52
2.	Shpenzime për investime	5	1,9	38
	a) Blerje pajisje zyre	2	1,4	70
	b) Blerje pajisje kompjuterike dhe operationale	3	0,5	17

##### 5.4.2.1. Shpenzime korente


Shpenzimet korente janë realizuar në masën prej 76,728,505 lekë ose 74% e shumës së planifikuar. Realizimi në këtë masë ka ardhur për arsye se:

- a) Realizimi i zërit “Paga e kontribute të tjera” në masën 91% ka ardhur si rrjedhojë e lëvizjes së punonjësve, si dhe nga pagesat e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për paaftësi të përkohshme në punë. Po kështu, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, i ndryshuar, nuk janë kryer pagesat për orët e punës jashtë orarit dhe gjatë ditëve të pushimit, pagesa që, për vetë specifikën e institucionit tonë, ishin planifikuar në fondin e pagave.
- b) Realizimi i zërit “Shpenzime materiale e të tjera”, në masën 52 %, është si më poshtë:
  - Shpenzimet për “Honorare”, janë realizuar në masën 894,360 lekë ose 26%, për arsye të 3 vendeve vakante të AMA-s gjatë vitit 2013.

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

- Shpenzimet për zërin “Dieta”, janë realizuar në masën 4,471,394 nga 6,000,000 lekë të parashikuara.
- Nuk është realizuar zëri “Shpenzime për mirëmbajtje”, për arsye se ambientet e punës, në të cilat AMA ushtron aktivitetin e vet, me vendim gjyqësor, i janë kthyer një subjekti privat.

Në mënyrë grafike realizimi i shpenzimeve, për vitin 2013, paraqitet si vijon:



- Në buxhetin e vitit 2013, nga të ardhurat e vetë AMA-s, ishte planifikuar për shpenzime një shumë prej 15 milionë lekë, si më poshtë:
  - a) Zëri “Konferenca rajonale dhe kombëtare”, me një fond 2 milionë lekë.
  - b) Zëri “Fushata për informimin e publikut”, me një fond 13 milionë lekë.

Realizimi i shpenzimeve të mësipërme është bërë në shumën 1 milionë lekë.

Planifikimi i këtyre shpenzimeve është bërë në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike”, si dhe Planit të Veprimit për ndjekjen e zbatimit të saj, pavarësisht se për kryerjen e këtyre projekteve është parashikuar se “*KKRT merr përsipër kryerjen e kësaj detyre, vetëm nëse sigurohet financimi përkatës nga buxheti i shtetit*”.

### 5.4.2.2. Shpenzimet për investime

Ky tregues është realizuar në masën 1,898,990 lekë ose 38% e shumës së planifikuar, si vijon:

- a) Blerje pajisje kompjuterike dhe operationale 525,220 lekë
- b) Blerje pajisje zyre 1,373,770 lekë

### 5.5 Pasqyrat financiare të operatorëve radiotelevizivë

Në zbatim të nenit nr. 48 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, AMA (ish KKRT) ka kërkuar nga operatorët radiotelevizivë, të cilët kanë pasur aktivitet për vitin 2012, të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, të hartuara në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe të konfirmuara me numrin dhe datën e dërgesës postare.

Në mbyllje të vitit 2013, nga 250 operatorë, të cilët kanë pasur aktivitet gjatë vitit 2012, kanë dorëzuar pasqyrat financiare vetëm 105 operatorë, ku përfshihen 34 operatorë radio, 36 operatorë televizivë, 33 operatorë televizivë me kabëll dhe 2 operatorë televizivë numerikë. Situata financiare e operatorëve që kanë dorëzuar pasqyrat financiare rezulton si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Operatorë me fitim	Operatorë me rezultat 0	Operatorë me humbje	Gjithsej operatorë
1	Operatorë radiofonikë	21	3	10	34
2	Operatorë audioviziv	29	2	5	36
3	Operatorë me kabëll	28	2	3	33
4	Operatorë numerikë	2			2
	<b>Gjithsej</b>	<b>80</b>	<b>7</b>	<b>18</b>	<b>105</b>

Nga analiza e treguesve financiarë të këtyre operatorëve radiotelevizivë rezulton se peshën specifike të të ardhurave e zë zëri “Të ardhurat nga reklamat”, dhe/ose nga pagesat e abonentëve. Ndërkohë, rezulton se të ardhurat e deklaruara në bilancet kontabël për vitin 2012 janë gjithsej 11,534,029,980 lekë në vit, ndërsa shpenzimet e deklaruara në bilancet kontabël, janë gjithsej 10,640,078,404 lekë ose 93 % e të ardhurave të krijuara nga aktiviteti.

Pavarësisht se dorëzimi i pasqyrave financiare vjetore nga operatorët është detyrim ligjor, nga operatorët neglizhohet dorëzimi i tyre. AMA, në mënyrë të vazhdueshme, ka kërkuar dorëzimin e pasqyrave financiare, por ligji i mëparshëm, nuk parashikonte vendosjen e sanksioneve ndaj operatorëve, të cilët nuk respektonin këtë detyrim ligjor.

Për të plotësuar këtë boshllëk ligjor, ligji i ri, në nenin 33, pika "g", ka parashikuar detyrimin e ofruesve të shërbimit mediatik “për të paraqitur bilancin vjetor pranë AMA-s jo më vonë se data 30 prill e çdo viti”. Gjithashtu, në nenin 133, pika 1, germa "a" i ligjit të sipërcituar,

## AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

është parashikuar vendosja e sanksioneve me gjobë nga 40 000 deri në 400 000 lekë për rastet kur nuk respektohen detyrimet që rrjedhin nga ky nen.

### 5.6 Gjobat

Gjatë vitit 2013 janë vendosur 43 sanksione gjobë me vlerë 135,440,000 lekë.

Në zbatim të nenit 133, pika 13 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se: *”Gjoba është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbarrimor dhe derdhet 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në buxhetin e AMA-s.”*, AMA ka kërkuar, pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, lëshimin e urdhrave të ekzekutimit për titujt ekzekutivë për sanksionet me gjobë. Pas lëshimit të urdhrave të ekzekutimit për vjeljen e detyrimeve janë lidhur kontrata me shërbimin përmbarrimor, si më poshtë:

	Subjekti	Qyteti	Nr. i gjobës	Data e gjobës	Vlera (lekë)	NIPT	Data e vendimit gjyqësor
1	TV Ca. Cakran	Fier	380	27.05.2011	200000	K92904403D	06.06.13
2	TV Ca. Kuçova	Berat	381	27.05.2011	200000	K38228134E	12.06.13
3	TV Ca. Kucova	Berat	393	01.07.2011	400000	K38228134E	14.06.13
4	Olsi Kultarga,	Dibër	1	06.01.2012	1000000		11.06.13
5	TV Ca. AVN	Fier	452	26.03.2012	1000000	J63208417Q	17.06.13
6	TV Ca. Voskopi	Korçë	457	03.04.2012	600000	K94119001S	14.06.13
7	TV Ca. Kombi	Fier	461	07.05.2012	400000	K43407402P	12.06.13
8	TV Ca. Poliçan	Berat	465	07.05.2012	500000	K38709496A	14.06.13
9	TV Ca. Pojan	Fier	478	13.07.2012	300000	K92526403J	11.06.13
10	TV Ca. Luna	Kavajë	586	11.02.2013	200000	L03301801M	12.06.13
11	TV Ca. Maqellara	Dibër	485	19.07.2012	200000	K86820701U	11.06.13
12	TV Ca. Voskopi	Korçë	492	05.09.2012	300000	K94119001S	14.06.13
13	TV vendor 6	Kavajë	524	05.12.2012	200000		12.06.13
14	TV vendor 6	Kavajë	525	05.12.2012	20000	K63114802N	
15	TV vendor 6	Kavajë	526	05.12.2012	20000		
16	TV Ca. Portëz	Fier	563	15.01.2013	300000	K92712403O	17.06.13

**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

17	TV Ca. Kuçova	Berat	585	11.02.2013	200000	K38228134E	17.06.13
18	TV Ca. Xhaçi	Korçë	592	11.02.2013	200000	K96803601A	14.06.13
19	TV Ca. Voskopi	Korçë	595	11.02.2013	300000	K94119001S	14.06.13
20	Z. Fatos Hymetollari, për TV të palicencuar	Korçë	613	15.03.2013	1000000		14.06.13
21	TV Koha	Tiranë	388	01.06.2011	200000	K21817006K	13.06.13
22	TV Koha	Tiranë	428	06.12.2011	800000	K21817006K	12.06.13
23	TV Koha	Tiranë	439	16.12.2011	300000	K21817006K	14.06.13
24	Radio One	Tiranë	532	17.12.2012	200000	K92226026O	27.06.13
25	Radio Rash	Tiranë	534	17.12.2012	200000	K21909002K	24.06.13
26	Shoqëria "Alb-Com" TV	Vlorë	528	05.12.2012	200000	K11308001B.	14.06.13
27	TV kabllor "Kamzë"	Tiranë	506	23.10.2012	600000	K91512037M	19.07.13
28	TV kabllor "Kamza"	Tiranë	599	12.02.2013	400000	K91512037M	14.06.13
29	TV Shijak	Tiranë	387	01.06.2011	200000		19.06.13
30	TV Shijak	Tiranë	433	16.12.2011	400000		01.07.13
31	TV Shijak	Tiranë	616	26.03.2012	2000000		24.06.13
	TV Shijak	Tiranë	617	03.04.2012	10000000		
	TV Shijak	Tiranë	623	05.09.2012	10000000		
	TV Shijak	Tiranë	625	05.12.2012	10000000	K01711002M	
	TV Shijak	Tiranë	626	05.12.2012	10000000		
	TV Shijak	Tiranë	627	05.12.2012	10000000		
	TV Shijak	Tiranë	618	07.05.2012	10000000		
	TV Shijak	Tiranë	619	07.05.2012	10000000		
	TV Shijak	Tiranë	620	13.07.2012	10000000		
	TV Shijak	Tiranë	621	19.07.2012	10000000		
32	TV kabllor "Delta"	Pogradec	449	29.02.2012	600000	K74805602L	28.06.13



**AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE**

33	TV kabllor "Delta"	Pogradec	479	19.07.2012	100000	K74805602L	28.06.13
34	TV kabllor "Delta"	Pogradec	303	16.12.2010	400000	K74805602L	09.09.13
35	TV kabllor "Inkusat"	Pogradec	304	16.12.2010	300000	K43924655C	09.09.13
36	TV " Ca Përmeti"	Përmet	500	05.12.2012	300000	L19416201E	09.07.13
37	TV " Ca Përmeti"	Përmet	596	11.02.2013	300000	L19416201E	09.07.13
38	TV " Ca Përmeti"	Përmet	527	05.12.2012	300000	L19416201E	09.07.13
39	TV Egnatia	Elbasan	472	08.06.2012	200000	K52931201O	25.06.13
40	TV kabll."Elba sat"	Elbasan	493	05.09.2012	600000	K63513203A	24.06.13
41	TV kabllor "Brado"	Elbasan	499	18.09.2012	200000	K32803221V	21.06.13
42	TV "Ca Alb.North"	Elbasan	571	31.01.2013	200000	K92703206E	27.06.13
43	TV kabll."Elba sat"	Elbasan	396	01.07.2011	200000	K63513203A	27.06.13
44	TV kabll."Elba sat"	Elbasan	417	31.10.2011	300000	K63513203A	27.06.13
45	TV "Ca Alb South"	Elbasan	625	05.12.2012	200000	K92703204L	19.09.13

Gjatë vitit 2013, janë shlyer 1 milionë lekë për sanksionet me gjobë.

### **5.7 Rezultatet dhe rekomandimet e kontrollit të ushtruar nga KLSH**

Gjatë kontrollit të ushtruar nga përfaqësuesit e autorizuar të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për auditimin me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së aktivitetit ekonomik e financiar”, për periudhën 01.01.2011-30.09.2013, sipas çështjeve të përcaktuara në programin e kontrollit, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit me konkluzionin se:

*”Autoriteti i Mediave Audiovizive operon me të ardhurat e veta pa financim nga buxheti i shtetit, nga viti 2006 dhe paraqet një performancë të mirë në menaxhimin e shpenzimeve,*

*pasi ka menaxhuar drejt veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucionit, ka administruar siç duhet vlerat materiale dhe monetare, bazuar në rregullat dhe standardet financiare.*

*Raportimet financiare paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale e monetare të institucionit, pasi ka bërë të mundur arritjen e objektivave, politikave dhe qëllimeve të njësisë por, ka nevojë edhe për disa përmirësime të trajtuara sipas gjetjeve nga auditimi”.*

Në Raportin Përfundimtar të Auditimit, u lanë rekomandimet përkatëse, të cilat janë zbatuar tërësisht nga AMA<sup>40</sup>.

---

<sup>40</sup> Referuar pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit me shkresën nr. 275, datë 28.01.2014.

## 6. KONKLUZIONE

Në mbyllje të këtij Raporti Vjetor theksojmë si më thelbësore konkluzionet e mëposhtme:

1. Nevoja për zbatimin me ritme të shpejta të Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në ato Numerike. Duke patur parasysh kufirin kohor, qershor 2015, për mbylljen e transmetimeve analoge, vlerësojmë se koha që ka mbetur deri në përfundim të procesit është shumë e shkurtër dhe rrezikohet zbatimi i saj brenda afateve të parashikuara.
2. Përshpejtimi i procesit të kalimit në transmetime numerike të RTSH-së si dhe zhbllokimi i procesit të licencimit të rrjeteve private kombëtare është i domosdoshëm për vijimin e zbatimit në tërësi të procesit të kalimit në transmetimet numerike.
3. Plotësimi i shpejtë i vendeve vakante të AMA-s për të siguruar funksionimin normal të një organi kolegjal dhe zhbllokimin e vendimmarrjes për një tërësi aktesh rregullatore dhe vendimesh të rëndësishme, që janë të domosdoshme ndër të tjera për zbatimin e plotë dhe në afat të procesit të kalimit në transmetimet numerike.
4. Respektimi i të drejtave themelore të njeriut dhe sidomos mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në transmetimet audiovizive, kërkon domosdoshmërisht funksionimin e Këshillit të Ankesave, ngritja e të cilit mundësohet me shumicë të cilësuar vetëm pas plotësimit të vendeve vakante të AMA-s.
5. Miratimi i strukturës së re të AMA-s, në përputhje me politikat rregullatore të vendeve të Bashkimit Europian, do të përmbushë me efikasitet kërkesat e kuadrit të ri ligjor.
6. Forcimi i kapaciteteve monitoruese dhe teknike do të përmirësojë më tej monitorimin e programeve audiovizive si dhe shfrytëzimin më të mirë të spektrit të frekuencave.
7. Intensifikimi i procesit të koordinimit me vendet fqinje për zbatimin e Planit të Frekuencave Numerike (GE-06 D) në kuadër të procesit të kalimit në transmetimet numerike.
8. Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me Zyrën Shqiptare të të Drejtave të Autorit, Autoritetin e Konkurrencës dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, konsiderohet i nevojshëm për respektimin e të drejtave të transmetimit dhe garantimin e konkurrencës së ndershme në tregun mediatik.

9. Zbatimi i Kodit të Transmetimit për mediat audiovizive kërkon një proces të plotë bashkëpunimi dhe komunikimi mes autoritetit rregullator, ofruesve të shërbimit mediatik dhe aktorëve të tjerë të interesuar për transmetimet audiovizive.
10. Nevoja e hartimit dhe zbatimit të programit të ndërgjegjësimit publik, i cili do të informojë konsumatorët dhe do t'i edukojë ata mbi veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren në kuadër të realizimit me sukses të procesit të kalimit në transmetimet numerike.
11. Nevoja për zgjidhjen përfundimtare të kërkesës së AMA-s për sistemimin në ambiente të reja pune kërkon një zgjidhje të shpejtë, pasi ambientet aktuale i janë kthyer, me vendim gjykate, një subjekti privat.